



Raport Përfundimtar Auditimi “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E PERFORMANCËS TË EVADUAR NË GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2023”

për auditimet e performancës sipas temave:

1. “Rezerva materiale e shtetit në shërbim të qytetarit”,
2. “Performanca e Shërbimit të Paraburgimit”,
3. “Fuqizimi Ekonomik i Gruas në Vendin tonë”,
4. “Shërbimi përmbartimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”,
5. “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”.

Tiranë, 2024

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.1	PËR AUDITIMIN ME TEMË “REZERVA MATERIALE E SHËRBIMIT NË SHËRBIM TË QYTETARIT”.....	7
II.2	PËR AUDITIMIN ME TEMË “PERFORMANCA E SHËRBIMIT TË PARABURGIMIT”.....	41
II.3	PËR AUDITIMIN ME TEMË “FUQIZIMI EKONOMIK I GRUAS NË VENDIN TONË”	59
II.4	PËR AUDITIMIN ME TEMË “SHËRBIMI PËRMBARIMOR SHËRBIMOR NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE”	76
II.5	PËR AUDITIMIN ME TEMË “NDIKIMI I MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR NË CILËSINË E AJRIT”.....	96
III.	ANEKSE	119

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Auditimi është kryer, në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 914 prot., datë 08.07.2024, "Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023", në përputhje me kërkesat e Manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional", të miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së, në subjektet si më poshtë vijon:

- 1 Ministria e Mbrojtjes;
- 2 Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit;
- 3 Ministria e Drejtësisë;
- 4 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- 5 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- 6 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- 7 Ministria e Financave;
- 8 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- 9 Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
- 10 Drejtoria e Përgjithshme të Përmbartimit Shtetëror;
- 11 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- 12 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- 13 Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Auditimi u krye nga:

Për Raportin përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve u angazhua grupi me përbërje: **K.Xh, E.K dhe V.K.**

Për Raportet e veçanta mbi zbatimin e rekomandimeve u angazhuan: audituesit si më poshtë:

- 1-** Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin me temë "Rezerva materiale e shtetit në shërbim të qytetarit";
 - E.K, përgjegjëse grupi;
 - M.L, anëtare;
 - K.Xh, anëtar;
- 2-** Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin me temë: "Performanca e Shërbimit të Paraburgimit";
 - B.L, përgjegjës grupi;
 - L.Gj, anëtar;
 - A.S, anëtar;
- 3-** Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin me temë "Fuqizimi Ekonomik i Gruas në Vendin tonë";
 - Xh.Ç, përgjegjëse grupi;
 - M.L, anëtar;
 - L.Gj, anëtar;

4- Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin me temë “Shërbimi përmbartimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”;

- V.K, përgjegjëse grupi;
- A.Ç, anëtare;

5- Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin me temë “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”;

- A.G, përgjegjës grupi;
- Xh.Ç, anëtare;
- J.Zh, anëtare;

Auditimi ka filluar më, datë 08.07.2024.

Auditimi ka përfunduar më, datë 16.08.2024.

Periudha e auditimit: Për auditimet e evaduara në periudhën **01.01.2023 - 30.06.2023.**

Subjektet e audituara sipas temave përkatëse paraqiten si më poshtë:

Tema e auditimit:	Subjektet e audituara:
1. “Rezerva materiale e shtetit në shërbim të qytetarit”;	-Ministria e Mbrojtjes -Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit
2. “Performanca e Shërbimit të Paraburgimit” ;	- Ministria e Drejtësisë - Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
3. “Fuqizimi Ekonomik i Gruas në Vendin tonë” ;	- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - Ministria e Financave -Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
4. “Shërbimi përmbartimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore” ;	- Drejtoria e Përgjithshme të Përmbartimit Shtetëror
5. “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit” ;	- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Nga auditimi rezultoi se, nga ana e këtyre institucioneve janë marrë masa mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, efektet e të cilave trajtohen më poshtë.

Nga auditimi tematik “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”, mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet e INTOSAI-t, Manualët e Auditimit të KLSH, për periudhën **01.01.2023 deri më 30.06.2023**, rezultoi se **niveli i pranimit të rekomandimeve** nga auditimi i ushtruar për zbatimin e rekomandimeve, paraqitet sipas tabelës vijon:

Tabela mbi nivelin e pranimit të rekomandimeve sipas llojit:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar Në numër
1	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	5	5	0
2	Organizative	80	78	2
	Total	85	83	2

Në 13 subjekte të audituara nga KLSH, janë rekomanduar gjithsej 85 masa nga të cilat janë pranuar 83 masa ose rreth 97.6% e tyre dhe nuk janë pranuar 2 masa ose rreth 2.4% e tyre.

Sipas llojit ato paraqiten:

- Masa propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, janë rekomanduar 5 masa të cilat janë pranuar në masën 100%.
- Masa organizative, janë rekomanduar 80 masa nga të cilat janë pranuar 78 masa ose 97.5% dhe nuk janë pranuar 2 masa ose 2.5 %.

Në numër dhe në % statusi i zbatimit të totalit të masave ku përfshihen masat “Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi” dhe “Masa organizative”, paraqitet sipas tabelës vijon:

Tabela mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve në total:

Nr.	Statusi i masave të rekomanduara 6 Mujorine I-rë të vitit 2023	Në numër	Në %
1	Totali	85	100
2	Pa pranuar	2	2.4%
3	Pranuar	83	97.6
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar	33	39.8%
2	Zbatuar pjesërisht	17	20.5%
3	Në proces	15	18.1%
4	Pa zbatuar	18	21.6%

Nga 83 masa të pranuar gjithsej, janë zbatuar 33 masa ose 39.8%, zbatuar pjesërisht 17 masa ose 20.5%, në proces zbatimi 15 masa ose 18.1% dhe pazbatuar 18 masa ose 21.6% e tyre.

Sipas llojit të masave ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë vijon.

Nr.	“Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi”	Në numër	Në %
1	Totali	5	100%
2	Pa pranuar		0
3	Pranuar	5	100%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar	3	60%
2	Zbatuar pjesërisht	1	20%
3	Në proces	1	20%
4	Pa zbatuar		

Nr.	“Masa Organizative”	Në numër	Në %
1	Totali	80	100%
2	Pa pranuar	2	2.5%
3	Pranuar	78	97.5%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar	30	38.5%
2	Zbatuar pjesërisht	16	20.5%
3	Në proces	14	17.9%
4	Pa zbatuar	18	23.1%

Analizuar sipas llojit të masave të rekomanduara rezultojnë se:

- a. Janë rekomanduar gjithsej **5 masa për përmirësim ligjor** të pranuar nga subjektet e audituara. Nga të pranuarat (**5**) janë zbatuar plotësisht **3** masa ose **60%** të tyre, zbatuar pjesërisht **1** masa ose **20%**, në proces zbatimi **1** masa ose **20%**.
- b. Janë rekomanduar gjithsej **80 masa organizative** nga të cilat janë pranuar **78 masa** ose **97.5%** dhe nuk janë pranuar **2** masa ose **2.5%**.
Nga të pranuarat (**78**) janë zbatuar plotësisht **30** prej tyre ose **38.5%**, janë zbatuar pjesërisht **16** masa ose **20.5%**, janë në proces zbatimi **14** masa ose **17.9%**, dhe pazbatuar **18** masa ose **23.1%** e tyre.

Në përfundim, grupi i auditimit konkludoi se veprimtaria e 13 subjekteve të audituara, në drejtim të çështjeve që lidhen me zbatimin e rekomandimeve, nuk ka qenë plotësisht efektive.

Të analizuar dhe të detajuara sipas çdo subjekti dhe sipas llojit të masave të rekomanduara, niveli i zbatimit të tyre paraqitet si vijon:

1- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: : “REZERVA MATERIALE E SHTETIT NË SHËRBIM TË QYTETARIT”.

I. Përmbledhje EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 914 prot, datë 08.07.2024 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në gjashtë mujorin e parë të vitin 2023”, ushtroi auditim tematik në 2 (dy) subjektet pjesë e Auditimit të Performancës me temë: “Rezerva materiale e shtetit në shërbim të qytetarit”, përkatësisht: Ministrinë e Mbrojtjes dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit.

Auditimi i kryer në vitin 2023, kishte si periudhë auditimi nga data 01.01.2019 deri më datë 28.02.2023 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me Vendimin nr. 125 datë 25.07.2023 të Kryetarit të KLSH-së si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat nr. 1180/9 prot, dhe nr. 1180/10 prot., datë 26.07.2023. Auditimi u krye nga data 15.07.2024 deri më datë 16.08.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet e audituara përkatësisht MM dhe DPRMSH u mbajtën Akt-Verifikimet përkatëse të cilat janë regjistruar përkatësisht:

-Në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit Akt-Verifikimi nr. 1, datë 16.08.2024.

-Në Ministrinë e Mbrojtjes, Akt-Verifikimi nr. 2 datë 16.08.2024.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Nga auditimi u konstatua se,

-Ministria e Mbrojtjes ka miratuar nga titullari Programin e Punës për masat në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit duke e dërguar në KLSH me shkresën nr. 59/11, datë 15.08.2023 regjistruar në KLSH me nr. 1180/11 prot., kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

-Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit ka miratuar nga titullari Programin e Punës për masat në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit duke e dërguar në KLSH me shkresën nr. 59/16, datë 16.08.2023, regjistruar në KLSH me nr. 1180/12 prot., kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".
Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se:

-Ministria e Mbrojtjes nuk ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, mbi zbatimin e rekomandimeve.

-Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, mbi zbatimin e rekomandimeve, me shkresën nr. 59/31 datë 26.01.2024 administruan në KLSH me nr. 1180/13 prot., datë 29.01.2024.

3. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. nr.1180/9 prot., dhe nr. 1180/10 prot., datë 26.07.2023, janë rekomanduar gjithsej 25 masa:

Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore, 1 rekomandim.
Masa organizative, 24 rekomandime.

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, shkresave të përcjella në KLSH mbi planin e masave si dhe shpjegimet e paraqitura për secilin rekomandim në fazën e verifikimit të tyre, rezultoi se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.	1	1	0
2	Masa Organizative	24	24	0

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të evaduara në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve" miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 23.06.2020.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 914 prot., datë 08.07.2024. Rekomandimet e lëna në Raporti Përfundimtar i Auditimit të mëparshëm me temë "Rezerva materiale e shtetit në shërbim të qytetarit" me konkluzionet përkatëse janë miratuar me Vendimin nr. 125 datë 25.07.2023 të Kryetarit të KLSH-së dhe janë përcjellë në subjektet e audituara me shkresën nr.1180/9 prot., dhe nr. 1180/10 prot., datë 26.07.2023.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH-së, me përbërje:

1. E.K, përgjegjëse grupi
2. K.Xh, anëtar
3. M.L, anëtare

Auditimi ka filluar më, 15.07.2024

Auditimi ka përfunduar më, 16.08.2024

II.1. Objekti i auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të dërguar në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, me shkresat nr.1180/9 prot., dhe nr. 1180/10 prot., datë 26.07.2023.

II.2. Qëllimi i auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

II.4. Konkluzioni:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat e sipërcituara, rezulton se nga 25 (njëzetë e pesë) masa të rekomanduara gjithsej nga të cilat janë pranuar nga subjektet e audituara.

Nga masa e pranuar:

janë zbatuar 1 rekomandime ose 4% e tyre,

janë zbatuar pjesërisht 10 rekomandime ose 40% e tyre,

gjenden në proces zbatimi 5 rekomandime ose 20% e tyre,

gjenden pa zbatuar 9 rekomandime ose 36% e tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.	1			1	
2	Masa organizative	24	1	10	4	9
	Gjithsej	25	1	10	5	9

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.	Në numër	Në %
1	Totali	1	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	1	100%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht		
2	Zbatuar pjesërisht		
3	Në proces zbatimi	1	100%
4	Pa zbatuar		

Nr.	Masa Organizative	Në numër	Në %
1	Totali	24	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	24	100%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	1	4%
2	Zbatuar pjesërisht	10	42%
3	Në proces zbatimi	4	17%
4	Pa zbatuar	9	37%

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Pavarësisht nga puna e bërë dhe masat e marra, niveli i zbatimit të plotë të rekomandimeve është i ulët. Për disa nga masat organizative të lëna (institucionet) nuk kanë mundur të realizojnë tërësisht ato. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjektet e audituara për përmbushjen e rekomandimeve të lëna për garantimin e një menaxhimi efektiv dhe të sigurtë të rezervës materiale të shtetit.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Nga të dhënat e paraqitura gjatë auditimit prej subjekteve të audituara, përgjigjet me shkrim dhe dokumentacionit të tyre, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

4.2 Për pyetjen e auditimit. A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur në funksion të rezervës materiale të shtetit?

4.2.1 A i ka shërbyer mekanizmi i ngritur miradministrimit të rezervës materiale të shtetit?

1. Gjetje nga auditimi: Kuadri rregullator mbi të cilin bazohet administrimi i mjeteve shfaq disa dobësi dhe konkretisht, manuali i cili përcakton peshën reale fizike të mjeteve nuk trajton në asnjë rast pjesët jo-metalike të mjetit, të cilat transferohen së bashku me mjetin. Pavarësisht se Udhëzimi nr.1 datë 18.02.2015 i Këshillit të Ministrave përcakton një rend shterues për trajtimin e mjeteve, duke plotësuar fillimisht nevojat e rezervës materiale të shtetit dhe më tej në institucionet e tjera publike, por ende nuk disponohet një mekanizëm i qartë mbi adresimin e kërkesave dhe mënyrën e trajtimit të tyre. Veç sa më sipër, në udhëzimin e përbashkët midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj të Brendshme evidentohet se në rast se pas shitjes së mjetit të konfiskuar me gjobën e vendosur ka 49 një diferencë pozitive, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ia kthehen atë shkelësit, ndërsa në rastin që kjo diferencë është negative, vlera e shitjes konsiderohet si detyrim përfundimtar. Mekanizmi i kthimit të vlerave ende nuk rezulton të jetë bërë efektiv ndërsa sa i përket shuarjes së detyrimit, vlerësojmë se kjo është një kompetencë e cila vendoset me ligj për aq kohë sa penaliteti buron po nga ligji.

1.1 Rekomandimi:

Ministria e Mbrojtjes pas vlerësimit të situatës, të marrë masat e nevojshme për rishikimin e kuadrit ligjor e rregullator mbi administrimin e mjeteve të konfiskuara.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

DPRMSH në vlerësim të rekomandimit të lënë mbi administrimin e mjeteve ka vlerësuar se procesi i administrimit nga RMSH të sendeve/mallrave apo mjeteve që kalojnë në favor të shtetit si pasojë e konfiskimit nuk i shërbejnë misionit të saj i ka propozuar Ministrisë së Mbrojtjes me anë të Memos Nr.1274, datë 03.11.2023 ndërmarrjen e iniciativave të mëtejshme për shfuqizimin e Udhëzimit të Përbashkët Nr.127 Prot., datë 11.01.2019 të Ministrit të Brendshëm dhe Nr.1 Prot., datë 09.01.2019 të Ministrit të Mbrojtjes “Për procedurat e kalimit të automjeteve dhe motomjeteve nga mjediset e drejtorive vendore të policisë kufitare dhe migracionit, tek Drejtoritë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit”, si dhe Udhëzimit Nr.6, datë 17.05.2019 të Ministrit të Mbrojtjes “Për procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit”.

Ndërkohë deri në ligjërimin e iniciativave të ligjore të sipërcituara, DPRMSH ka ndërprerë procesin e administrimit nga Drejtoritë e Policisë të gjithë mjeteve që nuk i shërbejnë misionit të saj.

Lidhur me vjeljen e gjobave mjeteve të konfiskuara dhe shitura nga DPRMSH, nga ana jonë me shkresën Nr.59/25 prot., datë 03.10.2023 “Mbi zbatimin e detyrimeve ligjore në përfundim të procedurës së shitjes me ankand publik të mjeteve” i është përcjellë informacioni Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për mjetet e shitura dhe vlerën e tyre. Gjithashtu me shkresën Nr.59/26 prot., datë 03.10.2023 “Mbi zbatimin e detyrimeve ligjore nga rezervat materiale të shtetit në përfundim të procedurës së shitjes me ankand publik të mjeteve” janë orientuar drejtoritë rajonale të varësisë për marrjen e masave të nevojshme në zbatim të akteve nënligjore.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

B. MASA ORGANIZATIVE

4.1 Për pyetjen e auditimit: A ka një vizion të qartë mbi rezervën materiale të shtetit?

4.1.1 A është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm kuadri ligjor dhe rregullator?

1. Gjetje nga auditimi: Ministria e Mbrojtjes, si institucion politikë bërës, nuk ka një vizion të qartë për rezervën materiale të shtetit në përgjigje të përballimit të situatave me të cilat mund të përballet vendit dhe përmbushjen e misionit të saj. Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030, planifikuar në SKZHI 2015-2020, nuk ka një plan konkret veprimi , i cili të përfshijë rezervën materiale të shtetit. Direktivat e Ministrisë së Mbrojtjes, nuk janë zbërthyer në plane veprimi me objektiva të mirë përcaktuar dhe indikatorë të matshëm për rezervën materiale.

Rekomandimi:

1.1 Ministria e Mbrojtjes, të bëjë pjesë të strategjive sektoriale rezervën materiale të shtetit, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2023-2030 dhe Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Me shkresën Nr.59/28, datë 27.10.2023 “Kërkesë për përfshirjen e Rezervave Materiale të Shtetit pjesë të strategjive sektoriale”, DPRMSH i ka kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes përfshirjen e rezervave materiale të shtetit në programet politike si Strategjia Kombëtare për

Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030, planifikuar nga SKZHI 2015-2020, duke i siguruar një plan konkret veprimi RMSH.

Duke u nisur nga fakti që dy dokumentat e mësipërm ishin në fazën e miratimit dhe pjesmarrja ishte e pa mundur, ministria e mbrojtjes ju kërkoj institucioneve që planifikojnë dhe planifikimi përfshin fushën që mbulon RMSH, RMSH të jetë pjesë përbërëse e grupeve të punës.

Në email e datës 17.05.2024, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes ka kërkuar pjesmarrjen e RMSH për hartimin e Planit të Vazhdimësisë së Qeverisjes dhe Planit të Vazhdimësisë së Operacioneve, në zbatim të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, në të cilat do të përcaktohen procedurat e vazhdimin të qeverisjes në raste të emergjencave civile të dëmtimeve të rënda të infrastrukturës kritike dhe kur jo çdo gjë shkon sipas planit, me qëllim vazhdimin e aktivitetit ekonomik, ofrimin e shërbimeve bazë dhe plotësimin e nevojave bazë të popullsisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

2. Gjetje nga auditimi: Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit nuk kanë përmirësuar legjislacionin aktual për rezervën materiale të shtetit, referuar zhvillimeve të fundit për mbrojtjen civile.

Aktiviteti i rezervës materiale të shtetit mbështetet mbi akte rregullatorë të cilat nuk janë azhurnuar pas ndryshimeve të ndodhura lidhur me ndryshimin e përgjegjësisë nga Ministria e Brendshme të Ministria e Mbrojtjes.

Urdhri i Kryeministrit për strukturat e DPRMSH-së dhe DRRMSH-ve është zbatuar jashtë afateve ligjore të parashikuara dhe këto të fundit kryejnë aktivitetin e tyre mbi rregullore të parashikuara.

Rekomandimi:

2.1 Ministria e Mbrojtjes, të marrë masat e nevojshme për plotësimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me qëllim mirëfunksionimin e rezervës materiale të shtetit.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Është ngritur grupi i punës me Urdhrin Nr.1765, datë 26.09.2023 të Ministrit të Mbrojtjes “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar”. Në përfundim të takimeve të mbajtura nga grupi i punës është propozuar projektligj i ri për arsye të ndryshimit të ligjit ekzistues në më shumë se 70% të tij.

Me shkresën Nr.1496, datë 28.12.2023 DPRMSH ka përcjellë pranë Ministrisë së Mbrojtjes Projektligjin “Për rezervat materiale të shtetit” dhe Relacionin shoqërues të tij.

Me e-mailin e datës 10.01.2024 me Nr. 57 Prot., DPRMSH ka përcjellë në Ministrinë e Mbrojtjes vijimësinë e procedurave për Projektligjin dhe Relacionin shoqërues.

Me e-mailin e datës 19.01.2024 me Nr. 57/1 Prot., DPRMSH në vijim të takimit të mbajtur në Ministrinë e Mbrojtjes ka përcjellë Projektligjin dhe Relacionin shoqërues të përditësuar me ndryshimet e dakortësuara në takim.

Me e-mailin e datës 29.01.2024 me Nr. 57/2 Prot., DPRMSH në vijim të takimit të mbajtur me Ministrinë e Mbrojtjes ka përcjellë Projektligjin dhe Relacionin shoqërues me ndryshimet e dakortësuara në takim.

Me e-mailin e datës 30.01.2024 me Nr. 57/3 Prot., DPRMSH ka ridërguar në Ministrinë e Mbrojtjes Projektligjin dhe Relacionin shoqërues me ndryshimet në nenin 5 pika 8 lidhur me karakterin secret të Planit Strategjik Afatmesëm si dhe Planit Vjetor të Rezervave Materiale të Shtetit.

Me anë të Memos Nr. 57/4 Prot., datë 16.02.2024 të Sektorit Juridik në DPRMSH drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH është përcjellë emaili date 16.02.2024, “Mbi administrimin e emailit të datës 16.02.2024 administruar nga Drejtoria e Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes”.

Me anë të shkresës Nr. 1409 Prot., datë 01.03.2024 “Mbi projektligjin “Për rezervat materiale të shtetit” të Ministrisë së Mbrojtjes janë përcjellë disa propozime dhe komente.

Në vijim të tyre, nëpërmjet shkresës Nr. 57/6 Prot., datë 07.03.2024 “Ridërgim i projektligjit “Për rezervat Materiale të Shtetit” DPRMSH ka shprehur qëndrimin e saj lidhur me komentet e mësipërme.

Në vijim të takimit të mbajtur në DPRMSH, sipas dakortësisë për sa i përket disa ndryshimeve në përmbajtjen e neneve 14,16 dhe 21, Ministria e Mbrojtjes ka përcjellë me emailin e datës 03.04.2024 me Nr. 57/7 Prot., draftin e projektligjit më ndryshimet në dispozitat e përcaktuara më sipër, shoqëruar nga relacioni shpjegues.

Me shkresën Nr. 57/8 Prot., datë 05.04.2024 “Për disa ndryshime në projektligjin “Për rezervat Materiale të Shtetit” DPRMSH ka propozuar ndryshime në përmbajtjen e neneve 14,16 dhe 21 të projektligjit.

Me e-mailin e datës 11.04.2024 me Nr. 57/9 Prot., DPRMSH ka ridërguar Projektligjin dhe Relacionin shoqërues të tij duke evidentuar shtesat dhe ndryshimet.

Me e-mailin e datës 02.07.2024 me Nr. 57/10 Prot., janë përcjellë për vlerësim komentet e ministrive dhe strukturave të tjera në lidhje me projektligjin “Për rezervat material të shtetit”. Në vijim të tij DPRMSH ka vlerësuar cdo mendim dhe koment të dhënë duke përcjellë me emailin e datës 10.07.2024 projektligjin “Për rezervat material të shtetit dhe Relacionin shpjegues të projektligjit të reflektuar nga komentet e ministrive dhe strukturave të tjera. Në vijim të e-mailit është ridërguar relacioni shpjegues i ripunuar i projektligjit “Për rezervat material të shtetit”.

Pas miratimit të ligjit do të vijohet me hartimin akteve të tjera nënligjore parashikuar në dispozitat e projektligjit lidhur me organizimin dhe funksionimin e rezervës së shtetit.

Është ngritur grupi i punës me Urdhrin Nr.1767, datë 26.09.2023 të Ministrit të Mbrojtjes “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt strukturës dhe organikës të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtorive Rajonale në varësi të saj”. Për vijimin e punës së grupit të sipërcituar dhe dhënies së propozimeve konkrete bazuara në një analizë të domosdoshme për strukturën dhe organikën që do të nevojitet rezervës materiale të shtetit në vijim, duhet së pari të pritët miratimi i Projektligjit “Për rezervat materiale të shtetit” pjesë e dispozitave të së cilit është dhe miratimi i strukturës dhe organikës së institucionit në bazë të vizionit të ligjit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.**

4.1.2 A janë të qarta rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira?

3. Gjetje nga auditimi: Baza ligjore aktuale në përballimin e situatave emergjente nuk garanton qartësinë dhe detyrimet respektive të roleve, përgjegjësisë dhe kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile dhe institucioneve të tjera të cilat janë të përfshira në përballimin e situatave emergjente. Ligji Nr.9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i

ndryshuar dhe Ligji Nr.45, datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, krijojnë paqartësi të roleve dhe mbivendosje kompetencash. Nuk evidentohet përgjegjësia dhe mënyra e bashkëpunimit dhe koordinimit mes dy institucioneve të përfshira, të cilat veprojnë veçmas referuar kuadrit ligjor aktual, në përballimin e situatave të parashikuara.

Rekomandimi:

3.1 Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet një grupi pune, të kryejë vlerësimin e roleve dhe përgjegjësive të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit dhe Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile për qartësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor të këtyre institucioneve.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Me shkresën Nr.59/29, datë 27.10.2023 “Kërkesë për bashkëpunim, mbi përcaktimin e roleve të DPRMSH, AKMC si institucione të përfshira në procesin e ndërhyrjes së menjëherëshme për përballimin e situatave emergjente”, DPRMSH i ka parashtruar Ministrisë së Mbrojtjes pozicionin që ka rezerva materiale e shtetit në përballimin situatave emergjente dhe shprehur gatishmërinë për të siguruar kontributin e saj dhe pjesëmarrjen e nevojshme në strukturat apo grupet e punës që do të ngrihen nga kjo e fundit në zbatim të këtij rekomandimi.

Në vijim të argumentimit të rekomandimit tuaj mbi reolet dhe përgjegjësitë të RMSH dhe të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në qartësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor të këtyre dy institucioneve ju bëjmë me dije se:

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile bazuar në ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile” ka për mision “Mbrojtja civile synon krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t’u rimëkëmbur, nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë”. Pra siç shihet nga misioni por dhe nga fryma e ligjit në tërësi, AKMC-ja dhe të gjitha institucionet dhe strukturat të parashikuara në ligj përbëjnë sistemin e mbrojtjes civile, me detyra specifike për çdo institucion ku bën pjesë dhe rezerva Materiale e Shtetit.

Në situatat e tjera si gjendja e luftës, gjendja e jashtzakonshme, çrregullimi I tregut etj, legjislacioni shqiptar parashikon ngritjen e strukturave të posaçme jo të përherëshme për menaxhimin e këtyre situatave në të cilat marrin pjesë institucionet shtetërore dhe RMSH.

Në pojektligjin e ri të RMSH, në nenin “7”, “Përdorimi” janë përcaktuar rrastet e përdorimit të RMSH, në zbatim të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht:

Rezervat materiale të shtetit përdoren për nevoja të furnizimit në raste:

të gjendjes së luftës dhe akteve terroriste;

të gjendjes së jashtëzakonshme;

të fatkeqësive natyrore, fatkeqësive të tjera, emergjencave civile si pasojë e këtyre të dyjave si dhe të çrregullimit të tregut;

ç) të dhënies së ndihmave humanitare shteteve tjera të dëmtuara sipas normave të së drejtës ndërkombëtare ose akteve të tjera nënligjore.

Në nenin “8”, “Shpërndarja”, përcakton anën procedurale të funksionimit të rezervës materiale të shtetit gjatë rasteve të përcaktuara në nenin 7 për shfrytëzimin e saj.

Në këtë nen përcaktohet se Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit si strukturë zbatuese e detyrave të dhëna në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 6 të projektligjit, duke i specifikuar në nënparagrafë pozitive zbatuese të DPRMSH-së, të vendimeve të strukturave e posaçme, të përherëshme dhe jo të përherëshme që krijohen bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe në akte të tjera ligjore për menaxhimin e situatave të gjendjes së luftës dhe akteve të ndryshme

terroriste, të gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive të tjera. Këto struktura krijohen dhe funksionojnë me akte ligjore të veçanta.

Përfundimisht për situata të emergjencave civile vendore apo rajonale, të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen civile, Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit vlerëson dhe shpërndan vetë (pa një akt nënligjor nga një strukturë tjetër e posaçme) mallrat rezervë shteti, duke kërkuar nga struktura koordinuesve vendore (kryetari i bashkisë) dhe rajonale (prefekti) evidentimin e rrethanave në të cilat është përcjellë kërkesa për furnizim, me qëllim garantimin e objektivitetit në trajtimin e kërkesave për ndihmë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.**

4. Gjetje nga auditimi: Ligji nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, ka mbivendosje me Ligjin nr.34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar lidhur me administrimin e mallrave të sekuestruara dhe konfiskuara. Nga auditimi rezultoi se, vendimet gjyqësore të marra lidhur me pasuritë/mallrat e konfiskuara ose sekuestruara si rezultat i kryerjes së veprave penale në disa raste adresohen pranë Rezervës Materiale të Shtetit dhe në raste të tjera pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, ndërkohë që ky i fundit është institucioni i posaçëm për këtë qëllim.

Rekomandimi:

4.1 Ministria e Mbrojtjes ti drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor për të unifikuar praktikën e vendimeve gjyqësore për konfiskimet dhe sekuestrimet e pasurive dhe mallrave që vijnë si rezultat i veprave penale drejt institucionit të posaçëm të krijuar për këtë qëllim.

Menjëherë

Përgjigja e subjektit të audituar:

Në projektligjin e propozuar nga rezervat materiale të shtetit pjesë e risive të propozuara është sanksionimi në ligj i dispozitës sipas së cilës “mallrat rezervë materiale shtetërore përbëhen midis të tjerash nga mallra të konfiskuara të cilat kanë vlerë përdorimi për rezervën e shtetit”. Në kuptim të këtij propozimi DPRMSH do të administrojë mallra të konfiskuara që i shërbejnë misionit të saj dhe mund të jenë ose jo pjesë e nomenklaturës. Në të gjitha rastet mallrat e administruara nga konfiskimi do të shërbejnë vetëm për plotësimin e nevojave të rezervës dhe vihen në funksion të misionit të saj dhe jo më ti nënshtrohen procedurave të shitjes apo tjetërsimit sikurse është proceduar deri më tani. Ky propozim synon të shmangë mbivendosjet me ligjin Nr.34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara". Ndërkohë deri në miratimin e ndryshimeve ligjore, DPRMSH bazuar në misionin e saj ka udhëzuar institucionet shtetërore prej të cilave janë administruar deri më tani mallra të konfiskuara duke i orientuar se procesi i administrimit do të vijojë vetëm për ato mallra që i shërbejnë rezervës së shtetit, pjesa tjetër nuk do merret në dorëzim. E njëjta gjë është bërë edhe lidhur me administrimin e mjeteve nga Drejtoritë e Policive, duke iniciuar për këto të fundit ndryshimet ligjore të evidentuara në rekomandimet e lëna më poshtë lidhur me mjetet.

Nëpërmjet Memos Nr. 1274 Prot., datë 03.11.2023 “Mbi pamundësinë objektive të zbatimit në vijim të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 127 Prot., datë 11.01.2019 të Ministrit të Brendshëm dhe Nr.1 Prot., datë 09.01.2019 të Ministrit të Mbrojtjes “Për procedurat e kalimit të automjeteve dhe motomjeteve nga mjediset e drejtorive vendore të policisë kufitare dhe migracionit, tek Drejtoritë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit”, si dhe Udhëzimit Nr. 6, datë 17.05.2019 të Ministrit të Mbrojtjes “Për procedurat që ndiqen për administrimin e

automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit”” ku DPRMSH kërkon bashkëpunimin e Ministrisë së Mbrojtjes për ndërprerjen e administrimit të mjeteve nga Drejtoritë Vendore të Policisë.

Me anë të shkresës Nr. 1286 Prot., datë 06.11.2023 “Mbi administrimin e mallrave që vijnë nga konfiskimet apo kryerja e veprave penale” DPRMSH udhëzon drejtoritë rajonale mbi mosmarrjen në dorëzim të mallrave të cfarëdolloj natyre (mjete, industriale, ushqimore, medikamente etj.) që vijnë nga konfiskimet apo kryerja e veprave penale, të cilat nuk i shërbejnë misionit të rezervave Materiale të Shtetit.

Ministria e Mbrojtjes me shkresën Nr. 979 Prot., datë 13.02.2024, protokolluar me tonën Nr. 362 Prot., datë 28.02.2024 ka përcjellë shkresën Nr. 11/3 Prot., datë 12.02.2024 “Kthim përgjigje” të Ministrisë së Brendshme. DPRMSH me shkresën Nr. 362/1 Prot., datë 01.03.2024 “Kthim përgjigje” ka shprehur sërish qëndrimin e saj.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.**

5. Gjetje nga auditimi: VKM nr.1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se lista përbërëse e mallrave rezervë, në lloje dhe sasi, e ndarë sipas grupeve, si dhe kufiri minimal për secilin artikull të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.³⁹ Lista me nomenklaturën e mallrave rezervë shteti e cila përmban gjendjen orientuese të tyre si dhe sasinë limit i detyrueshëm, është e publikuar, duke mos garantuar në këtë mënyrë ruajtjen e karakterit sekret sipas përcaktimit ligjor.

Rekomandimi:

5.1 Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, të kryejë analizë dhe vlerësim të karakterit sekret të nomenklaturës, gjendjes dhe sasive të rezervës materiale të shtetit me qëllim qartësimin e mënyrës së funksionimit të proceseve në ruajtjen e këtij karakteri apo dhe ndërmarrjen e nismave të nevojshme ligjore për rregullimin e tij.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Është ngritur grupi i punës me Urdhrin Nr.1766, datë 26.09.2023 të Ministrit të Mbrojtjes “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektvendimit “Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr.1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, i ndryshuar”, ndërkohë referuar projektligjit “Për rezervat materiale të shtetit” është parashikuar miratimi i VKM për hartimin e planit strategjik afatmesëm (3 vjeçar) që do të sanksionojë midis të tjerash krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë shteti. Gjithashtu në projektligj është sanksionuar karakteri sekret i listës së mallrave rezervë shteti, nomenklaturës, kurse sasinë limit minimal, maksimal dhe gjendja do të kenë karakter sekret sipas legjislacionit në fuqi. Për sa më sipër duhet që së pari të miratohet projektligji i sipërcituar për të vijuar me hartimin e akteve nënligjore.

Drejtoria e Përgjithshme e RMSH, bazuar në karakterin sekret që kanë dhe do të kenë mallrat rezervë shteti, referuar pikës 4 të nenit 5 të ligjit Nr. 9900, datë 10.04.2008 “nomenklatura, sasia dhe gjendja e mallrave rezervë shtetërore, ka karakter sekret”, rekomandimit tuaj për marrjen e masave për garantimin e karakterit sekret të nomenklaturës, gjendjes e sasisë të mallrave rezervë shtetërore dhe ligjit Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, DPRMSH i është drejtuar Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura me shkresën Nr. 953 Prot., datë 08.08.2023 “Kërkesë për pajisje të personelit me CSP”, ku ka kërkuar

bashkëpunimin e tyre për pajisjen e personelit të evidentuar në tabelën bashkëlidhur me Certifikatat e Sigurisë së Personelit (CSP).

Në vijim të Urdhrit Nr. 2573, datë 29.12.2023 të Ministrit të Mbrojtjes “Për miratimin e listës së funksioneve organike që, për shkak të detyrës zyrtare, mund dhe duhet të njihen me informacion të klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO-s dhe Bashkimit Evropian, të prodhuar nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave të Armatosura ose/dhe të përfutur në kuadrin e bashkëpunimit dy ose shumëplanësh me shtete dhe organizata ndërkombëtare” dhe Urdhrit Nr. 39, datë 02.02.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH “Për zbatimin e urdhrit Nr. 2573, datë 29.12.2023 të Ministrit të Mbrojtjes mbi pajisjen me CSP të DPRMSH dhe drejtorive rajonale të varësisë” DPRMSH dhe DRRMSH të varësisë kanë plotësuar dokumentacionin e kërkuar të pyetësorit të sigurisë. Dokumentacioni i të gjithë punonjësve i është përcjellë institucionit përgjegjës, SHPFA përmes shkresave të kufizuara.

Në zbatim të këtij rekomandimi, një pjesë e konsiderueshme e personelit të DPRMSH dhe DRRMSH rajonale të varësisë janë të pajisur me CSP ndërsa pjesa tjetër e personelit ndodhet në proces pajisjeje me CSP.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.**

6. Gjetje nga auditimi: Struktura aktuale e rezervës materiale të shtetit është jo e plotë dhe e pamjaftueshme për të përmbushur qëllimin për të cilin është krijuar. Organika e miratuar nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit Nr.63, datë 12.04.2018 ” Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtorive Rajonale”, pasoi me dinamikë e lëvizjeve të personelit si lëvizje paralele, ngritje në detyrë, largim me dorëheqje, pezullim nga shërbimi civil etj., ka krijuar një numër të konsiderueshëm pozicionesh vakante, gjithsej 14 punonjës.

Rekomandimi:

6.1 Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, të kryejë analizë dhe vlerësim të strukturës aktuale të rezervës materiale, si në nivel qendror ashtu edhe rajonal referuar qasjes institucionale që rezerva materiale e shtetit do të ketë.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Sikurse sqaruar më sipër, rekomandimet lënë nga juaj për ndryshimet e strukturës nisur nga vlerësimi i strukturës aktuale, do të gjejnë zbatim në momentin e hartimit të projekt strukturës së DPRMSH pas miratimit të projektligjit “Për rezervat materiale të shtetit”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

7. Gjetje nga auditimi: Emërtimet e Drejtorive Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, Shkodër, Dibër, Fier, nuk kanë vendndodhje të njëjtë sipas emërtesës duke shkaktuar konfuzion gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Rekomandimi:

7.1 Ministria e Mbrojtjes të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ndryshimin e emërtimeve të drejtorive rajonale, të cilat nuk përkojnë me vendndodhjen e tyre reale.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Në momentin e hartimit të projekt strukturës do të mbahet në konsideratë edhe nevoja për ndryshimin e emërtimeve të drejtorive rajonale sipas vendndodhjes së tyre aktuale.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**.

8. Gjetje nga auditimi: Në Rezervat Materiale të Shtetit konstatohet një numër i lartë drejtuesish me funksione të komanduara në tejkalim të afateve të përcaktuara.

Pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit gjendet i komanduar prej disa vitesh, ndërsa shkresa për ngarkim të detyrave nuk është në përputhje me kuadrin ligjor.⁴¹

Pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit Tiranë, është i komanduar prej disa vitesh;

Ndërkohë pozicionet e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Shkodër dhe Korçë janë emërime të përkohshme, respektivisht prej vitit 2020 dhe vitit 2021.

Rekomandimi:

8.1 Ministria e Mbrojtjes të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit si edhe drejtorëve rajonalë, të cilët rezultojnë të komanduar ose me emërim të përkohshëm, në tejkalim të afateve të përcaktuara.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Lidhur me plotësimin e pozicionit të Drejtorit të Përgjithshëm, sajë praktikës së përcjellë nga ana juaj por edhe nga DPRMSH është bërë e mundur përcjellja e këtij rekomandimi pranë strukturës së cilës i adresohet zbatimi i tij. Në vijim të kërkesave të sipërcituara drejtuar DAP, theksojmë së; Pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit është vakant dhe nuk është shpallur akoma nga DAP.

Pozicioni i Drejtorit në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë vazhdon të jetë vakant, si rrjedhojë e përfundimit të procedurës së shpalljes pa fitues,

Në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Shkodër është emëruar znj. L.M.

Pozicioni i Drejtorit në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Korçë, është shpallur fituesi dhe pritët vijimi me aktin e emërimit nga DAP dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Sa më sipër moszbatimi në kohë i këtij rekomandimi (plotësimi e vendeve vakante) vjen për shkak të tejkalimit të kompetencave të DPRMSH, për zbatimin të tij.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar**.

9. Gjetje nga auditimi: Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit dhe drejtorive rajonale prej një kohe të gjatë paraqitet me disa pozicione vakante. Propozimet e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit për ndryshimin e strukturës aktuale nuk kanë qenë tërësisht në funksion të rritjes së efektivitetit të rezervës materiale të shtetit dhe performancës së institucionit. Ministria e Mbrojtjes nuk ka marrë në konsideratë propozimet e kryera për ndryshimin e strukturës së rezervës materiale të shtetit.

Brenda vitit 2023

Rekomandimi:

9.1 Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në të gjitha nivelet.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Plotësimi i vendeve vakante ka vijuar pjesërisht për pozicionet e nivelit ekzekutiv. Nga DPRMSH i janë dërguar disa herë kërkesë DAP për të vijuar me publikimin e pozicioneve vakante, ashtu sikurse edhe shkresa pranë Ministrisë Mbrojtjes për të nxitur ecurinë e këtij procesi, konkretisht:

Shkresa Nr. 569 Prot., datë 11.05.2023 “Kërkesë për publikim pozicionesh vakante”,

Shkresa Nr. 1127 Prot., datë 26.09.2023 “Kërkesë për bashkëpunim për plotësim të pozicioneve vakante”,

Shkresa Nr. 1381 Prot., datë 01.12.2023 “Kërkesë për plotësim të pozicioneve vakante”,

Shkresa Nr. 1396 Prot., datë 05.12.2023 “Kërkesë për plotësim të pozicioneve vakante të nivelit ekzekutiv në DPRMSH, nga lista fituese”.

Në fund të vitit 2023 organika rezulton të jetë e paplotësuar pavarësisht iniciativave të sipërcituara.

Gjatë janarit të vitit 2024 i janë ridërguar DAP dhe Ministrisë së Mbrojtjes shkresa mbi Planin e nevojave për rekrutim për vitin 2024 duke i theksuar nevojën e ngutshme për plotësimin e tyre. DPRMSH i është drejtuar DAP dhe Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën Nr. 49 Prot., datë 09.01.2024 “Përcjellje e planit të nevojave për rekrutim për DPRMSH, për vitin 2024” dhe Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën Nr. 53 Prot., datë 10.01.2024 “Kërkesë për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese”.

Në vijim të tyre DPRMSH ka informuar vazhdimisht DAP mbi vakancat e pozicioneve të punës si pasojë e lëvizjeve paralele të tyre, dorëheqjeve apo pezullimit të statusit civil, konkretisht;

Shkresa Nr. 33 Prot., datë 08.01.2024 “Informacion mbi vakancën e pozicionit “specialist finance në Sektorin e Financës në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë”,

Me emailin date 16.02.2024 me Nr. 291 Prot., ku kërkohet informacion i përditësuar për situatën në burimet njerëzore, duke përfshirë vakancat, pozicionet që janë dërguar për shpallje, pozicionet që janë shpallur dhe janë në afat pritjeje etj nga Ministria Mbrojtjes,

Shkresa Nr. 628 Prot., datë 29.04.2024 “Kërkesë për plotësim të pozicioneve vakante”,

Shkresa Nr. 665 Prot., datë 08.05.2024 “Informacion mbi vakancën e pozicionit “specialist në Drejtorinë Teknike të Standarteve dhe Cilësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit”,

Shkresa Nr. 670 Prot., datë 09.05.2024 “Informacion mbi vakancën e pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit”, si pasojë e emërimit të znj. A.D në këtë pozicion sipas Urdhrit Nr.79, datë 28.03.2024 “Për fillimin e marrëdhënieve të punës sipas aktit Nr. 1320/84 Prot., datë 05.03.2024 të DAP” dhe Urdhrit Nr. 100, datë 09.05.2024 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në vijim të Vendimit Nr. 1, datë 09.05.2024 të DMBNJ&SH “Për deklarimin e shkakut të pezullimit nga shërbimi civil””.

Shkresa Nr. 692 Prot., datë 14.05.2024 “Dërgim informacioni për vendet vakante në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit”,

Për sa më sipër, DAP ka vijuar me shpalljen e disa prej pozicioneve vakante në DPRMSH, ku janë emëruar disa nëpunës civil ndërsa shpallje të tjera mbeten në afat pritjeje deri në përfundim të procedurave:

Shpallja me kod 4902: Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike” niveli minimal i diplomës “Bachelor”, përfunduar pa fitues.

Shpallja me kod 4929: Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike/ Juridike” niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, përfunduar pa fitues.

Shpallja me kod 4930: Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike/ Juridike” niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, përfunduar pa fitues.

Shpallja me kod 5925: Lloji i diplomës “Shkenca Juridike” niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, emëruar z. J.H në pozicionin e Specialist jurist pranë Sektorit Juridik në DMBNJ&Sh në DPRMSH me Urdhër nr. 46, datë 14.02.2024 “Për fillimin e marrëdhënieve të punës sipas aktit Nr. 939 Prot., datë 09.02.2024 të Departamentit të Administratës Publike”.

Shpallja me kod 6236: Lloji i diplomës “Inxhinieri Mekanik/Inxhinieri Materiale” niveli minimal i diplomës “Bachelor”, vijon procedura.

Shpallja me kod 6237: Lloji i diplomës “Kimi/ Teknologji Ushqimore” niveli minimal i diplomës “Bachelor”, vijon procedura.

Shpallja me kod 6238: Lloji i diplomës “Shkenca Juridike” niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, vijon procedura.

Shpallja me kod 6239: Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike/ Juridike” niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, vijon procedura.

Shpallja me kod 6248: Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Shkodër, emëruar znj. L.M në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Shkodër” me Urdhër nr. 146, datë 16.07.2024 “Për fillimin e marrëdhënieve të punës sipas aktit Nr. 3869 Prot., datë 15.07.2024 të Departamentit të Administratës Publike”.

Shpallja me kod 6248: Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Korçë, shpallur fitues, pritet akti i emërimit dhe Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm.

Shpallja me kod 6250: Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë, përfunduar pa fitues.

Shpallja me kod 6279: Tiranë/Durrës/Vlorë/Mat – Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike” niveli minimal i diplomës “Bachelor”, emëruar z. D.L në pozicionin e Specialist në Sektorin e Financës në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë me Urdhër nr. 142, datë 04.07.2024 “Për fillimin e marrëdhënieve të punës sipas aktit Nr. 3579 Prot., datë 03.07.2024 të Departamentit të Administratës Publike”.

Shpallja me kod 6315: Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, vijon

Shpallja me kod 6316: Lloji i diplomës “Inxhinieri Mekanik/Inxhinieri Materiale” niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, vijon procedura.

Shpallja me kod 6237: Lloji i diplomës “Kimi/ Teknologji Ushqimore” niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, vijon procedura.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

10. Gjetje nga auditimi: Sistemi i komunikimeve elektronike zyrtare i Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe drejtorive rajonale, funksionon nëpërmjet adresave personale dhe jo brenda rrjetit Gov-Net.

Rekomandimi:

10.1 Ministria e Mbrojtjes të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm ligjorë për përfshirjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe njësisë të varësisë brenda rrjetit Gov-Net, me qëllim garantimin e sigurisë në komunikimet elektronike.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

DPRMSH ka ndjekur në vijim zbatimin e këtij rekomandimi duke kërkuar bashkëpunimin e AKSHIT për hapjen e adresave zyrtare të personelit nëpërmjet shkresës Nr. 942 Prot., datë 07.08.2024 “Kërkesë për hapje të domain zyrtar”. Sa më sipër në vijim të orientimeve lënë nga AKSHI në shkresën e tyre Nr.4167/1 Prot., datë 18.08.2023, nga ana jonë janë kryer veprimet paraprake dhe me shkresën Nr.113, datë 17.01.2024 “Mbi hapjen e adresave elektronike zyrtare” është kërkuar vijimi i procesit të hapjes së adresave zyrtare. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtoritë në varësi të saj janë informuar me anë të shkresës Nr. 113/1 Prot., datë 01.02.2024 “Mbi pajisjen me adresa zyrtare të personelit të DPRMSH dhe Drejtorive të varësisë” konfirmuar nga AKSHI me shkresën Nr. 363/1 Prot., datë 01.02.2024 “Kthim përgjigje”.

Sa më sipër moszbatimi në kohë i këtij rekomandimi vjen për shkak të tejkalimit të kompetencave të DPRMSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

4.2 Për pyetjen e auditimit. A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur në funksion të rezervës materiale të shtetit

4.2.1 A i ka shërbyer mekanizmi i ngritur miradministrimit të rezervës materiale të shtetit?

11. Gjetje nga auditimi: Gjendja e mallrave rezervë materiale shtetërore është nën kufijtë e përcaktuara në VKM nr.1128 datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, e ndryshuar, çka ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përgjigjen ndaj përballimit të situatave jo të zakonshme me të cilat mund të përballet vendi.

Për artikujt e grupit A: “Mjete të rënda për çdo lloj transporti” gjendja është nën vlerat orientuese dhe kufirin minimal dhe për artikullin “Grurë” gjendja është zero.

Për artikujt e grupit B: “Mjete të vogla lundrimi, dhe Karburante”, gjendja është zero, ndërsa për automjete të tonazhit të ulët nën 10 ton, gjendja është nën vlerat orientuese dhe kufirin minimal.

Për artikujt e Grupit C: nga 22 artikuj, 20 prej tyre janë me diferenca, mungesa jo vetëm të gjendja orientuese e mallrave (sasia) por edhe nën vlerat e kufijve minimal të përcaktuara në VKM.

Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje për disa mallra është zvogëluar. Diferencat nga limiti minimal për një pjesë të konsiderueshme mallrash janë të ndjeshme. Rezerva materiale e shtetit nuk garanton nevojat e qytetarëve në përballimin e rasteve të emergjencave civile dhe rasteve të tjera të parashikuara.

Rekomandimi:

11.1 Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit në bashkëpunimin me Ministrinë e Mbrojtjes të marrin masa për plotësimin e sasisë së mallrave sipas përcaktimeve në VKM nr.1128 datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, e ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit të audituar:

Në zbatim të këtij rekomandimi Grupi i Menaxhimit Strategjik në DPRMSH ka kryer evidentimin e listës së mallrave pjesë të nomenklaturës së rezervës materiale të shtetit, sasia e

të cilave paraqitet nën limitin minimal të përcaktuar me VKM Nr.1128/2008 apo dhe sasisë optimale/maksimale të cilat vlerësohen të nevojshme për përballimin e situatave të parashikuar në Ligjin 9900/2008. Për sa më sipër DPRMSH me shkresën Nr.2/1 Prot., datë 24.10.2023 “Kërkesë për akordimin e fondeve buxhetore me qëllim plotësimin e nevojave të DPRMSH me artikuj rezervë shteti, sipas përcaktimeve të VKM Nr.1128, datë 05.08.2008” (sekret) i është drejtuar Ministrit të Mbrojtjes duke kërkuar fond buxhetor për plotësimin e nevojave me mallra ushqimore dhe industriale rezervë shteti. Nga komunikimet e marra me Ministrinë e linjës nevoja për fondet buxhetore të paraqitura nga DPRMSH do të mbahet në konsideratë për një periudhë disavjeçare me qëllim akordimin pjesë pjesë të vlerës së kërkuar të fondit në pamundësi të akordimit të menjëhershëm të tij.

Në shkresën Nr.20692/1 Prot., datë 23.11.2023 të Ministrisë së Financave “Mbi kërkesën për rishpërndarje të fondeve në Projektbuxhetin 2024 të Ministrisë së Mbrojtjes”, administruar me Nr.6202 Prot., datë 30.11.2023 në Ministrinë e Mbrojtjes (përcjellë për njohje me email në DPRMSH) Ministria e Financave ka sqaruar arsye e pamundësisë objektive të akordimit të fondeve buxhetore për plotësimin e limitit minimal të mallrave rezervë shteti.

Sa me sipër e ne vijim te përmbushjes se Misionit dhe Qëllimit te kësaj Organizate nga strukturat përgjegjëse te Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit janë preventivuar dhe planifikuar vlerat përkatëse për çdo mall dhe ajo totale për mallrat Rezervë Shteti sipas nomenklaturës së përcaktuar në VKM- 1128/2008 dhe Ligjit 9900/2008.

Pas përcaktimit të kërkesave nevojave DPRMSH ka vijuar me hartimin e kërkesave buxhetore në dy nivele:

Hartim i kërkesave buxhetore mbështetur në tavanet e miratuara gjatë fazës së parë të hartimit të PBA-së 2025-2027.

Hartimi i kërkesave buxhetore mbi limit për tre vjeçarin e ardhshëm 2025/2027.

Për sa i takon nivelit të parë, bazuar në tavanet buxhetore të miratuara në fazën e parë të PBA-së 2025-2027, nga EMP ngritur me urdhër nr.17 datë 15.01.2024, ndryshuar me Urdhër nr.123, datë 03.06.2024, është bërë një analizë e kujdesshme në lidhje me përcaktimin e saktë të mallrave të cilat do të prokurohen në vitet në vazhdim sipas tavanëve të përcaktuar nga Ministria e Financave, tavanet e cilat janë në përpjestim të zhdrejtë me kërkesat tona për mallra Rezervë Shtetit, në funksion të plotësim të nomenklaturës së mallrave rezervë shteti. Nga EMP është analizuar saktë gjendja aktuale e këtyre mallrave në magazinë, janë marrë në referencë eksperiencat e mëparshme në lidhje me qarkullimin e mallrave dhe më pas janë përcaktuar sasisë respektive të mundshme për tu realizuar sipas tavanëve buxhetore të miratuara në fazën e parë të hartimit të PBA-së 2025-2027.

Për sa i përket nivelit të dytë të lartë përmendur nga EPM është përcaktuar më përafërsi vlera totale e detyrueshme për plotësimin e sasisë Optimale me mallra Rezervë e Shtetit në zbatim të VKM-së 1128/2008 dhe Ligjit 9900/2008, Sasia dhe vlera e artikujve pjesë të nomenklaturës rezerve shtetit janë paraqitur si kërkesa shtesë mbi tavanet e miratuara në fazën e parë të përgatitjes së PBA-së 2025-2027. Dokumentacioni i përgatitjes së kërkesave buxhetore 2025-2027 është përcjellë në Ministrinë e Mbrojtjes me Shkresën nr.581/5 prot., datë 25.04.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

12. Gjetje nga auditimi: Gjendjet orientuese dhe kufijtë minimal për produktet bazë janë mbajtur në të njëjtat nivele që prej vitit 2008, duke mos reflektuar dinamikën e zhvillimit dhe situatat me të cilat është përballur vendi vitet e fundit si tërmeti i vitit 2019, pandemia globale etj. Ndryshimet në nomenklaturën e mallrave rezervë shteti, janë kryer mbi një kuadër rregullator të parashikuar së fundmi për mbrojtjen civile dhe pa një metodologji të caktuar,

referuar rëndësisë, burimeve të financimit, ndryshimit të numrit të popullsisë, ndryshimeve demografike, etj.

Rekomandimi:

12.1 Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit të marrin masa për rishikimin e nomenklaturës, sasisë dhe gjendjes së mallrave rezervë shteti mbi bazën e një metodologjie të mirë përcaktuar, me qëllim garantimin e nevojave të qytetarëve në rastet e situatave jo të zakonshme.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Zbatimi i këtij rekomandimi do të mbahet në konsideratë gjatë hartimit të Planit Strategjik Afatmesëm (3 vjeçar) të DPRMSH që zëvendësojë VKM aktuale Nr.1128/2008. Sa më sipër në momentin e përcaktimit të listës emërore të mallrave rezervë shteti do të kryhet një analizë më e thelluar e nevojave konkrete për rastet e përcaktuara në ligj të ndërhyrjes së rezervës së shtetit, si dhe për përcaktimin e sasive minimale dhe maksimale do të kihet parasysh ndryshimi i numrit të popullsisë, ndryshimet demografike e faktorë të tjerë me impakt në këtë fushë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pa zbatuar**.

13. Gjetje nga auditimi: Rezerva materiale e shtetit ka 25 prona të paluajtshme të regjistruara pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ndërsa për 27 të tjera të cilat përbëhen nga 933,690 m² “Troje” dhe 58,989 m² “Ndërtime” procesi i regjistrimit nuk rezulton të ketë përfunduar. Këto prona shtrihen në të gjitha drejtoritë rajonale. Pjesa më e madhe e pronave të paregjistruara në numër dhe sipërfaqe paraqitet në Drejtorinë Rajonale, Tiranë e cila rezulton me 18 të tilla dhe Korçë me 4 prona. Pronat nën përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit janë të përcaktuara qartësisht në VKM nr. 413 datë 11.07.2007, i ndryshuar. Zgjatja e procesit të regjistrimit, burimet njerëzore dhe financiare të kufizuara për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre krijojnë risk të lartë për dëmtimin dhe tjetërsimin e këtyre aseteve pasuri kombëtare.

Rekomandimi:

13.1 Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet një grupi pune, të verifikojë problematikat e hasura për mos regjistrimin e pronave nën administrimin e rezervës materiale të shtetit dhe të ndërmarrë veprimet përkatëse për adresimin e tyre.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Gjatë viti 2023 DPRMSH në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe DVASHK përkatëse ka vijuar procesin e regjistrimit të pasurive të paregjistruara të rezervës së shtetit. Deri në qershor të vitit 2024 rezultojnë të regjistruara 36 Agjenci 17 të paregjistruara.

Nr.	AGJENCITE	VENDNDODHJ A	STATUSI JURIDIK I PRONËS			SHËNIME
			REGJIST RUAR	VËRTETIM HIPOTEKOR	PA REGJISTRUA R	
I	DRRMSH Tiranë					

1	Agjencia Lunder	Njësia Administrative Farkë-Tiranë				VKM NR. 808, datë 12.12.2022 "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga DPRMSH te FSHZH"
2	Parku	Bashkia Tirane-Tiranë	Regjistruar			
3	Dyqani Sauk	Bashkia Tirane-Tiranë	Regjistruar			
4	Agjencia Petrelë	Njësia Administrative Petrelë-Tiranë	Regjistruar			VKM NR. 249, date 24.04.2024 "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga DPRMSH te FSHZH"
5	Agjencia Grecë	Njësia Administrative Pezë-Tiranë	Regjistruar			
6	Agjencia Mnerë	Njësia Administrative Zall-Bastar - Tiranë			Pa regjistruar	
7	Agjencia Linos	Njësia Administrative Shëngjergj - Tiranë	Regjistruar			
8	Agjencia Tujan	Njësia Administrative Dajt - Tiranë	Regjistruar			
9	Agjencia Noje	Njësia Administrative Çudhi - Krujë			Pa regjistruar	
10	Agjencia Halilaj	Bashkia Fushe-Kruje - Krujë			Pa regjistruar	
11	Agjencia Buron	Njësia Administrative Nikel - Krujë			Pa regjistruar	
12	Agjencia Labinot	Njësia Administrative Labinot Fushe - Elbasan		Vërtetim hipotekor		
13	Agjencia Shushicë	Njësia Administrative Shushicë - Elbasan			Pa regjistruar	
14	Agjencia Shals	Njësia Administrative Shals - Elbasan	Regjistruar			
15	Agjencia Gjinar	Njësia Administrative Gjinar - Elbasan	Regjistruar			
16	Agjencia Shtemaj	Njësia Administrative Bradashesh -			Pa regjistruar	

		Elbasan				
17	Agjencia Shijon	Njësia Administrative Bradashesh - Elbasan	Regjistruar			
18	Agjencia Letan	Njësia Administrative Bradashesh - Elbasan			Pa regjistruar	
19	Agjencia Seferan	Bashkia Belsh - Elbasan	Regjistruar			
20	Ish zyrtar	Bashkia Elbasan			Pa regjistruar	
21	Drejtoria	Bashkia Durrës	Regjistruar			
22	Agjencia Shkozë	Bashkia Durrës	Regjistruar			
23	Agjencia e Karburanteve	Bashkia Durrës			Pa regjistruar	VKM Nr. 61, date 01.02.2012 "Përndryshimi i përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Brendshme të Autoriteti Portual Durres"
24	Agjencia Mengaj	Njësia Administrative Helmes - Kavajë	Regjistruar			
25	Agjencia Fushë-Peshtan	Njësia Administrative Vërtop - Berat			Pa regjistruar	
26	Agjencia Uji I Zi	Njësia Administrative Terpan - Berat	Regjistruar			
27	Agjencia Mbolan	Njësia Administrative Sinjë - Berat			Pa regjistruar	
			STATUSI JURIDIK I PRONËS			
Nr.	AGJENCITE	VENDNDODHJA	REGJISTRUAR	VËRTETIM HIPOTEKOR	PA REGJISTRUAR	SHËNIME
II	DRRMSH Korçë					
28	Agjencia Mborje	Bashkia Korçë - Korçë	Regjistruar			
29	Agjencia Plasë	Njësia Administrative Pojan - Korçë	Regjistruar			
30	Agjencia Shpellë e Mokrës	Njësia Administrative Velçan - Pogradec			Pa regjistruar	
31	Agjencia Dorez	Njësia Administrative Qendër Librazhd	Regjistruar			
32	Agjencia Kokel	Njësia Administrative Kodovjat -			Pa regjistruar	

		Gramsh				
33	Agjencia Bratile	Njësia Administrative Kodovjat - Gramsh			Pa regjistruar	
34	Agjencia Bersnik	Njësia Administrative Kodovjat - Gramsh			Pa regjistruar	
III	DRRMSH Shkodër					
35	Agjencia Puke	Bashkia Pukë	Regjistruar			
36	Agjencia Kukes	Bashkia Kukës	Regjistruar			
37	Agjencia Myçmamëz	Njësia Administrative Kolsh-Kukës	Regjistruar			
38	Agjencia Koje	Bashkia Bajram-Curri	Regjistruar			
39	Agjencia Gradiski	Njësia Administrative Qender Malësi e Madhe		Vërtetim hipotekor		
40	Agjencia Rrenz	Bashkia Shkodër	Regjistruar			
IV	DRRMSH Dibër					
41	Zyrat	Bashkia Burrel - Mat	Regjistruar			
42	Agjencia German	Njësia Administrative Komsit - Mat	Regjistruar			
43	Agjencia Shupenzë	Njësia Administrative Shupenzë-Bulqizë	Regjistruar			
44	Agjencia Maqellarë	Njësia Administrative Maqellarë-Dibër	Regjistruar			
45	Agjencia Kastriot	Njësia Administrative Kastriot-Dibër	Regjistruar			
46	Agjencia Milot	Njësia Administrative Milot-Laç	Regjistruar			
47	Agjencia (NFK) Rrëshen	Bashkia Rrëshen			Pa regjistruar	Prona ka kaluar pranë ATP për t'u përdorur si fond kompensimi fizik
V	DRRMSH Fier					
48	Peshore	Bashkia Vlorë	Regjistruar			
49	Agjencia Tepelene	Bashkia Tepelenë	Regjistruar			
50	Agjencia Depo Luzat	Njësia Administrative Qendër-Tepelenë	Regjistruar			

51	Agjencia Dukaj	Njësia Administrative Qendër-Tepelenë	Regjistruar			
52	Agjencia Kash	Njësia Administrative Qendër-Mallakastër	Regjistruar			
53	Agjencia Povel-Fratar	Njësia Administrative Fratar - Mallakastër	Regjistruar			
TOTALI			34	2	17	53

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

14. Gjetje nga auditimi: Pronat të cilat Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit administrojnë përcaktohen në VKM nr. 413 datë 11.07.2007, të ndryshuar. Ndër vite këto asete janë përdorur në disa forma dhe përkatësisht 2 (dy) prona i janë nënshtruar procesit të shitjes, 2 (dy) prona janë dhënë me qira me çmimin simbolik 1 Euro, 2 (dy) prona janë dhënë me qira 1 vjeçare nga DPRMSH, 1 (një) pronë është kaluar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave për tu përdorur fond kompensimi si dhe 5 (pesë) prona janë transferuar në institucione të tjera sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave. Territori dhe ndërtesat e njësive kryesore të rezervës materiale me vendndodhje në Lundër, Tiranë, e cila është përgjegjëse për administrimin e mallrave ushqimorë në rang kombëtar, me VKM nr. 808, datë 12.12.2022 i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me qëllim ngritjen e një kompleksi argëtues dhe sportiv. Pavarësisht sa më sipër, procedura për zhvendosjen ka nisur prej muajit Shkurt 2023 por ende nuk ka gjetur zbatim.

Rekomandimi:

14.1 Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, nëpërmjet një grupi pune, të kryejë vlerësimin e situatës, nevojave dhe kapaciteteve të nevojshme të magazinimit dhe territorit që rezerva materiale e shtetit duhet të ketë në funksion të aktivitetit të saj, për përdorimin në mënyrë sa më efektive të aseteve në shërbim të interesit publik.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Për zbatimin e këtij rekomandimi ju informojmë se nga DPRMSH është ndërmarrë iniciativa për hartimin e projekteve për 3 ambiente magazinuese për të cilat pritet hartimi i projekteve nga IGJIU. Kjo iniciativë e ndërmarrë kërkon të garantojë mundësimin e kushteve optimale magazinimi në secilën Drejtori varësie. Theksojmë se për përcaktimin e kapaciteteve totale magazinuese është e nevojshme së pari identifikimi i nevojave për mallra rezervë shteti nisur nga ndryshimet e nevojshme të nomenklaturës dhe sasive minimale e maksimale të saj. Vetëm pas përcaktimit të volumit të mallrave rezervë shteti mund të vijohet me evidentimin konkret të sipërfaqeve magazinuese. Nga ana tjetër një faktor po aq i rëndësishëm nga i cili varet ky përcaktim është edhe sigurimi i vendvendosjes së mallrave që aktualisht janë në Agjencinë Lundër.

Në vijim të rekomandimit lidhur me përmirësimin e kushteve magazinuese si dhe krijimin e kushteve optimale për magazinimin e mallrave rezervë shteti nga DPRMSH:

referuar shkresës nr. 135 prot., datë 22.08.2023 “Kërkesë për kryerje rikonstruksione” e DRRMSH Korçë ka vijuar puna për hartimin e detyrave të projektimit me lëndë

“Rikonstruksion i depos nr. 6, rrethimit të jashtëm, portës hyrëse, rrjetit elektrik si dhe vëzhgimit të territorit me kamera”. Këto detyra projektimi me shkresën nr. 1009/3 prot., datë 01.09.2023 i janë drejtuar IGJIU me qëllim hartimin e projekt-preventivit përkatës.

referuar shkresës nr. 187 prot., datë 30.08.2023 “Kërkesë për rikonstruksion” e DRRMSH Shkodërë ka vijuar puna për hartimin e detyrave të projektimit me lëndë “Rikonstruksion i depos nr. 2, rrethimit të jashtëm, portës hyrëse, rrjetit elektrik si dhe vëzhgimit të territorit me kamera”. Këto detyra projektimi me shkresën nr. 1026/3 prot., datë 01.09.2023 i janë drejtuar IGJIU me qëllim hartimin e projekt-preventivit përkatës.

referuar shkresës nr. 276 prot., datë 24.08.2023 “Kërkesë për rikonstruksionin e depos harkore nr. 1, rrethimit të territorit, ndriçimit të terrritorit dhe vendosjen e kamerave të sigurisë të DRRMSH Dibër” e DRRMSH Dibër ka vijuar puna për hartimin e detyrave të projektimit me lëndë “Rikonstruksion i depos nr. 1, rrethimit të jashtëm, portës hyrëse, rrjetit elektrik si dhe vëzhgimit të territorit me kamera”. Këto detyra projektimi me shkresën nr. 1004/3 prot., datë 01.09.2023 i janë drejtuar IGJIU me qëllim hartimin e projekt-preventivit përkatës. (bashkëlidhur praktikat shkresore)

DPRMSH me shkresën Nr. 711 Prot., datë 09.06.2023 “Kërkesë për ndryshim të përgjegjësisë të pronës Nr. 906 Rep.Usht.7008 Fakultetit Teorik Vlorë” i është drejtuar Ministrit të Mbrojtjes duke i kërkuar bashkëpunim për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës, nga Komanda e Forcës Ajrore tek DPRMSH për DRRMSH Fier. Lidhur me këtë kërkesë, Ministria e Mbrojtjes me anë të shkresës Nr. 711/1 Prot., datë 06.09.2023 “Për dërgim informacioni dhe dokumentacioni për kalimin në administrim nga KFA te DPRMSH të disa objekteve dhe truall funksional, komponentë të pronës nr. 906 me emërtim “Rep.Usht.7008 Fakultetit Teorik” në Vlorë” ka kërkuar të përgatitet dokumentacioni tekniko-ligjor (planrilevimin dhe formularin standard të inventarizimit të objekteve së bashku me truall funksional) që do të kalojnë në administrim të DPRMSH. Në vijim të saj dhe pas dakortësisë nga SHPFA si dhe KFA i është kërkuar verifikimi në terren i pronës ku të përcaktohet sipërfaqja funksionale nëpërmjet shkresës Nr. 711/2 Prot., datë 07.09.2023 “Kërkesë për bashkëpunim” DPRMSH i është drejtuar IGJIU, KFA dhe DRRMSH Fier me qëllim verifikimin në terren të pronës, bashkëlidhur kopje e planrilevimit të pasurisë si dhe planimetritë e objekteve me nr. 8,9,10,11 dhe 12.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

Rekomandimi:

14.2 Ministria e Mbrojtjes të marrë masat e nevojshme për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit të rezervës materiale ushqimore e cila gjendet në Lundër, Tiranë, për të mos u përballur me situata të paplanifikuara dhe të pavlerësuara paraprakisht.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit të audituar:

Lidhur me garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit të rezervës materiale ushqimore e cila gjendet në Lundër, Tiranë, sqarojmë se nga FSHZH ende nuk është ndërmarrë asnjë masë për zbatimin e VKM 808/2022 në mënyrë negocimin nga ana jonë për mallrat dhe administratën e DRRMSH Tiranë pranë kësaj agjencie.

Për sa më sipër sqarojmë së: nuk ka një plan të miratuar për transferimin e aktivitetit të rezervës materiale në Lundër, një projekt me FSHZH dhe as nuk janë lidhur akt marrëveshje me këtë institucion për plotësimin e nevojave të DPRMSH-së. DPRMSH ka hartuar aktet e nevojshme e më konkretisht: shkresën Nr. 194/1 prot., datë 13.02.2023 “Për njohje e zbatim” drejtuar DRRMSH Tiranë lidhur me njohjen e zbatimit e vendimit të sipërcituar si dhe

marrjen e masave për njoftimin e institucioneve ose subjekteve të cilat kanë kontrata huapërdorje sipërfaqe magazinuese pranë kësaj agjencie, me qëllim lirimin e tyre. Urdhri Nr. 25, datë 13.02.2023 “Për ngritjen e komisionit për dorëzimin e fondit shqiptar të zhvillimit të pronës me emërtim “Agjencia Lundër”, me vendndodhje në Lundër, Tiranë, Zona Kadastrale 2529” për ngritjen e komisionit për dorëzimin e pronës vetëm pas nënshkrimit të një aktëmarrëveshje dypalëshe midis FSHZH dhe DPRMSH. Shkresën Nr. 194/3 prot., datë 13.02.2023 “Kërkesë për bashkëpunim” drejtuar Fondit Shqiptar të Zhvillimit në të cilën informon se nuk mund të vijohet me dorëzimin e pronës pa nënshkrimin e aktëmarrëveshjes dypalëshe në zbatim të pikës 4 të VKM-së Nr. 808, datë 12.12.2022 por pa përgjigje.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, i pazbatuar.**

15. Gjetje nga auditimi: Kushtet e ruajtjes së mallrave të sekuestruar dhe konfiskuar jo në të gjitha rastet ishin optimale, kjo për shkak të mungesës së investimeve për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e magazinave të shfrytëzuara. Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme e mallrave kryesisht veshje, apo mallra të konfiskuara, ishin të pa-paketuara dhe nuk paraqiteshin në gjendeshin në kushte optimale për përdorim. Ndërkohë automjetet ishin të përhapura në të gjithë territorin rreth magazinave kryesor. Për ato të kategorizuara për skrap periudha e gjatë nën efektin e agjentëve atmosferikë e kishte përshpejtuar së tepërmi amortizimin e tyre. Kjo situatë paraqitej thuajse në të gjitha DRRMSH-të, si rezultat i mos përfundimit ende të procedurave të shitjes së tyre. Mosveprimi në kohë krijon mbingarkesa të panevojshme për stafin e rezervës materiale në drejtim të administrimit të mallrave por edhe ndikon negativisht në përfitimet që mund të vijnë nga shitja në kohë e tyre.

Rekomandimi:

15.1 Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të marrin masat e nevojshme për vlerësimin dhe shitjen në kohë të mallrave të konfiskuara gjendje me qëllim përfitimin e vlerave sa më të larta në shitjen e tyre si dhe reduktimin e veprimeve administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit të audituar:

Sikurse sqaruam edhe më sipër në projektligjin e propozuar nga rezervat materiale të shtetit është sanksionimi në ligj i dispozitës sipas së cilës “mallrat rezervë materiale shtetërore përbëhen midis të tjerash nga mallra të konfiskuara të cilat kanë vlerë përdorimi për rezervën e shtetit”. Në kuptim të këtij propozimi DPRMSH do të administrojë mallra të konfiskuara që i shërbejnë misionit të saj dhe mund të jenë ose jo pjesë e nomenklaturës. Në të gjitha rastet mallrat e administruara nga konfiskimi do të shërbejnë vetëm për plotësimin e nevojave të rezervës dhe vihen në funksion të misionit të saj dhe jo më ti nënshtrohen procedurave të shitjes apo tjetërsimit sikurse është proceduar deri më tani. Ndërkohë deri në miratimin e ndryshimeve ligjore, DPRMSH bazuar në misionin e saj ka udhëzuar institucionet shtetërore prej të cilave janë administruar deri më tani mallra të konfiskuara duke i orientuar se procesi i administrimit do të vijojë vetëm për ato mallra që i shërbejnë rezervës së shtetit, pjesa tjetër nuk do merret në dorëzim. E njëjta gjë është bërë edhe lidhur me administrimin e mjeteve nga Drejtoritë e Policive.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, në proces zbatimi.**

16. Gjetje nga auditimi: Në kontratat e përdorura nga DPRMSH për blerjen dhe ruajtjen e mallrave rezervë materiale e shtetit evidentohet se: Kontratat Depozitë lidhur midis DPRMSH dhe agjentëve ekonomike (subjekteve tregtare), në mënyrën si janë konceptuar nuk garantojnë sasinë, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mallrave rezervë materiale shtetërore. Përzgjedhja e subjekteve që shërbejnë si depozitarë nuk është kryer si përcaktohet në mënyrë që të sigurohet pandryshueshmëria e gjendjes cilësore dhe vëllimore të artikujve rezervë material e shtetit. Kontratat Depozitë nuk kanë të përcaktuara afatet e kohëzgjatjes të depozitimit të mallit pranë depozitarit si edhe penalitetet në rast të humbjes apo dëmtimit të mallit rezervë material shtetërore si përcaktohet. Në të gjitha rastet e kontratave depozitë të lidhura, shoqëria tregtare garanton mirëmbajtjen dhe ruajtjen e sasisë pa shpërblim.

Rekomandimi:

16.1 Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të marrë masa për hartimin e kuadrit rregullator, i cili të përcaktojë qartë kriteret e përzgjedhjes së agjentëve ekonomikë me të cilët do të lidhen Kontratat Depozitë për mallrat rezervë materiale e shtetit që kërkojnë kushte të veçanta për ruajtjen dhe mirëmbajtjen.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Zbatimi i këtij rekomandimi në pamundësi objektive të zbatimit të menjëhershëm, do të mbahet në konsideratë në vijim, për arsye se në propozimet e dhëna në Projektligjin “Për rezervat materiale të shtetit” është sanksionuar që “Kriteret e përzgjedhjes së subjekteve tregtare për ruajtjen e mirëmbajtjen e mallit, pagesa, inspektimi, kontrolli i mallit dhe sanksionet në rast mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.”

Lidhur me kontratat e depozitave midis DPRMSH dhe agjentëve ekonomik për mënyrën e ruajtjes, mirëmbajtjes si dhe garantimit të sasisë, nga ana e DPRMSH janë ngritur urdhërat si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme ka ngritur Urdhrin Nr.58, datë 22.2.2024 “Për ngritjen e komisionit të inspektimit periodik të artikullit miell gruri, lënë në ruajtje pranë subjekteve tregtare “S..T shpk” dhe “P.... shpk”, në përgjegjësi administrimi të DRRMSH Tiranë”:

Në zbatim të Urdhërit të DP Nr. Nr.58, datë 22.2.2024, më shkresën Nr. 324/1 Prot., datë 21.03.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit është bërë njoftim për inspektim të artikullit ushqimor “Miell gruri” shoqërisë S... T.... dhe me shkresën Nr. 493 Prot., datë 26.03.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit është bërë njoftim për inspektim të artikullit ushqimor “Miell gruri” shoqërisë P.... shpk.

Për këtë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit janë përcjellë akt-inspektimet të datës 27.03.2024 me shoqërinë S.... T.... shpk protokolluar me tonën Nr. 324/3 Prot., datë 08.04.2024 dhe akt-inspektimi i datës 28.03.2024 me shoqërinë P.....shpk protokolluar me tonën Nr. 324/2 Prot., datë 08.04.2024.

Me Urdhrin Nr.64 datë 28.2.2024 “Për ngritjen e komisionit të inspektimit periodik të artikullit ushqimor konserva mish viçi dhe ushqim i koncentruar (koncentrat) për kafshë, lënë në ruajtje pranë subjekteve tregtare “L..... C.....” shpk, “3-Sh” shpk dhe “M.C. C...” shpk në përgjegjësi administratimi të DRRMSH Tiranë” ka kryer inspektimet si më poshtë:

Në zbatim të urdhrit Nr. 64, datë 28.02.2024, me shkresën Nr. 508 Prot., datë 29.03.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit është bërë njoftim për inspektim të artikullit ushqimor “Koncentrat për kafshët” shoqërisë L.... C..... dhe me shkresën Nr. 507 Prot., datë 29.03.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit është bërë njoftim për inspektim të artikullit ushqimor “Konserva mishi” shoqërisë M.C C... shpk.

Për këtë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit janë përcjellë akt-inspektimet të datës 03.04.2024 me shoqërinë M.C C.... shpk protokolluar me tonën Nr. 361/3 Prot., datë 24.04.2024, akt-inspektimi i datës 04.04.2024 me shoqërinë L... C... shpk protokolluar me tonën Nr. 361/1 Prot., datë 08.04.2024 dhe akt-inspektimi i datës 24.04.2024 me shoqërinë 3-... shpk protokolluar me tonën Nr. 361/4 Prot., datë 02.05.2024 si dhe protokolluar me tonën Nr. 809 Prot., datë 10.06.2024 janë përcjellë analizat për arikujt “Miell gruri” dhe “Koncentrat për kafshë”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, i pazbatuar.**

Rekomandimi:

16.2 Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të marrë masa për hartimin e Kontratës Depozitë tip në rastin e magazinimit të mallrave rezervë materiale e shtetit pranë të tretëve, duke marrë në konsideratë përfshirjen e elementëve të munguar, të cilët rrisin përgjegjësinë e agentëve ekonomikë për të garantuar mirëmbajtjen dhe ruajtjen e sasisë.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

DPRMSH, harton kontratat në varësi të procedurës së prokurimit të cilat lidhen vetëm nga drejtoria e përgjithëshme.

DPMRSH ka lidhur kontratën me Nr. 196/14 Prot., datë 06.09.2023 “Kontratë Shit-Blerje Ushqim i Koncentruar (Koncentratë) për kafshë”, me operatorin ekonomik “3...” (bashkëlidhur kontrata).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, i pazbatuar.**

17. Gjetje nga auditimi: Për Kontratat e Shit-Blerjes lloji i kontratës së përdorur është “Marrëveshje Kuadër”, me afat një vit, ku procedurat e prokurimit realizohen nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Aktualisht kjo kontratë trajtohet si një kontratë e zakonshme prokurimi duke mos shfrytëzuar avantazhet që “Marrëveshja Kuadër” jep lidhur me furnizimin e mallrave sa herë lind nevoja dhe jo në mënyrë të menjëhershme dhe përdorimin me ekonomikitet të fondeve. Aplikimi i një afati më të gjatë se një vit do të mundësonte një siguri më të lartë në aktivitetin e rezervës materiale të shtetit për shkak të garancisë lidhur me kontraktorin.

Rekomandimi:

17.1 Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të përdorë të gjitha avantazhet e “Marrëveshjes Kuadër” sa i përket blerjes së mallrave rezervë materiale si dhe ti drejtohet Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, për përdorimin e një afati më të gjatë, me qëllim përdorimin me ekonomikitet të fondeve publike, shkurtimin e procedurave, si dhe garantimit të gjendjes dhe sasisë së mallrave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit të audituar:

Zbatimi rekomandimit të aplikimit të marrëveshjeve kuadër për një periudhë më të gjatë se 1 vit do të mbahet në konsideratë gjatë blerjeve të mallrave rezervë shteti në vijim.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe pazbatuar.**

18. Gjetje nga auditimi: Gjatë kohës që mallrat kanë qëndruar në magazinat e agjentëve ekonomikë, nuk është kryer asnjë inspektim apo tërheqje e kampionëve të e përdorimit, nga ana e DPRMSH. Në përfundim mungon një kuadër rregullator i qartë dhe i plotë i cili përcakton kriteret e përzgjedhjes së agjentëve ekonomikë të cilët do të shërbejnë si depozitarë të mallrave rezervë materiale e shtetit të cilat për shkak të kushteve të veçanta të ruajtjes dhe mirëmbajtjes, duhet të magazinohen pranë të tretëve.

Në kontratat e lidhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit me subjekte tregtare, si Kontrata Depozitë ashtu edhe Shitblerje, megjithëse përgjegjësinë për kryerjen e inspektimeve dhe tërheqjen e kampionëve e ka DPRMSH, përgjegjësia materiale për mallrat rezervë materiale e shtetit qëndron te Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit Tiranë, e cila është përgjegjëse për inventarizimin e mallrave.

Rekomandimi:

18.1 Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të hartojë kuadrin rregullator për përcaktimin e periodicitetit të kryerjes të inspektimeve dhe mekanizmin për monitorimin e tij, për mallrat rezervë materiale e shtetit që kërkojnë kushte të veçanta për ruajtjen dhe mirëmbajtjen dhe depozitohen pranë të tretëve.

Përgjigja e subjektit të audituar:

Zbatimi i këtij rekomandimi në pamundësi objektive të zbatimit të menjëhershëm, do të mbahet në konsideratë në vijim, për arsye se në propozimet e dhëna në Projektligjin “Për rezervat materiale të shtetit” është sanksionuar që “Kriteret e përzgjedhjes së subjekteve tregtare përgjegjëse për ruajtjen e mirëmbajtjen e mallit, pagesa, inspektimi, kontrolli i mallit si dhe sanksione në rast mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.”

Sa më sipër në momentin e hartimit të projektvendimit do të analizohen dhe sanksionohen mekanizmat për garantimin e kontrollit të mallrave të lëna në ruajte.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, i pazbatuar.**

Rekomandimi:

18.2 Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të përfshijë si Kontrata Depozitë ashtu edhe Shit-blerje edhe Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë, në cilësinë e monitoruesit dhe inspektuesit, si strukturë me përgjegjësi materiale.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Zbatimi i këtij rekomandimi në pamundësi objektive të zbatimit të menjëhershëm, do të mbahet në konsideratë në vijim, për arsye se në propozimet e dhëna në Projektligjin “Për rezervat materiale të shtetit” është sanksionuar që “Kriteret e përzgjedhjes së subjekteve tregtare përgjegjëse për ruajtjen e mirëmbajtjen e mallit, pagesa, inspektimi, kontrolli i mallit si dhe sanksione në rast mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.”

Sa më sipër në momentin e hartimit të projektvendimit do të analizohen dhe sanksionohen mekanizmat për garantimin e kontrollit të mallrave të lëna në ruajte.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, i pazbatuar.**

4.2.2 A ka funksionuar sistemi i raportimit, monitorimit dhe koordinimit mes institucioneve të përfshira?

19. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për periudhën nën auditim, vitet 2019-2022, nuk ka të përcaktuar në aktet e veta rregullative një formë të mirë të përcaktuar raportimi nga drejtoritë rajonale në DPRMSH dhe nga kjo e fundit në Ministrinë e Mbrojtjes. Informacionet e dërguara nga gjatë kësaj periudhe drejt institucionit epror janë kryesisht raportime të rregulluara nga akte të tjera ligjore si në rastin e raportimeve buxhetore, të ankandëve, burimeve njerëzore si dhe të dhënave të kërkuara specifikisht për aktivitetin. Në këtë periudhë 4- vjeçare është hartuar vetëm një Raport-analizë për aktivitetin e kryer përkatësisht vitin 2022, por edhe ky raport rezulton i dërguar drejt Drejtorive Rajonale dhe jo pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Mungesa e një sistemi të qartë raportimi ndikon në menaxhimin efektiv të burimeve.

Rekomandimi:

19.1 Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, të rishikojnë, aktet e brendshme rregullatorë mbi raportimin e aktivitetit vjetor të institucionit të rezervave materiale të shtetit duke saktësuar mënyrën e raportimit të drejtorisë qendrore dhe atyre vendore si dhe frekuencën e tyre.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Zbatimi i këtij rekomandimi do të mbahet në konsideratë gjatë hartimit të akteve të reja nënligjore mbi organizimin e aktivitetit të brendshëm të DPRMSH, rregullores së brendshme duke sanksionuar raportimin e aktivitetit vjetor të institucionit, mënyrën e raportimit të drejtorisë qendrore dhe atyre vendore si dhe frekuencën e tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

20. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit nuk rezulton të jetë audituar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, pjesë e strukturës së saj, për veprimtarinë e kryer për periudhën nën auditim. Kjo strukturë nuk ka qenë as objekt i inspektimeve nga Ministria e Mbrojtjes, megjithëse është njësia kryesore për administrimin e rezervës materiale të shtetit dhe kryen menaxhimin financiar të gjithë strukturës nën varësi, çka nuk jep siguri të arsyeshme për funksionalitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe garantimin e përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike dhe burimeve institucionale.

Rekomandimi:

20.1 Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, të kryejnë përkatësisht, inspektime dhe auditime të plota në drejtorinë qendrore të rezervave materiale të shtetit, për të vlerësuar aktivitetin e kryer si dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të kësaj njësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit të audituar:

Zbatimi i këtij rekomandimi nga DPRMSH për të mundësuar auditimin nga Sektori i Auditit në DPRMSH gjatë vitit 2023 ka qenë objektivisht i pamundur për shkak se struktura e Sektorit të auditit është e paplotësuar (nga 3 pozicione vetëm 1 është i plotësuar). Ndërkohë për zbatimin e tij nga Ministria e Mbrojtjes, DPRMSH në momentin e hartimit të Planit të masave i ka bërë me dije Ministrisë së Mbrojtjes gjithë rekomandimet e lëna nga ana juaj, përfshirë dhe rekomandimin për këtë çështje.

Në fillim të vitit 2024, Përgjegjësi i Sektorit të Auditit në DPRMSH me Memon Nr. 349 Prot., datë 26.02.2024, ka bërë me dije Drejtorin e Përgjithshëm të DPRMSH për pamundësinë e vazhdimësisë së auditimeve të parashikuara ndodhur në kushtet e mungesës së personelit.

Në vijim të Memos, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën Nr. 349/1 Prot., datë 28.02.2024 “Kërkesë për mbështetje” ku kërkon mbështetjen e tyre me një specialist auditit me qëllim vijimësinë e punës së planifikuar për 4 mujorin e parë të vitit 2024.

Me anë të shkresës Nr. 1369/1 Prot., datë 08.03.2024, protokolluar me tonën Nr. 349/2 Prot., datë 11.03.2024 “Kthim përgjigje” ka shprehur pamundësinë e tyre për të vënë në dispozicion një auditues.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

21. Gjetje nga auditimi: Kalimi i rezervave materiale të shtetit, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes solli dhe vendosjen e saj nën të njëjtin program buxhetor me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, njësi gjithashtu nën varësi të Ministrisë së Mbrojtjes e cila është ngarkuar me drejtimin e këtij programi. Pas këtyre ndryshimeve, drejtoritë rajonale të rezervës materiale u suprimuan si njësi shpenzuese dhe procesi u qendërzua në Drejtorinë e Përgjithshme. Referuar fushës së saj të përgjegjësisë, përballimi i emergjencave civile është vetëm një nga aspektet që rezerva materiale e shtetit duhet të përmbush për vendin por ndryshimet e ndodhura e kanë vendosur në një pozicion jo 54 të përshtatshëm sa i përket buxhetimit dhe menaxhimit të aktivitetit por dhe të institucioneve të varësisë të saj.

Rekomandimi:

21.1 Ministria e Mbrojtjes në rolin e institucionit epror, të vlerësojë nevojën dhe të ndër marrë iniciativat e nevojshme për kalimin e rezervës materiale nën një kod buxhetor më vete.

Brenda vitit 2023

Përgjigja e subjektit të audituar:

Me shkresën nr.1025 prot., datë 31.08.2023 “Kërkesë për bashkëpunim për kalimin e DPRMSH kod buxhetor më vete” DPRMSH ka argumentuar dhe kërkuar bashkëpunimin e Ministrisë së Mbrojtjes për kalimin e DPRMSH kod buxhetor më vete. Sa më sipër pritet vijimi i iniciativës së kërkuar nga Ministria e Mbrojtjes - Ministrisë së Financave si organi kompetent për këtë çështje.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

Në vijim të Projektraportit të dërguar, nga ana e subjekteve të audituara nuk janë paraqitur observacione lidhur me Akt-Verifikimet nr. 1 dhe nr.2 datë 16.08.2024 të mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresën nr.1180/9 prot., dhe 1180/10prot., datë 26.07.2023, konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e tyre është e pazbatuar, e zbatuar pjesërisht ose në proces zbatimi. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **ri-kërkojmë** zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

4.1 Për pyetjen e auditimit: A ka një vizion të qartë mbi rezervën materiale të shtetit?

4.1.1 A është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm kuadri ligjor dhe rregullator?

1. Gjetje nga auditimi: Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit nuk kanë përmirësuar legjislacionin aktual për rezervën materiale të shtetit, referuar zhvillimeve të fundit për mbrojtjen civile.

Aktiviteti i rezervës materiale të shtetit mbështetet mbi akte rregullatorë të cilat nuk janë azhurnuar pas ndryshimeve të ndodhura lidhur me ndryshimin e përgjegjësisë nga Ministria e Brendshme të Ministria e Mbrojtjes.

Urdhri i Kryeministrit për strukturat e DPRMSH-së dhe DRRMSH-ve është zbatuar jashtë afateve ligjore të parashikuara dhe këto të fundit kryejnë aktivitetin e tyre mbi rregullore të parashikuara.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes, të marrë masat e nevojshme për plotësimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me qëllim mirëfunksionimin e rezervës materiale të shtetit.

Brenda muajit Mars 2025

4.1.2 A janë të qarta rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira?

2. Gjetje nga auditimi: Baza ligjore aktuale në përballimin e situatave emergjente nuk garanton qartësinë dhe detyrimet respektive të roleve, përgjegjësisë dhe kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile dhe institucioneve të tjera të cilat janë të përfshira në përballimin e situatave emergjente. Ligji nr.9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar dhe Ligji nr.45, datë 18.07.2019, "Për Mbrojtjen Civile", krijojnë paqartësi të roleve dhe mbivendosje kompetencash. Nuk evidentohet përgjegjësia dhe mënyra e bashkëpunimit dhe koordinimit mes dy institucioneve të përfshira, të cilat veprojnë veçmas referuar kuadrit ligjor aktual, në përballimin e situatave të parashikuara.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet një grupi pune, të kryejë vlerësimin e roleve dhe përgjegjësisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit dhe Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile për qartësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor të këtyre institucioneve.

Brenda muajit Mars 2025

3. Gjetje nga auditimi: Ligji nr. 9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar, ka mbivendosje me Ligjin nr.34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", i ndryshuar lidhur me administrimin e mallrave të sekuestruara dhe konfiskuara. Nga auditimi rezultoi se, vendimet gjyqësore të marra lidhur

me pasuritë/mallrat e konfiskuara ose sekuestruara si rezultat i kryerjes së veprave penale në disa raste adresohen pranë Rezervës Materiale të Shtetit dhe në raste të tjera pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, ndërkohë që ky i fundit është institucioni i posaçëm për këtë qëllim.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes ti drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor për të unifikuar praktikën e vendimeve gjyqësore për konfiskimet dhe sekuestrimet e pasurive dhe mallrave që vijnë si rezultat i veprave penale drejt institucionit të posaçëm të krijuar për këtë qëllim.

Brenda muajit Mars 2025

4. Gjetje nga auditimi: VKM nr.1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se lista përbërëse e mallrave rezervë, në lloje dhe sasi, e ndarë sipas grupeve, si dhe kufiri minimal për secilin artikull të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.39 Lista me nomenklaturën e mallrave rezervë shteti e cila përmban gjendjen orientuese të tyre si dhe sasinë limit i detyrueshëm, është e publikuar, duke mos garantuar në këtë mënyrë ruajtjen e karakterit sekret sipas përcaktimit ligjor.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, të kryejë analizë dhe vlerësim të karakterit sekret të nomenklaturës, gjendjes dhe sasive të rezervës materiale të shtetit me qëllim qartësimin e mënyrës së funksionimit të proceseve në ruajtjen e këtij karakteri apo dhe ndërmarrjen e nismave të nevojshme ligjore për rregullimin e tij.

Brenda muajit Mars 2025

5. Gjetje nga auditimi: Struktura aktuale e rezervës materiale të shtetit është jo e plotë dhe e pamjaftueshme për të përmbushur qëllimin për të cilin është krijuar. Organika e miratuar nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit Nr.63, datë 12.04.2018 ” Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtorive Rajonale”, pasoi me dinamikë e lëvizjeve të personelit si lëvizje paralele, ngritje në detyrë, largim me dorëheqje, pezullim nga shërbimi civil etj., ka krijuar një numër të konsiderueshëm pozicionesh vakante, gjithsej 14 punonjës.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, të kryejë analizë dhe vlerësim të strukturës aktuale të rezervës materiale, si në nivel qendror ashtu edhe rajonal referuar qasjes institucionale që rezerva materiale e shtetit do të ketë.

Brenda muajit Mars 2025

6. Gjetje nga auditimi: Emërtimet e Drejtorive Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, Shkodër, Dibër, Fier, nuk kanë vendndodhje të njëjtë sipas emërtesës duke shkaktuar konfuzion gjatë ushtrimit të aktivitetit.

6.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ndryshimin e emërtimeve të drejtorive rajonale, të cilat nuk përkojnë me vendndodhjen e tyre reale.

Brenda muajit Mars 2025

7. Gjetje nga auditimi: Në Rezervat Materiale të Shtetit konstatohet një numër i lartë drejtuesish me funksione të komanduara në tejkallim të afateve të përcaktuara.

Pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit gjendet i komanduar prej disa vitesh, ndërsa shkresa për ngarkim të detyrave nuk është në përputhje me kuadrin ligjor.⁴¹

Pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit Tiranë, është i komanduar prej disa vitesh;

Ndërkohë pozicionet e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Shkodër dhe Korçë janë emërimet të përkohshme, respektivisht prej vitit 2020 dhe vitit 2021.

7.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit si edhe drejtorëve rajonalë, të cilët rezultojnë të komanduar ose me emërim të përkohshëm, në tejkalim të afateve të përcaktuara.

Brenda muajit Mars 2025

4.2 Për pyetjen e auditimit. A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur në funksion të rezervës materiale të shtetit

4.2.1 A i ka shërbyer mekanizmi i ngritur miradministrimit të rezervës materiale të shtetit?

8. Gjetje nga auditimi: Gjendjet orientuese dhe kufijtë minimal për produktet bazë janë mbajtur në të njëjtat nivele që prej vitit 2008, duke mos reflektuar dinamikat e zhvillimit dhe situatat me të cilat është përballur vendi vitet e fundit si tërmeti i vitit 2019, pandemia globale etj. Ndryshimet në nomenklaturën e mallrave rezervë shteti, janë kryer mbi një kuadër rregullator të parishikuar së fundmi për mbrojtjen civile dhe pa një metodologji të caktuar, referuar rëndësisë, burimeve të financimit, ndryshimit të numrit të popullsisë, ndryshimeve demografike, etj.

8.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit të marrin masa për rishikimin e nomenklaturës, sasisë dhe gjendjes së mallrave rezervë shteti mbi bazën e një metodologjie të mirë përcaktuar, me qëllim garantimin e nevojave të qytetarëve në rastet e situatave jo të zakonshme.

Brenda muajit Mars 2025

9. Gjetje nga auditimi: Rezerva materiale e shtetit ka 25 prona të paluajtshme të regjistruara pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ndërsa për 27 të tjera të cilat përbëhen nga 933,690 m² “Troje” dhe 58,989 m² “Ndërtime” procesi i regjistrimit nuk rezulton të ketë përfunduar. Këto prona shtrihen në të gjitha drejtoritë rajonale. Pjesa më e madhe e pronave të paregjistruara në numër dhe sipërfaqe paraqitet në Drejtorinë Rajonale, Tiranë e cila rezulton me 18 të tilla dhe Korçë me 4 prona. Pronat nën përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit janë të përcaktuara qartësisht në VKM nr. 413 datë 11.07.2007, i ndryshuar. Zgjatja e procesit të regjistrimit, burimet njerëzore dhe financiare të kufizuara për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre krijojnë risk të lartë për dëmtimin dhe tjetërsimin e këtyre aseteve pasuri kombëtare.

9.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet një grupi pune, të verifikojë problematikat e hasura për mos regjistrimin e pronave nën administrimin e rezervës materiale të shtetit dhe të ndërmarrë veprimet përkatëse për adresimin e tyre.

Brenda muajit Mars 2025

10. Gjetje nga auditimi: Pronat të cilat Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit administrojnë përcaktohen në VKM nr. 413 datë 11.07.2007, të ndryshuar. Ndër vite këto asete janë përdorur në disa forma dhe përkatësisht 2 (dy) prona i janë nënshtruar procesit të shitjes, 2 (dy) prona janë dhënë me qira me çmimin simbolik 1 Euro, 2 (dy) prona janë dhënë me qira 1 vjeçare nga DPRMSH, 1 (një) pronë është kaluar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave për tu përdorur fond kompensimi si dhe 5 (pesë) prona janë transferuar në institucione të tjera sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave. Territori dhe ndërtesat e njësisë kryesore të rezervës materiale me vendndodhje në Lundër, Tiranë, e cila është përgjegjëse për administrimin e mallrave ushqimorë në rang kombëtar, me VKM nr. 808, datë 12.12.2022 i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me qëllim ngritjen e një kompleksi argëtues dhe sportiv. Pavarësisht sa më sipër, procedura për zhvendosjen ka nisur prej muajit Shkurt 2023 por ende nuk ka gjetur zbatim.

10.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, nëpërmjet një grupi pune, të kryejë vlerësimin e situatës, nevojave dhe kapaciteteve të nevojshme të magazinimit dhe territorit që rezerva materiale e shtetit duhet të ketë në funksion të aktivitetit të saj, për përdorimin në mënyrë sa më efektive të aseteve në shërbim të interesit publik.

Brenda muajit Mars 2025

10.2 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes të marrë masat e nevojshme për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit të rezervës materiale ushqimore e cila gjendet në Lundër, Tiranë, për të mos u përballur me situata të paplanifikuara dhe të pavlerësuara paraprakisht.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në kontratat e përdorura nga DPRMSH për blerjen dhe ruajtjen e mallrave rezervë materiale e shtetit evidentohet se: Kontratat Depozitë lidhur midis DPRMSH dhe agjentëve ekonomike (subjekteve tregtare), në mënyrën si janë konceptuar nuk garantojnë sasinë, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mallrave rezervë materiale shtetërore. Përzgjedhja e subjekteve që shërbejnë si depozitarë nuk është kryer si përcaktohet në mënyrë që të sigurohet pandryshueshmëria e gjendjes cilësore dhe vëllimore të artikujve rezervë material e shtetit. Kontratat Depozitë nuk kanë të përcaktuara afatet e kohëzgjatjes të depozitimit të mallit pranë depozitarit si edhe penalitetet në rast të humbjes apo dëmtimit të mallit rezervë material shtetërore si përcaktohet. Në të gjitha rastet e kontratave depozitë të lidhura, shoqëria tregtare garanton mirëmbajtjen dhe ruajtjen e sasisë pa shpërblim.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të marrë masa për hartimin e kuadrit rregullator, i cili të përcaktojë qartë kriteret e përzgjedhjes së agjentëve ekonomikë me të cilët do të lidhen Kontratat Depozitë për mallrat rezervë materiale e shtetit që kërkojnë kushte të veçanta për ruajtjen dhe mirëmbajtjen.

Brenda muajit Mars 2025

11.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të marrë masa për hartimin e Kontratës Depozitë tip në rastin e magazinimit të mallrave rezervë materiale e shtetit pranë të tretëve, duke marrë në konsideratë përfshirjen e elementëve të munguar, të cilët rrisin përgjegjësinë e agjentëve ekonomikë për të garantuar mirëmbajtjen dhe ruajtjen e sasisë.

Brenda muajit Mars 2025

12. Gjetje nga auditimi: Për Kontratat e Shit-Blerjes lloji i kontratës së përdorur është “Marrëveshje Kuadër”, me afat një vit, ku procedurat e prokurimit realizohen nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Aktualisht kjo kontratë trajtohet si një kontratë e zakonshme prokurimi duke mos shfrytëzuar avantazhet që “Marrëveshja Kuadër” jep lidhur me furnizimin e mallrave sa herë lind nevoja dhe jo në mënyrë të menjëhershme dhe përdorimin me ekonomikitet të fondeve. Aplikimi i një afati më të gjatë se një vit do të mundësonte një siguri më të lartë në aktivitetin e rezervës materiale të shtetit për shkak të garancisë lidhur me kontraktorin.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të përdorë të gjitha avantazhet e “Marrëveshjes Kuadër” sa i përket blerjes së mallrave rezervë materiale si dhe ti drejtohet Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, për përdorimin e një afati më të gjatë, me qëllim përdorimin me ekonomikitet të fondeve publike, shkurtimin e procedurave, si dhe garantimit të gjendjes dhe sasisë së mallrave.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Gjatë kohës që mallrat kanë qëndruar në magazinat e agjentëve ekonomikë, nuk është kryer asnjë inspektim apo tërheqje e kampionëve të e përdorimit, nga ana e DPRMSH. Në përfundim mungon një kuadër rregullator i qartë dhe i plotë i cili përcakton kriteret e përzgjedhjes së agjentëve ekonomikë të cilët do të shërbejnë si depozitarë të mallrave rezervë materiale e shtetit të cilat për shkak të kushteve të veçanta të ruajtjes dhe mirëmbajtjes, duhet të magazinohen pranë të tretëve.

Në kontratat e lidhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit me subjekte tregtare, si Kontrata Depozitë ashtu edhe Shitblerje, megjithëse përgjegjësinë për kryerjen e inspektimeve dhe tërheqjen e kampionëve e ka DPRMSH, përgjegjësia materiale për mallrat rezervë materiale e shtetit qëndron te Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit Tiranë, e cila është përgjegjëse për inventarizimin e mallrave.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të hartojë kuadrin rregullator për përcaktimin e periodicitetit të kryerjes të inspektimeve dhe mekanizmin për monitorimin e tij, për mallrat rezervë materiale e shtetit që kërkojnë kushte të veçanta për ruajtjen dhe mirëmbajtjen dhe depozitohen pranë të tretëve.

Brenda muajit Mars 2025

13.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të përfshijë si Kontrata Depozitë ashtu edhe Shitblerje edhe Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë, në cilësinë e monitoruesit dhe inspektuesit, si strukturë me përgjegjësi materiale.

Brenda muajit Mars 2025

4.2.2 A ka funksionuar sistemi i raportimit, monitorimit dhe koordinimit mes institucioneve të përfshira?

14. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për periudhën nën auditim, vitet 2019-2022, nuk ka të përcaktuar në aktet e veta rregullative një formë të mirë përcaktuar raportimi nga drejtoritë rajonale në DPRMSH dhe nga kjo e fundit në Ministrinë e Mbrotjtjes. Informacionet e dërguara nga gjatë kësaj periudhe drejt institucionit epror janë kryesisht raportime të rregulluara nga akte të tjera ligjore si në rastin e raportimeve buxhetore, të ankandëve, burimeve njerëzore si dhe të dhënave të kërkuara specifikisht për aktivitetin. Në këtë periudhë 4- vjeçare është hartuar vetëm një Raport-

analizë për aktivitetin e kryer përkatësisht vitin 2022, por edhe ky raport rezulton i dërguar drejt Drejtorive Rajonale dhe jo pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Mungesa e një sistemi të qartë raportimi ndikon në menaxhimin efektiv të burimeve.

14.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, të rishikojnë, aktet e brendshme rregullatorë mbi raportimin e aktivitetit vjetor të institucionit të rezervave materiale të shtetit duke saktësuar mënyrën e raportimit të drejtorisë qendrore dhe atyre vendore si dhe frekuencën e tyre.

Brenda muajit Mars 2025

15. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit nuk rezulton të jetë audituar nga Njësisë e Auditimit të Brendshëm, pjesë e strukturës së saj, për veprimtarinë e kryer për periudhën nën auditim. Kjo strukturë nuk ka qenë as objekt i inspektimeve nga Ministria e Mbrojtjes, megjithëse është njësi kryesore për administrimin e rezervës materiale të shtetit dhe kryen menaxhimin financiar të gjithë strukturës nën varësi, çka nuk jep siguri të arsyeshme për funksionalitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe garantimin e përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike dhe burimeve institucionale.

15.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, të kryejnë përkatësisht, inspektime dhe auditime të plota në drejtorinë qendrore të rezervave materiale të shtetit, për të vlerësuar aktivitetin e kryer si dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të kësaj njësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Kalimi i rezervave materiale të shtetit, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes solli dhe vendosjen e saj nën të njëjtin program buxhetor me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, njësi gjithashtu nën varësi të Ministrisë së Mbrojtjes e cila është ngarkuar me drejtimin e këtij programi. Pas këtyre ndryshimeve, drejtoritë rajonale të rezervës materiale u suprimuan si njësi shpenzuese dhe procesi u qendërzua në Drejtorinë e Përgjithshme. Referuar fushës së saj të përgjegjësisë, përballimi i emergjencave civile është vetëm një nga aspektet që rezerva materiale e shtetit duhet të përmbush për vendin por ndryshimet e ndodhura e kanë vendosur në një pozicion jo 54 të përshtatshëm sa i përket buxhetimit dhe menaxhimit të aktivitetit por dhe të institucioneve të varësisë të saj.

16.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në rolin e institucionit epror, të vlerësojë nevojën dhe të ndër marrë iniciativat e nevojshme për kalimin e rezervës materiale nën një kod buxhetor më vete.

Brenda muajit Mars 2025

Të tjera

Për të gjitha masat e dhëna të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar me statusin *në proces zbatimi*, duke vlerësuar proceset e ndërmarrë nga subjektet e audituara dhe afatet e nevojshme për implementimin e plotë të tyre, kërkohet përmbushja e plotë e tyre **brenda tremujorit të parë të vitit 2025**.

2. PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “ PERFORMANCA E SHËRBIMIT TË PARABURGIMIT”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Nga verifikimi rezultoi që:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 592/10, prot., datë 26.09.2022 mbi “Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet në auditimet e performancës të evaduara gjatë 6 Mujorit I të vitit 2023”, ushtroi auditim në Ministria e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si subjekte pjesë e auditimit të Përformancës me temë: “*Performanca e Shërbimit të Paraburgimit*”.

Auditimi është kryer në vitin 2022-2023, me fokus kohor periudhën 01.01.2019-30.06.2022 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me Vendimin Nr.37 Datë 13.02.2023 të Kryetarit të KLSH-së si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat nr. 592/13, 14,15 prot, datë 14.02.2023. Auditimi mbi “Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara gjatë 6 mujorit I të vitit 2023” u krye nga data 17.07.2024 deri më datë 15.08.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a.** Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në 6 mujorin e I të vitit 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për 4097 prot., datë 25,07,2024 çdo njësi vartëse;
- b.** Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhëra për zbatimin e masave organizative;
- c.** Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet objekt auditimi u mbajtën Akt-Verifikimi përkatës nr. 1 e 2 të cilët janë regjistruar në protokollin e MDrejtësisë dhe DPBurgjeve dhe u është dërguar me shkresë dhe email dy subjekteve të tjera, përkatësisht në:

- Ministria e Drejtësisë, me nr.12494 prot., datë 25.07.2023;
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me datë 25.07.2024

Lidhur me Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresë nr. 914/3 prot., datë 02.08.2024 subjekti i auditimit DPBurgjeve ka dërguar dakordësinë me materialin e paraqitur dhe ka dërguar konfirmimin me shkresën Nr. 13017/1 prot., datë 13.09.2024, pra nga subjekti i mësipërm nuk ka patur observacione, duke vlerësuar me objektivitet rekomandimet dhe konstatimet e grupit të auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve, si dhe vënien e theksit tek rekomandimet që janë në proces zbatimi (vijimësi) për të vazhduar zbatimin e tyre.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH^{së}, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

Ministria e Drejtësisë dhe DPBurgjeve

Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë dërguar Planin e masave të përbashkët (pasi MD është mjaftuar me miratimin dhe pranimin e planit të masave të DPBurgjeve) për zbatimin e rekomandimeve dhe pranimin e tyre me

email zyrtar me datë 28.03.2023 ora 8:06 AM, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka bashkëpunuar me DPBurgje për zbatimin e 4 rekomandimeve(nga të cilat dy janë me DPB dhe dy rekomandime kanë qenë pjese e punës dhe kompetencave të DPPSH.

3.1 Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se:

3.2 Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi mbi zbatimin e respektimit të këtij afati rezultoi se:

Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Nga auditimi u konstatua se, ka dërguar gjendjen e realizimit të rekomandimeve sipas Planit të Masave të DP Burgjeve e cila ka dërguar Planin e masave për ecurine dhe gjendjen e zbatimit të rekomandimeve me email zyrtar me datë 23.10.2023 ora 2:39 PM (Bashkëlidhur këtij Akt Verifikimi).

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me email zyrtar me datë 28.03.2023 ora 8:06 AM, janë rekomanduar gjithsej:

✓ Masa Ligjore 3 rekomandime

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, referuar shkresës së përcjellë nga DPBurgjeve në KLSH email zyrtar me datë 28.03.2023 ora 8:06 AM dhe me email zyrtar me datë 23.10.2023 ora 2:39 PM "Mbi planin e masave, lidhur me rekomandimet e lëna rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.	3	3	-

✓ Masa organizative 15 rekomandime

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, referuar shkresës së përcjellë nga DPBurgjeve në KLSH email zyrtar me datë 28.03.2023 ora 8:06 AM dhe me email zyrtar me datë 23.10.2023 ora 2:39 PM "Mbi planin e masave, lidhur me rekomandimet e lëna rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Masa Organizative	17	17	-

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në 6 mujorin e I të vitit 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualin “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”, miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 13.06.2021.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 914 prot., datë 08.07.2024 “Njoftim për fillim projekt auditimi tematik për zbatimin e rekomandimeve në auditimet e performancës të evaduara në 6 mujorin e I të vitit 2023”. Rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm me temë “Performanca e Shërbimit të Paraburgimit”, me konkluzionet përkatëse janë miratuar me Vendimin Nr.37, datë 13.02.2023 të Kryetarit të KLSH-së, si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat nr. 592/13, 14,15 prot, datë 14.02.2023.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. B.L, *përgjegjës grupi*
2. L.Gj, *anëtar*
3. A.S, *anëtar*

Auditimi ka filluar më, 17.07.2024

Auditimi përfundon më, 15.09.2024

II.1. Objekti i auditimit

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara në Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën nr. 592/13, 14,15 prot, datë 14.02.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II.2. Qëllimi i auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjektet në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e aktivitetit të tyre në të ardhmen.

II.4. Konkluzioni:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, me shkresën nr. 592/13, 14,15 prot, datë 14.02.2023, rezulton se nga **20 (tetëmbëdhjetë) masa të rekomanduara** gjithsej, të gjitha janë pranuar nga subjektet e audituara.

Nga këto masa:

✓ janë zbatuar **20 rekomandime** ose 100 % e tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Ndryshime apo përmirësime ligjore	3	3		-	-
2	Masa organizative	17	17	-	-	-
	Gjithsej	20	20	-	-	-

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Për ndryshim apo përmirësim ligjor	Në numër	Në %
1	Totali	3	100%
2	Pa pranuar	-	-
3	Pranuar	3	100%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	3	100%
2	Zbatuar pjesërisht	-	-
3	Në proces zbatimi	-	-
4	Pa zbatuar	-	-

Nr.	Masa organizative	Në numër	Në %
1	Totali	17	100%
2	Pa pranuar	0	-
3	Pranuar	17	100%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	17	100%
2	Zbatuar pjesërisht	-	-
3	Në proces zbatimi	-	-
4	Pa zbatuar	-	-

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Puna e bërë nga subjekti i auditimit DPBurgjeve si institucioni përgjegjës direkt dhe institucionet e tjera, si MD, DPPSH, etj., ka mundur një nivel zbatimi të rekomandimeve rreth **100%**, tregues ky pozitiv mbi vlerësimin dhe pranimin e rekomandimeve në funksion të ndryshimit dhe përmirësimit të menaxhimit dhe bashkëpunimi ndërmjet këtyre subjekteve. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi, ka kërkuar më tepër impenjim e bashkëpunim nga subjektet e audituara, për përmbushjen e rekomandimeve të lëna dhe garantimin e një shërbimi e përmirësimi të kushteve për të paraburgosurit sipas standardeve të përcaktuara dhe udhëzimeve e rekomandimeve të Këshillit të Europës dhe Institucioneve ndërkombëtare që monitorojnë këtë shërbim. Konstatohet se MD, DPBurgjeve dhe DPPSH kanë patur një vlerësim pozitiv dhe bashkëpunues për rekomandimet e dërguara nga grupi i auditimit dhe niveli i zbatimit të tyre është i lartë.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1 Për pyetjen audituese: “A janë hartuar politika dhe a sigurohen kushte të përshtatshme për të paraburgosurit, në përputhje me standardet ndërkombëtare?”

1.1.1 A është hartuar kuadri ligjor dhe rregullator i nevojshëm me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur?

Gjetje nga auditimi:

1. Referuar legjislacionit në fuqi, në faza të ndryshme të procedimit penal procesi i caktimit të avokatit mbrojtës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare bëhet nga organe proceduese të ndryshme. Kështu, në fazën e hetimit paraprak, e drejta për caktimin e avokatit mbrojtës i njihet organit procedues që fillon hetimet, pra, prokurorit. Ndërsa, në fazën e dërgimit të çështjes për gjykim, është gjykata ajo që shqyrton kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe vendos për përfitimin ose jo të saj.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë të propozojë rishikimin e përcaktimeve ligjore në Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që: “në rastet kur kërkesa për përfitimin e ndihmës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare paraqitet nga i pandehuri që në fazën fillestare të hetimit dhe ai ka përmbushur kushtet për përfitimin e saj, atij ti ofrohet mundësia që edhe gjatë procesit të gjykimit të përfaqësohet me po të njëjtin avokat, që i është caktuar nga prokurori në fazën e hetimeve paraprake, kur është e mundur”.

Konstatohet: : Në lidhje me rekomandimin 1.1 është sqaruar: Përfituesit e ndihmes juridike të garantuar nga shteti (ndihmë juridike parësore/dytësore) janë shtetasit shqiptar me vendbanim ose vendqëndrim në RSH, shtetasit e huaj që janë të pajisur me leje qëndrimi, etj. Ndihma juridike i ofrohet personave që janë kategori e veçantë e ligjit dhe çdokush që provon me dokumentacion që nuk ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim në çështjet civile, penale dhe administrative. Neni 11 dhe 12 i ligjit nr.111/2017.

Të "ardhurat" e një personi i i cili jeton në familje konsiderohen të pamjaftueshme sipas pikës 1 të këtij neni, nëse të ardhurat e të gjithë familjes të pjesëtuar me numrin e anëtarëve janë më të ulëta se 50% e pages minimale mujore. Të ardhurat e një personi që nuk jeton në familje konsiderohen të pamjaftueshme nëse janë më të ulëta se niveli i pages minimale mujore të përcaktuar me VKM dhe "pasuri" e një personi konsiderohet e pamjaftueshme sipas pikës 1 të nenit 12 të ligjit 111/2017 nëse vlera e saj nuk kalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi.

Në vlerësimin e Ministrisë së Drejtësisë me shkresën e saj nr. 61/4 prot, dt. 26.6.2024 me objekt, "Mbi gjetjet e KLSH-se, gjatë auditimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas" përcjellë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, shprehet që rekomandimet janë jashtë fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë e cila gjykon që: "Amendimi i ligjit nr. 111/2017 Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti nuk mund të kryhet pa përcaktuar fillimisht minimumimin jetik sipas legjislacionit në fuqi".

Panvarësisht këtij fakti, me shkresën e DNJF-se, nr. 1406 prot, dt. 20.6.2024 u propozua një tryezë e përbashkët me të gjithë aktorët që administrojnë ndihmën juridike sipas nenit 6 të ligjit nr.111/2017 ku rezultatat e këtij takimi do të bëhen me dijeni Ministrisë së Drejtësisë. Shkresat bashkëlidhur

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin për pjesën takuese dhe zbatuar atë me organizimin e një tryeze me të gjithë aktorët dhe MSMSH e cila e ka si kompetence direkte.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht .

1.1.2 A kanë qenë burimet financiare të mjaftueshme, me qëllim sigurimin e kushteve infrastrukturore të nevojshme për personat e paraburgosur?

Gjetje nga auditimi:

2. Sa i përket garantimit të sigurisë:

- Vendosja e monitorëve të cilët ofrojnë pamje të kamerave të instaluar në çdo ambient të IEVP-ve vetëm në sallat operative, monitorimi i tyre vetëm nga dy operatorë brenda një turni dhe qëndrimi me orare të zgjatura vëzhgimi nga ana e operatorëve, ndikon negativisht në efektivitetin e procesit monitorues.
- IEVP-të që ofrojnë shërbim paraburgimi kanë numër të lartë vakancash në staf policor.

2.1 Rekomandimi:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për rishikimin e pikës “ë” të nenit 29 të Ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, i cili parashikon se: “Ka të drejtë të konkurrojë për t’u pranuar në Policinë e Burgjeve çdo person që është nën moshën 35 vjeç”.

Konstatohet se: Ky rekomandim është realizuar pasi është përmirësuar monitorimi me kamera.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë për shtimin e kamerave dhe në drejtim të rekrutimit ka dalë ligji nr.39/2022 dhe ka hequr kufizimin e moshës.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

1.2 Për pyetjen audituese: A kanë qenë strukturat përgjegjëse efektive në realizimin e objektivave, duke treguar kështu rol proaktiv dhe qasje bashkëpunuese midis tyre?

1.2.2 A ka bashkëvepruar DPB dhe IEVP-të në mënyrë integrale me DPP/DVP-të dhe aktorë të tjerë të përfshirë në proces, në funksion të garantimit të të drejtave për personat e paraburgosur?

Gjetje nga auditimi:

3. Në drejtim të bashkëveprimit ndërinstucional, nuk janë ngritur grupe të përbashkëta pune apo hartuar plane të përbashkëta veprimi për zbatimin e marrëveshjes dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes. Ndërkohë, marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nuk është përditësuar që nga marsi 2019 kur është nënshkruar.

3.1 Rekomandimi:

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrin masa për rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërinstucional si dhe të mblidhet të dy herë në vit për të analizuar implementimin e marrëveshjes dhe problematikat që hasen në zbatimin e saj.

Konstatohet: Lidhur me kete rekomandim, DPB dhe Policia e Shtetit kane kontakte te perditshme dhe ndajne informacione periodike te dy anshme ne referim te problematikave qe kane, bazuar ne kuadrin ligjor perkates te DPB dhe DP.

Po kështu grupit auditimit ju vu ne dispozicion dhe marrëveshja midis DPB dhe DPPSH me datë 04.03.2019 e cila është në fuqi dhe ka korrespondenca institucionale per implementimin e plotë të saj siç është Urdhëri i DP të Burgjeve nr.528, datë 14.04.2024 “Mbi standartizimin e procedurave të pranimit të shtetasve të paaburgosur në IEVP.

Po kështu dhe nga DPPSH ka disa urdheresa/Letër porosi për Drejtoritë Vendore të Policisë në rrethe , ku në zbatimdhe të detyrave e rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore e Degraduese (CPT) të KiE-së” ku kanë kërkuar zbatimin e rekomandimeve dhe mos përsëritjen e rasteve dhe shkeljeve te caktuara në dhomat e paraburgimit.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit në DPPSH dhe në DPBurgjeve mbi zbatimin e marrëveshjes konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë plotësisht në vijimësi .

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Për pyetjen audituese: “A janë hartuar politika dhe a sigurohen kushte të përshtatshme për të paraburgosurit, në përputhje me standardet ndërkombëtare?”

1.1.1 A është hartuar kuadri ligjor dhe rregullator i nevojshëm me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur?

Gjetje nga auditimi:

1. Në IEVP Lezhë (Shënkoll), krahas personave “të paraburgosur” dhe “të dënuar”, janë të akomoduar edhe 369 pacientë me çrregullime të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka vendosur masën “mjekim i detyruar”. Këta individ ndodhen të akomoduar në dy godina, në kushte të papërshtatshme për pacientë me çrregullime mendore që kanë nevojë për trajtim të specializuar. Staf i mjekësor në dispozicion të tyre përbëhet vetëm nga dy mjekë dhe trajtimi i tyre nuk është i diferencuar nga të burgosurit e tjerë, duke marrë në konsideratë statusin dhe nevojat e tyre.

2. Në kriteret e përfitimit të ndihmës juridike falas, të garantuar nga shteti ndaj personave që konsiderohen në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare, merren në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi por jo shpenzimet e detyrueshme dhe të nevojshme për jetesë.

3. Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk harton një listë të posaçme të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre, sikurse diktohet nga neni 31 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

4. DPB ende nuk ka konkluduar hartimin dhe miratimin e skemës dhe standardeve për mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin dhe vlerësimin e performancës për IEVP-të.

5. Takimet e zgjatura nuk zbatohen në asnjë rast për personat e paraburgosur. Referuar Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, këto takime ju mundësohen vetëm personave “të dënuar”.

6. Ligji nr. 81/2020 dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve nuk përcaktojnë afate të posaçme për trajtimin e ankesave të të paraburgosurve, kur ato shqyrtohen nga IEVP-të dhe kur shqyrtohen nga DPB.

7. Nga shqyrtimi i kontratave të punës midis “të paraburgosurve” dhe IEVP-së, grupi auditimit konstatoi pasaktësi në përpilimin dhe nënshkrimin e tyre. Në 6 nga 17 kontratat e shqyrtuara nga grupi i auditimit, mungonte data e fillimit të fuqisë juridike të tyre, si dhe numri i llogarisë bankare ku do të kalojnë të ardhurat e fituara nga punësimi i të paraburgosurit.

1.1 Rekomandim:

Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrin masa për ngritjen e një Institucioni Mjekësor të Posaçëm, duke ofruar kushte dhe një shërbim mjekësor të denjë për pacientë me çrregullime mendore.

Konstatohet se: Ministria e Shëndetësisë është angazhuar për këtë dhe po planifikon që ta zbatojë këtë projekt me fondet e IPA.

Pavarësisht se referuar akteve ligjore në fuqi, e konkretisht, nenit 15 të ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe nenit 56 të ligjit 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, institucioni ku trajtohen këta shtetas duhet të administrohet nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

Stafi i IEVP Lezhë ka parashikuar në bashkëpunim me sektorin e shëndetësisë në DPBurgjeve që kryejnë në vijimësi një trajnimi të mirëfilltë me qëllim fuqizimin e tyre si asete në kuadër të maksimizimit të shërbimit ndaj pacientëve.

Ndërsa për trajtimin e pacientëve me masë mjekësore po bashkëpunohet me Ministrinë e Shëndetësisë për gjetjen dhe përshpejtimin e zbatimit të zgjidhjeve alternative për këta shtetas, duke qenë se mbështetur në Ligjin 81/2020, neni 15, pika 2 ‘*Institucionet e kujdesit shëndetësor për personat për të cilat gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme administrohen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë*’.

Të gjithë të burgosurit me probleme të shëndetit mendor trajtohen konform ligjit 44/2012 “Për shëndetin mendor”, me të njëjtat standarde të strukturave të shëndetit publik, konsultohen nga mjekët psikiatër të sistemit të burgjeve dhe spitaleve rajonale dhe trajtohen sipas rekomandimeve të tyre.

Nga ana tjetër është evidentuar se, pacientët me masë mjekësore, me probleme të shëndetit mendor, mbahet nën mbikëqyrje të vazhdueshme nga ekipi multidisiplinar i përbërë nga mjeku psikiatër, psikologu dhe punonjësi social. Sa i përket trajtimit shëndetësor, pacientet ndiqen në mënyrë periodike me konsulta mjekësore psikiatrike, e madje këto paciente/të konsultohen nga mjekja psikiatër, si dhe dhënia e terapisë, sipas rekomandimeve të mjekut psikiatër, e cila administrohet nga infermierët e shërbimit në institucion.

DPB po merren masa në vijimësi për plotësimin e organikës me staf shëndetësor, sidomos me mjek psikiatër.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është bërë herë pas here shpallje on-line në faqen zyrtare të DPB-së, për vendet vakante të stafit shëndetësor (mjek, farmacist, stomatolog, infermier), por rekrutimi i stafit shëndetësor në sistemin e burgjeve ka qenë i vështirë për shkak të mungesës së kërkesave dhe interesimit për punësim nga ana e tyre. Nga ana tjetër evidentohet fakti se DPB e ka në vëmendje të veçantë rekrutimin e stafit punonjës sidomos të stafit shëndetësor dhe do të vijojnë me shpallje on-line.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë me nxjerrjen masat e marra në drejtim të trajnimit intensiv me

stafin mjekësor që ka në dispozicion dhe po sheh mundësitë për nxitjen e marrjes së stafëve me të kualifikuar, ndonëse ka mungesa në ofrime .

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht .

2.1 Rekomandim: Ministria e Drejtësisë të kryejë një analizë të mirëfilltë, për përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike dytësore falas.

Konstatohet: : Në lidhje me rekomandimin 1.2 është sqaruar: Perfituesit e ndihmes juridike të garantuar nga shteti (ndihmë juridike parësore/dytësore) janë shtetasit shqiptar me vendbanim ose vendqëndrim në RSH, shtetasit e huaj që janë të pajisur me leje qëndrimi, etj. Ndhima juridike i ofrohet personave që janë kategori e veçantë e ligjit dhe çdokush që provon me dokumentacion që nuk ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim në çeshtjet civile, penale dhe administrative. Neni 11 dhe 12 i ligjit nr.111/2017.

Të "ardhurat" e një personi i i cili jeton në familje konsiderohen të pamjaftueshme sipas pikës 1 të këtij neni, nëse të ardhurat e të gjithë familjes të pjesëtuara me numrin e anëtarëve janë më të ulëta se 50% e pages minimale mujore. Të ardhurat e një personi që nuk jeton në familje konsiderohen të pamjaftueshme nëse janë më të ulëta se niveli i pages minimale mujore të përcaktuar me VKM dhe "pasuri" e një personi konsiderohet e pamjaftueshme sipas pikës 1 të nenit 12 të ligjit 111/2017 nëse vlera e saj nuk kalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi.

Në vlerësimin e Ministrisë së Drejtësisë me shkresën e saj nr. 61/4 prot, dt. 26.6.2024 me objekt, "Mbi gjetjet e KLSH-se, gjatë auditimit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas" përcjellë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, shprehet që rekomandimet janë jashtë fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë e cila gjykon që: "Amendimi i ligjit nr. 111/2017 Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti nuk mund të kryhet pa përcaktuar fillimisht minimumimin jetik sipas legjislacionit në fuqi".

Panvarësisht këtij fakti, me shkresën e DNJF-se, nr. 1406 prot, dt. 20.6.2024 u propozua një tryezë e përbashkët me të gjithë aktorët që administrojnë ndihmën juridike sipas nenit 6 të ligjit nr.111/2017 ku rezultatet e këtij takimi do të bëhen me dijeni Ministrisë së Drejtësisë. Shkresat bashkëlidhur

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin për pjesën takuese dhe zbatuar atë me organizimin e një tryeze me të gjithë aktorët dhe MSMSH e cila e ka si kompetencë direkte.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht .

3.1 Rekomandim:

Ministria e Drejtësisë të kërkojë nëpërmjet Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, që Dhoma Kombëtare e Avokatisë të hartojë listën e veçanta të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre.

Konstatohet: Dhoma Kombëtare e Avokatisë miraton me udhëzim të përbashkët me DNJF, kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore. Pika a) neni 9 i ligjit nr. 111/2017. Për këtë qëllim është miratuar Udhëzimi i përbashkët nr. 1 datë 15.2.2023 ndërmjet kryetarit të DHKA dhe titullarit të DNJF-së, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore". Fletore zyrtare numri 25 viti 2023.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë me përgatitjen e një Udhëzimi përkatës.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

4.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për hartimin dhe miratimin e skemës dhe standardeve për mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin dhe vlerësimin e performancës për IEVP.

Konstatohet se: Nga DP Burgjeve:

- I është kërkuar Komisionit European që të përfshihet si aktivitet në fazën e tretë të projektit “Horizontal Facility” për hartimin e këtij dokumenti dhe kjo është në proces zbatimi.
- Është hartuar një dokument motivimi për stafin, i cili përmban mundësi të rregjistrimit në shkolla të larta dhe studim pa pagesë në katër universitete me nga tre bursa pa pagese dhe në raste të tjera me gjysëm pagese.
- Marrëveshje janë lidhur me Universitetin P., E., T..., M...¹
- Janë hartuar fletpalosje për nxitjen e punësimit në sistemin e burgjeve dhe reklama promovuese (flete palosje janë në dokumentacionin e auditimit).
- Është zgjidhur problemi i transportit për punonjësit e policisë së burgjeve me shtimin e mjeteve të transportit.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin, është punuar dhe aktualisht është hartuar dokumenti i motivimit për stafin, dhe janë kryer marrëveshje për studime me bursa pa pagesë si dhe është zgjidhur përfundimisht problemi i transportit të stafeve të IEVP-ve.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

5.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për amendimin Rregullore të Përgjithshme të Burgjeve. Përkatësisht, të rishikohet neni 40 i kësaj rregulloreje në përputhje me ligjin nr. 81/2020. Gjithashtu, DPB të marrë masa që në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve të përcaktohen afate të posaçme për trajtimin e kërkesave/ankesave të personave të paraburgosur, në rastet kur ajo do të shqyrtohet nga vet IEVP dhe përcaktimin e afateve të trajtimit të tyre nga ana e DPB-së.

Konstatohet se: Është ngritur Grupi i Punës për hartimin e Rregullores së re të DPB dhe rregulloreve të IEVP-ve, me Urdher Nr.525, datë 11.04.2024. Drafti është dërguar në Drejtorinë e Kodifikimit në MD me email.²

Në draft të rregullores ka të parashikuar edhe shkurtimin e kohës së kthimit të përgjigjeve, sipas kategorive të ankesave dhe kërkesave. Si në rastin kur: kërkesa për leje shpërblyese ezaurohet brenda javës. Kërkesa për leje të veçantë, ezaurohet brenda 24 orëve, ose më shpejt.

Kërkesat që kanë të bëjnë me procedura ankimi për masa disiplinore, procedohet sipas kritereve ligjore të caktuara.

- ¹ Web site të DPBurgjeve

²Kopje Draft rregullore administrohet nga grupi i auditimit KLSH

Qëndrimi i audituesit të KLSH : Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin, është punuar dhe aktualisht është hartuar rregullorja e DPB dhe e IEVP-ve dhe është për miratim në Drejtorinë e Kodifikimit në MD.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

6.1 Rekomandim:

IEVP-të të marrin masa për nënshkrimin e saktë dhe të rregullt të kontratave të punës ndërmjet personave të paraburgosur dhe IEVP-së. Kontratat të përmbajnë të gjitha përcaktimet e nevojshme që garantojnë respektimin e të drejtave që lindin nga marrëdhënia e punësimit, si: koha e fillimit të efektit juridik të tyre dhe llogaria bankare në të cilën do të kalojë shpërblimi.

Konstatohet se: Ky rekomandim është realizuar me përgatitjen dhe nxjerrjen e Urdhërit Nr.244, datë 10.02.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë me nxjerrjen e Urdhërit përkatës për zbatim.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

1.1.2. A kanë qenë burimet financiare të mjaftueshme, me qëllim sigurimin e kushteve infrastrukturore të nevojshme për personat e paraburgosur?

Gjetje nga auditimi:

8. DPB dhe IEVP-të nuk kanë kryer një analizë dhe shpërndarje proporcionale të të paraburgosurve, sipas kapaciteteve dhe infrastrukturës së ngritur.

9. Në analizën e shpenzimeve të kryera për realizimin e përdorimit të fondeve buxhetore të planifikuara, është konstatuar se nuk ka patur bashkëpunim të organizuar e koordinuar me Agjencinë e Prokurimeve të Përqendruara për kryerjen e prokurimeve në kohë dhe lëvrimin e tyre, për blerjen e 4 autoburgjeve, një autoambulancë, blerje uniforme policie dhe material kazermimi për të dënuarit dhe paraburgosurit dhe shërbime të tjera.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka mbajtur e dokumentuar në mënyrë analitike të dhënat ekonomiko financiare të sektorit të paraburgimit (veçmas) për të pasur një pasqyrë të saktë analitike të shpenzimeve e kostos faktike për një të paraburgosur dhe ndarë sipas IEVP-ve.

11. Në lidhje me realizimin e nën objektivit 4.3.4 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 nuk është bërë asnjë progres dhe nuk është gjeneruar asnjë nga produktet e kërkuara, edhe pse dokumenti strategjik ndodhet në vitin e dytë të zbatimit të tij.

7.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, të kryejnë analiza të llogaritjes së kostove të trajtimit të paraburgosurve dhe të programojë shpërndarjen e tyre.

Konstatohet se: Ky rekomandim është realizuar me analizën dhe shtjellimin e hartimit të kostos për një dënuar dhe nuk ka asnjë ndryshim me koston e të paraburgosurve, këtu veçohet vetëm raporti i shpenzimeve të lëvizjeve me mjete sigurie të burgosur/paraburgosur.

Të drejtat lidhur me trajtimin e të paraburgosurve janë të njëjta me të dënuarit dhe për rrjedhojë nuk ka ndryshim kostoje. Ndryshime mund të vijnë për shkak të kushteve dhe nevojave të ndërtesave për mirëmbajtje dhe investime si dhe për shkak të shoqërimeve të paraburgosurve nga I EVP-të në gjykata.

Megjithatë Drejtoria e Financës në DPB ka përlogaritur kostot e shpenzimeve për kategori të ndryshme të popullatës së burgjeve dhe rezultton:

Kostoja faktike ditore për një të dënuar sipas kategorive për vitin 2023							
	Kategoria	Shp. Lekë/ viti 2023	numri	365 ditë/12 mujori	Shpenzime lekë/ditë/ 1 person	Kursi këmbimit	Shpenzime Euro/ditë / 1 person
12.0	Të gjithë	7,794,211,123	5,681	365	3,759	119.00	31.59
12.1	Të p/burgosur	4,158,435,850	2,994	365	3,805	119.00	31.98
12.2	Të dënuar	2,797,065,060	2,197	365	3,488	119.00	29.31
12.3	Të sëmurë	651,837,988	458	365	3,899	119.00	32.77
12.4	Të mitur	25,176,290	32	365	2,156	119.00	18.11

TREGUES PERFORMANCE			
	VITI 2023		VITI 2024
Te Denuar Plan/Te punesuar Plan	1.19		1.25
Te Denuar Fakt/Te punesuar Fakt	1.44		1.30
Shpenzime Operative Plan/ Te Burgosur Plan	1,422,053		1,301,539
Shpenzime Operative Fakt/Te Burgosur Fakt	556,096		625,733
Shpenzime kapitale Plan/Te Burgosur Plan	39,927		52,283
SHPENZIME VJETORE TOTAL PLAN ALL	1,461,980		1,353,822
SHPENZIME DITORE/DENUAR ALL	4,005.43		3,709.10
SHPENZIME DITORE/DENUAR EUR (kursi 100.5)	39.85		36.91
SHPENZIME DITORE FAKT ALL	3,266		3,715
SHPENZIME DITORE FAKT EUR	32.50		36.97

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë duke kryer analiza e parë mundësitë për rishikimin e dokumentacionit.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

8.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të hartojnë regjistra dokumentimi të treguesve ekonomik financiar veçmas për sektorin e paraburgimit dhe për trajtimin e të burgosurve, duke siguruar kështu të dhëna të plota e të besueshme për menaxhimin e sektorit të paraburgimit, si dhe të bashkëpunojë me Agjencinë e Prokurimeve të Përqendruara, për zhvillimin e procedurave të prokurimit brenda afateve ligjore.

Konstatohet se: Nga auditimi u konstatua se stafi menaxhues i DPBurgjeve po punohet për një format raportimi për të dënuar, të paraburgosur dhe kategori të tjera. Synohet që të bëhen edhe analiza të tjera si; kosto për hartën e re gjyqësore, etj. Po kështu evidentohet fakti se janë kryer procedurat e blerejeve të ambulancave dhe mjeteve të transportit auto-burg dhe pengesa me AZHPP është zgjidhur dhe nuk ka patur vonesa. Pra ky rekomandim është në proces zbatimi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë dhe po punon me nxjerrjen e një formati raportimi ekonomik financiar më të plotë.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

9.1 Rekomandim:

Ministria e Drejtësisë të marrë masa për kryerjen e një analize, në lidhje me mbikëqyrjen dhe kontrollin e brendshëm financiar në shërbimin e burgut, duke hartuar kështu regjistra risku, në zbatim detyrimeve që burojnë nga Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë.

Konstatohet: Ky rekomandim është pranuar e zbatuar plotësisht me hartimin e regjistrit të riskut dhe zbatimin e tij dhe për pjesën e mbulimit financiar. Për këtë ka një urdhër Nr. 1990 prot., datë 21.02.2020 “ Për hartimin e Rregjistrit të Riskut” nga Drejtori i Përgjithshëm dhe dhe është ngritur Sektori i vlerësimit riskut, pergatitur formati i regjistrit (bashkëlidhur).

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë me pergatitjen e nje Udhërit përkatës.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe është zbatuar plotësisht .

1.2 Për pyetjen audituese: A kanë qenë strukturat përgjegjëse efektive në realizimin e objektivave, duke treguar kështu rol proaktiv dhe qasje bashkëpunuese midis tyre?

1.2.1 A ka qenë DPB dhe I EVP-të efektive në mirë administrimin e sistemit penitenciar?

Gjetje nga auditimi:

12. Sa i përket garantimit të sigurisë:

- Vendosja e monitorëve të cilët ofrojnë pamje të kamerave të instaluara në çdo ambient të I EVP-ve vetëm në sallat operative, monitorimi i tyre vetëm nga dy operatorë brenda një turni dhe qëndrimi me orare të zgjatura vëzhgimi nga ana e operatorëve, ndikon negativisht në efektivitetin e procesit monitorues.

- I EVP-të që ofrojnë shërbim paraburgimi kanë numër të lartë vakancash në staf policor.

13. Sa i përket kushteve të trajtimit, mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes nuk respektojnë dinjitetin njerëzor dhe as hapësirat e nevojshme për banim. Mbipopullimi në sektorët e paraburgimit paraqitet në shifra problematike pothuajse në të gjitha I EVP-të. Në I EVP Durrës, për shkak të mbipopullimit, dhomat e observimit përdoren si dhoma banimi për personat e paraburgosur.

14. Kushtet që ju ofrohen personave të paraburgosur në I EVP-të në të cilat ata janë akomoduar nuk përmbushin standardet kombëtare e ndërkombëtare, si dhe nuk respektojnë dinjitetin njerëzor. Problematikat kryesore të konstatuara në sektorët e paraburgimit pranë I EVP-ve lidhen me mungesën e sistemeve të ngrohjes, prezencën e lagështirës, mungesën e dritës natyrale dhe ventilimit, mungesën e unifikimit dhe standardizimit e kushteve të ofruara nga një I EVP në tjetrën dhe mungesën e dhomës së prindërimit në distancë.

Sa i përket kushteve higjieno-sanitare, Në I EVP Fushë-Krujë mungojnë dushet dhe uji i ngrohtë. E njëjta situatë problematike konstatohet edhe në I EVP Burrel, ku përveç mungesës së dusheve, mungonte edhe furnizimi me uji. Ndërkohë që, në I EVP Shkodër, Fier, Lezhë,

Durrës vendosja e dusheve nuk respektonte privatësinë individuale të personave të paraburgosur.

15. Pavarësisht faktit se, Udhëzimi i Përbashkët nr. 1, datë 22.02.2022 i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, parashikon shtimin e disa produkteve në menu-në ushqimore, me qëllim përmirësimin e shijes dhe larmishmërisë, këto produkte ende nuk janë shtruar. Menu-ja ushqimore në I EVP nuk paraqet shumëllojshmëri dhe nuk ndryshohet çdo dy javë, sikurse përcaktohet në aktin nën ligjor të sipërcituar.

-Një sasi e konsiderueshme e ushqimit (rreth 25%) nuk konsumohet në I EVP. Nga takimet e zhvilluara në regjimet e sektorëve të paraburgimit gjatë fazës së terrenit, grupi i auditimit konkludoi se personat e paraburgosur, në disa raste nuk ishin të kënaqur me ushqimin e ofruar në I EVP (shijen; menu-n; cilësinë) dhe në disa raste të tjera, për shkak se merrnin furnizime ushqimore nga familja ishin indiferent dhe të pa interesuar për të konsumuar ushqimin e ofruar nga I EVP-të.

16. Sa i përket garantimit të të drejtës për shëndet, institucionet e paraburgimit nuk janë të pajisura gjithmonë me një sistem të kujdesit shëndetësor. Numri total i mjekëve të angazhuar në një I EVP, referuar organikës së stafit të mjekësisë në sistemin penitenciar, varjon nga 1-4, ku përfshihen mjekët e përgjithshëm dhe mjekët psikiatër. Problemet e konstatuara nga grupi i auditimit, ishin:

- Raporti ndërmjet stafit mjekësor të angazhuar dhe numrit të të paraburgosurve që mbulon një mjek nga një I EVP në tjerën nuk është i njëjtë.

- Në lidhje me vakancat, në I EVP Shkodër, Burrel, Fier, Fushë-Krujë, Berat dhe Lezhë kishte nga 1 vakancë për pozicionin mjek. Ndërkohë që në I EVP Korçë kishte 3 vakanca për pozicionin mjek, ndërsa në I EVP “Jordan Misja” dhe Peqin grupi i auditimit konstaton nga 2 vende vakante.

- Problem shqetësues në I EVP është dhe mungesa e autoambulancave, për transportimin në rast emergjence të të sëmurëve për në spital. Në I EVP “Ali Demi”, “Mine Peza”, Vlorë, Kavajë, Berat, Durrës, Burrel, Kukës, Tepelenë, Fushë-Krujë, Elbasan nuk ka autoambulancë me qëllim transportimin e personave të sëmurë në raste urgjence për në spital.

17. I EVP-të nuk kanë krijuar kushte për ofrimin e programeve rehabilituese dhe vetëzhvillimin profesional brenda institucionit. Lidhur me këtë fakt:

- I EVP Tepelenë dhe Lezhë nuk ishin të pajisura me një ambient biblioteke për të paraburgosurit.

- I EVP-të nuk kryejnë një vlerësim paraprak të përshtatshmërisë së titujve dhe përmbajtjes së librave të dhuruara nga donatorët për personat e paraburgosur. Nga auditimi i zhvilluar, grupi i auditimit konstaton disa botime, të cilat jo vetëm që nuk ndikojnë pozitivisht në vet zhvillimin e personave të paraburgosur, por njëkohësisht mund të rëndojnë gjendjen e tyre psikologjike.

- Në I EVP Kukës, Shkodër, Burrel, Fier, Elbasan, Tepelenë, Berat dhe Durrës nuk ofrohet arsim i ulët dhe i mesëm. Ndërkohë që, në I EVP Fushë-Krujë, Mine Peza, Korçë, Peqin dhe Vlorë ofrohet vetëm arsim 9-vjecar.

- I EVP Kukës, Burrel, Elbasan, Tepelenë, “Mine Peza”, “Jordan Misja”, Lezhë dhe Shkodër nuk ofrojnë asnjë kurs të zhvillimit profesional për personat e paraburgosur. Ndërkohë që, I EVP Peqin shprehet se ka marrëveshje për kurse por ato nuk frekuentohen nga të paraburgosurit.

Procesi i programeve të trajnimit për personat e paraburgosur paraqitet i cunguar. Numri i punonjësve social në raport me personat e paraburgosur për trajtim është në disproporcion dhe ndryshon nga një I EVP në tjetër.

18. Në disa institucione paraburgimi mungonin dhomat e kultit. Ky fakt, i vështirëson personit të paraburgosur kryerjen e riteve fetare dhe çënon të drejtën e tij për praktikimin e fesë së besimit të tij.

10.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për riorganizimin e punës së procesit të monitorimit. Për këtë qëllim, të mundësohen monitorim me kamera në çdo sektor shërbimi.

Konstatohet se: Ky rekomandim është realizuar pasi është përmirësuar monitorimi me kamera.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë për shtimin e kamerave dhe në drejtim të rekrutimit ka dalë ligji nr.39/2022 dhe ka hequr kufizimin e moshës.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

11.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për problematikën e mbipopullimit të sistemit të paraburgimit, duke hapur më shumë sektorë paraburgimi, si dhe duke bërë një shpërndarje më propocionale të individëve të paraburgosur, në përputhje edhe me përcaktimet ligjore.

Konstatohet se: Ky rekomandim është realizuar me zbatimin e Ligjit Nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”, ku janë liruar 898 të dënuar si dhe është pushuar ndjekja penale për disa vepra penale. Aktualisht janë 1020 vende të lira nga kapaciteti prej 5700 shtretër.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë zbatimin e ligjit nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie” .

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

12.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të marrin masa për plotësimin të gjitha kushteve që IEVP-të duhet të plotësojnë ndaj personave të paraburgosur.

IEVP-të të ndajnë praktika të mira mes njëra tjetrës për trajtimin e problematikave të ndryshme të konstatuara gjatë vijimësisë së punës dhe menaxhimit të sistemeve të paraburgimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të standardizoj kushtet që duhet të plotësojë çdo IEVP, me qëllim unifikimin e tyre dhe trajtimin e barabartë mes të paraburgosurve, pavarësisht institucionit në të cilin janë akomoduar.

Konstatohet: DPB ka vlerësuar dhe ka thelluar punën e saj menaxhuese për ta patur si praktikë pune shkëmbimin e eksperiencave pozitive të IEVP-ve në standartizimin e praktikave më të mira, nëpërmjet trajnimeve, seminareve, vizitave, etj. Janë bërë vizita në IEVP Fier me të gjithë drejtorët e IEVP-ve dhe stafin e trajtimit social. Kjo praktikë është evidentuar edhe nga Komisioni i Sigurisë në Kuvend e Shqipërisë.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik dhe informacionit të marrë nga drejtuesit në intervistimet e kryera nga grupi i auditimit rezulton se subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë .

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

13.1 Rekomandim:

Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të marrin masa për ndryshimin e menu-së ushqimore çdo dy javë. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për shtimin e asortimenteve të parashikuara sipas normës së miratuar për personat e paraburgosur, si dhe për hartimin e një akti normativ për mënyrën e trajtimit dhe menaxhimit të ushqimit që kthehet dhe nuk konsumohet nga të burgosurit.

Konstatohet: Sipas ligjit Nr.81/2020 për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosur, parashikohet ndryshimi i menusë ushqimore çdo dy javë.

Norma ushqimore është e përcaktuar. Brenda normës DPB për herë të parë ka prokuruar produkte të tjera me qëllim larmishmërinë e dietës ushqimore, ku janë ndryshuar llojet e ushqimeve bishtajore, bulmet etj..

Kontrolli i ushqimeve dhe cilësia e gatimit është përmirësuar dhe sipas verifikimeve dhe informacionit është vlerësuar edhe nga institucionet monitoruese.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit dhe informacionit të marrë nga drejtuesit në intervistimet e kryera nga grupi i auditimit rezulton se subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë, ku ka dhe vlerësime të institucioneve monitoruese.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

14.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të marrin masa me qëllim plotësimin e vendeve vakante të stafit mjekësor të angazhuar në sitemin penitenciar dhe pajisjen me autoambulanca të të gjitha I EVP-ve, me qëllim ofrimin e një qasje efektive dhe të barabartë në shërbime shëndetësore kah personave të paraburgosur.

Konstatohet: DPB ka marrë masa në vijimësi për plotësimin e organikës me staf shëndetësor, sidomos me mjek të përgjithshëm e psikiatër.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është bërë herë pas here shpallje on-line në faqen zyrtare të DPB-së, për vendet vakante të stafit shëndetësore (mjek, farmacist, stomatolog, infermier), por rekrutimi i stafit shëndetësor në sistemin e burgjeve ka qenë i vështirë për shkak të mungesës së kërkesave dhe interesimit për punësim nga ana e tyre. Nga ana tjetër evidentohet fakti se DPB e ka në vëmendje të veçantë rekrutimin e stafit punonjës sidomos të stafit shëndetësore dhe do të vijojnë me shpallje on-line.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar, verifikimit dhe informacionit të marrë nga drejtuesit në intervistimet e kryera nga grupi i auditimit rezulton se subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe marrë masa e po punon në vijimësi për të përmbushur nevojat me staf mjekësor.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

15.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të marrin masa për ofrimin e arsimit të ulët dhe të mesëm në institucionet që ofrohet shërbim paraburgimi (duke marrë në konsideratë nevojat dhe kërkesat e të paraburgosurve), ofrimin e programeve të larmishme rehabilituese nëpërmjet kurseve të ndryshme profesionale, si dhe të

bëjnë një përzgjedhje të librave të dhuruar që do të vendosin në përdorim për personat e paraburgosur.

Konstatohet: Është lidhur marrëveshja me MAS për arsimimin e të burgosurve, po kështu edhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për kryerjen e kurseve profesionale dhe këto marrëveshje janë në zbatim dhe ka rezultate e impakt pozitiv tek të burgosurit dhe paraburgosurit.

Nga DPBurgje, aktualisht është ndërmarrë një nismë ligjore shumë e rëndësishme, për kalimin në burg të hapur të personave që ju ka mbetur më pak se gjashtë muaj dënim, sipas nenit 20, të Ligjit 81/2020. Kjo krijon mundësi shkollimi, punësimi dhe kurseve të aftësimi profesional.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar,verifikimit dhe informacionit të marrë nga drejtuesit në intervistimet e kryera nga grupi i auditimit rezulton se subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe marrë masa e po punon në vijimësi për të përmbushur zbatimin e rekomandimit.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

16.1Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP-të, nëpërmjet kushteve infrastrukturore të marrin masa për krijimin e dhomave të kultit në institucionet e paraburgimit.

Konstatohet: Nga DPB është marrë masa që në të gjitha IEVP të funksionojnë dhomat e kultit.

Stafi i IEVP-ve është njohur me Udhëzimin për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe detyrat e ngarkuara nga ana Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në vijimësi³.

Të gjithë IEVP-të raportojnë se kanë ambjente kulti, sipas besimit, ku të dënuarit/paraburgosurit ushtrojnë ritet fetare. Në gjithë sistemin e burgjeve evidentohet se janë 24 ambjente kulti (të besimit musliman, ortodoks, katolik)⁴

Sipas statistikave të raportuara janë 822 të burgosur/paraburgosur) që praktikojnë ritet e besimeve fetare (të besimit musliman, ortodoks, katolik)⁵.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë plotësisht .

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

1.2.2 A ka bashkëvepruar DPB dhe IEVP-të në mënyrë integrale me DPP/DVP-të dhe aktorë të tjerë të përfshirë në proces, në funksion të garantimit të të drejtave për personat e paraburgosur?

Gjetje nga auditimi:

19. Në lidhje me bashkëveprimin e institucioneve në garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur janë konstatuar disa mangësi:

³ Lidhur me ekstremizmin e dhunshëm janë trajnuar rreth 330 punonjes te IEVP

⁴ Korçë 1; Jordan Misja 2; Fushë-Krujë 2;Berat 2;Burrel 2; Durrës 2, Elbasan 2;Lezhë 2;Peqin 3;Fier 3.

⁵ Fieri 314 praktikante (143 musliman);Lezha 25;Mine Peza 95;Peqini 82;Fushë Kruja 51;Korça 123;Berati 32, Burreli 36;Durrësi 64.

- disa të paraburgosur në pritje të transferimit të tyre në një IEVP janë mbajtur në ambientet e dhomave të sigurisë në DVP për periudha të zgjatura, të cilat shkojnë nga 3-5 ditë pas marrjes së masës së sigurimit të dhënë nga gjykata,
- ka raste të vonesave në transferime si rezultat i mospranimit nga IEVP-të të personave me masën e sigurisë “*arrest me burg*”, me argumentin se ka mbipopullim dhe mungesë të ambienteve për akomodim, si dhe për shkak të mangësive në dokumentacionin shoqëruar të përgatitur nga ana e Policisë, identifikimit me gjurmët daktiloskopike dhe fotove bashkëlidhur, mos plotësimi në kohë i dokumentacionit të gjendjes së pacientit nga ana e personelit mjekësor, etj.

17.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë Vendore të Policisë, të evitojnë mbajtjen e personave të paraburgosur pranë ambienteve të policisë përtej afateve të përcaktuara, si dhe plotësojnë në kohë sipas kërkesave, dokumentacionin për dërgimin e personave të paraburgosur në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Konstatohet se: Ky rekomandim është zbatuar me Urdher Nr.528, date 14.04.2024 bashkëlidhur Akt verifikimit. Gjithashtu DPB ka vlerësuar procedurat e pranimit në 200 raste dhe në asnjë rast nuk ka patur vonesa me shumë se dy-tre orë nga njoftimi i Komisariateve (bashkëlidhur).

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe zbatuar atë në vijimësi .

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar plotësisht.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresat nr. 592/13, 14,15 prot, datë 14.02.2023, konstatohet se rekomandimet e dërguar janë zbatuar plotësisht dhe kemi rekomandim që vazhdon procesi i zbatimit për shkak të afatit se disa rekomandime kanë fushë zbatimi kohore në vijimësi, dhe për të rritur nivelin e menaxhimit të IEVP-ve dhe në Drejtoritë Vendore të Policisë, **kërkojmë** që të vazhdohet me implementimin e plotë të planit të zbatimit të rekomandimeve të dërguar në KLSH, duke ndikuar në përmirësimin e menaxhimit të shërbimit të paraburgimit në institucionet përkatëse.

3. PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “FUQIZIMI EKONOMIK I GRUAS NË VENDIN TONË”.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I. 1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 914 prot., datë 08.07.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në gjashtëmujorin e parë të vitin 2023”, ushtroi auditim në 4 (katër) subjektet pjesë e Auditimit të Përformancës me temë: “Fuqizimi Ekonomik i Gruas në Vendin tonë”, përkatësisht në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Auditimi i kryer në vitin 2023, kishte si periudhë auditimi vitet 2016 - 2021 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me Vendimin nr. 57 datë 04.04.2023 të Kryetarit të KLSH-së si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat nr. 588/17, 18, 19, 20, 21, prot., datë 05.04.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a.** Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b.** Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- c.** Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet objekt auditimi u mbajtën Akt-Verifikimet përkatëse të cilat janë regjistruar përkatësisht:

- Në MSHMS me nr. 3092/1, prot, datë 01.08.2024;
- Në MBZHR me nr. 5255 prot, datë 01.08.2024;
- Në MF me nr. 9592/1, datë 01.08.2024;
- Në AKPA me nr. 1693/1, darë 01.08.2024

I. 2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh

Në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH^{së}, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi se:

1. Ministria e Financave ka dërguar me shkresën nr. 6190, prot., datë 03.04.2023 planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH – së për rekomandimet drejtuar vetë MF si dhe AKPA - së, protokolluar me tonën me nr. 588/22, prot., datë 12.04.2023.

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 1090/1. Prot., datë 29.03.2023 planin e masave paraprak për zbatimin e rekomandimeve të KLSH – së, protokolluar me tonën me nr.588/14, datë 04.04.2023 dhe me shkresën nr. 1090/3, prot., datë 24.04.2023, ka dërguar planin e masave përfundimtar.

3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave 20 ditor.

I. 3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh

Për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të

Lartë të Shtetit", përcaktohet se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi i respektimit të këtij afati rezultoi se:

1. Ministria e Financave nuk ka hartuar dhe dërguar raportimin 6 mujor në KLSH sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka hartuar dhe dërguar raportimin 6 mujor në KLSH sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka hartuar dhe dërguar raportimin 6 mujor në KLSH sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
4. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nuk ka hartuar dhe dërguar raportimin 6 mujor në KLSH sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

I. 3. Statusi i pranimit të rekomandimeve

Sipas shkresave përcjellëse me nr. 588/17, 18, 19, 20, 21, prot., datë 05.04.2023 të Raportit Përfundimtar të Auditimit janë rekomanduar gjithsej:

✓ Masa organizative 14 rekomandime

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, shkresave të përcjella nga subjektet KLSH, referuar planit të masave lidhur me rekomandimet e lëna rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Masa Organizative	14	12	2

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve" miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 13.06.2021.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 914 prot., datë 08.07.2024 "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në gjashtëmujorin e parë të vitin 2023". Rekomandimet e lëna në Raporti Përfundimtar i Auditimit të mëparshëm me temë "Fuqizimi Ekonomik i Gruas në Vendin Tonë" me konkluzionet përkatëse janë miratuar me Vendimin nr. 57 datë 04.04.2023 të Kryetarit të KLSH-së dhe janë përcjellë në subjektet e audituara me shkresat nr. 588/17, 18, 19, 20, 21, prot., datë 05.04.2023.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. Xh.Ç, *përgjegjës grupi*.
2. M.L, *anëtar*.
3. L.Gj, *anëtar*.

Auditimi ka filluar më, 08.07.2024

Auditimi ka përfunduar më, 02.09.2024.

II. 1. Objekti i auditimit

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara në Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Financave dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive përcjellë me shkresat nr. 588/17, 18, 19, 20, 21, prot., datë 05.04.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II. 2. Qëllimi auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II. 3. Metodologjia e auditimit

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

II. 4. Konkluzioni

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat nr. 588/17, 18, 19, 20, 21, prot., datë 05.04.2023, rezulton se nga **14 (katërbëdhjetë) masa të rekomanduara**, janë pranuar **12 (dymbëdhjetë)** dhe nuk janë pranuar **2 (dy)** masa. Nga të pranuarat:

- ✓ janë zbatuar **7 rekomandime** ose 58.3 % e tyre,
- ✓ zbatuar pjesërisht **1 rekomandim** ose 8.4% e tyre,
- ✓ gjenden në proces zbatimi **4 rekomandime** ose 33.3 % e tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa organizative	12	7	1	4	0

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	14	100
2	Pa pranuar	2	14%
3	Pranuar	12	86%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	- Zbatuar Plotësisht	7	58.3%
2	- Zbatuar pjesërisht	1	8.4%
3	- Në proces zbatimi	4	33.3%
4	- Pa zbatuar	0	-

II. 5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna

Pavarësisht nga puna e bërë, niveli i zbatimit të rekomandimeve është rreth **58.3 %**, është zbatuar pjesërisht **1 rekomandim** ose **8.4%** si dhe janë ende në proces zbatimi **4 rekomandime** ose **33.3%** e tyre. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjektet e audituara për përmbushjen e rekomandimeve të lëna dhe garantimin e një menaxhimi më të mirë në këtë drejtim.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. A ka qenë efektiv zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor?

Gjetje nga auditimi:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë qenë pjesërisht efektive në realizimin e objektivave mbi numrin e programeve që do të integronin buxhetimin gjinor, vetëm 31% e tyre nga 70% që ishte objektivi janë përfshirë BPGJ në PBA. Si dhe nuk është implementuar BPGJ për NJVQV.

2. Planifikimi i BPGJ në programet ekzistuese nga ML nuk ka tregues më ndarje gjinore edhe monitorimi e gjurmueshmëria e shpenzimeve buxhetore dhe vlerësimi e matja e ndikimeve të tyre nuk janë realizuar. Sistemet elektronike të menaxhimit dhe monitorimit të buxhetit nga MFE nuk kanë kodifikim për treguesit e produkteve me ndarje gjinore.

Rekomandim:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim të dakordësojnë plane vjetore trajnimesh, në fuqizimin e kapaciteteve planifikuese, monitoruese dhe vlerësuese të institucioneve qendrore e vendore për programet buxhetore në përgjithësi dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

Nga MSHMS: Trajnimet për punonjësit e administratës Publike janë detyrim i ASPA, ku me mbështetjen dhe nga UN Women është depozituar një modul lidhur me Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor, i cili realizohet në seanca trajnimi përgjatë gjithë vitit.

1. Në zbatim të rekomandimit, si dhe në zbatim të planit kombëtar të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave si dhe me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, gjatë vitit 2023 ka zhvilluar trajnime me temën “Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në nivel vendor” dhe “Buxhetimi gjinor për pakicat rome dhe egjiptiane - Reflektimi në nivel vendor”, për nëpunësit e Administratës Publike.

2. Gjatë vitit 2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave, organizoi Tryezën e Konsultimit me temë “Mbi Hartimin e Treguesve të Performancës me Bazë Gjinore në Buxhetin Vjetor 2024”. Tryeza kishte si qëllim integrimin gjinor në programet buxhetore afatmesme. Të gjitha ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera buxhetore qendrore, duhet të kryejnë analiza me bazë gjinore të sektorit përkatës, me qëllim përcaktimin e objektivave dhe treguesve të performancës me bazë gjinore, që ndihmojnë në kryerjen e analizave gjinore të sektorit përkatës dhe matjen e performancës së programit buxhetor.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ka ndjekur në vazhdimësi procesin për përgatitjen e PBA-ve nga ministrinë dhe institucionet qendrore, të cilat kanë të përfshira programe ose objektiva të ndjeshme nga ana gjinore (BPGJ). Në kuadër të integritimit gjinor në politika dhe programe si dhe në përgatitjen e PBA-së, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i është drejtuar institucioneve përgjegjëse, mbi adresimin e angazhimeve të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030 lidhur me rëndësinë e përfshirjes së aktiviteteve specifike dhe treguesve të Barazisë Gjinore në PBA 2023-2025, si një instrument kyç i zbatimit të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor. Konkretisht në PBA 2022-2024 mbështetja financiare në buxhet është në masën 9 % për çështje të barazisë gjinore. MSHMS ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse përfshirjen e aktiviteteve specifike dhe treguesve të barazisë gjinore në PBA 2023 - 2025 në të gjitha programet buxhetore të përmendura në SKBGJ 2023-2030.

2. Nga MF:

Lidhur me këtë rekomandim nga ana jonë është hartuar shkresa nr. 21405/1.prot, datë 8.05.2023 drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të cilës i kemi kërkuar bashkëpunim për të hartuar një plan të përbashkët trajnimi me fokus rritjen e kapaciteteve planifikuese, monitoruese dhe vlerësuese të IQ dhe vendore për buxhetimin gjinor. Nuk kemi marrë ende një përgjigje zyrtare lidhur me këtë rekomandim nga MSHMS.

Pavarësisht kësaj nga ana jonë janë zhvilluar në bashkëpunim me ASPËN trajnime për Planifikimin buxhetor afatmesëm gjatë vitit 2023, pjesë e të cilave ka qenë dhe fusha e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Ndërkohë gjatë vitit 2023, nga ana e Drejtorisë së Financave Vendore janë zhvilluar cikël trajnimesh mbi buxhetimin me bazë gjinore për NJVQV-të, si edhe gjatë vitit 2024, do të vijohet me zhvillimin e tyre, në drejtim të përfshirjes së treguesve me bazë gjinore në buxhetin vjetor dhe PBA.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson rekomandimin si **të pranuar dhe zbatuar pjesërisht**, pasi pavarësisht faktit që janë organizuar trajnime të shumta në fushën e bexhetimit të përgjigjshëm gjinor, në përgjigjet e tyre subjektet nuk kanë dërguar informacioni mbi dakordësimin e planeve vjetore të trajtimit, siç edhe kërkohet nga rekomandimi.

2 Ministria e Financave dhe Ekonomisë të hartojë plan veprimi me objektiva e aktivitete konkrete për integrimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

MF: Ky rekomandim nuk është pranuar nga ana jonë me argumentin që MSHMS është institucion lider i hartimit dhe monitorimit të strategjisë së barazisë gjinore dhe ka struktura të dedikuara për të hartuar plane veprimi për zbatimin e strategjisë. MFE me strukturat e saj në drejtorinë e përgjithshme të buxhetit ka kontribuar dhe vijon të kontribuojë në këtë proces, duke e përfshirë elementin e barazisë gjinore dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor si pjesë e procedurave të përgatitjes së PBA dhe monitorimit të saj në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton i **pa pranuar**. MFE ka kthyer përgjigje mbi këtë rekomandim edhe në planin e masave pas 20 ditësh.

3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të përfshijë në planet vjetore të auditimit të përputhshmërisë, monitorimin e buxhetimit të përgjithshëm gjinor në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

1. Nga MSHMS: Në zbatim të ligjit nr 36, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të udhëzimit të përbashkët nr.21, datë 21.06.2013 "Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm", të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera buxhetore qendrore, duhet të kryejnë analiza me bazë gjinore të sektorit përkatës, me qëllim përcaktimin e objektivave dhe treguesve të performancës me bazë gjinore, që ndihmojnë në kryerjen e analizave gjinore të sektorit përkatës dhe matjen e performancës së programit buxhetor.

Në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim dhe me MEF organizoi një Tryezë Konsultimit me temë “MBI HARTIMIN E TREGUESVE TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË BUXHETIN VJETOR 2024”, në 20 Nëntor 2023.

Në tryezë morën pjesë përfaqësues të drejtorive të buxhetit pranë Ministrive të Linjës dhe nëpunësit gjinorë pranë këtyre Ministrive.

2. Nga MFE: DH AB në Ministrinë e Financave, duke vlerësuar rekomandimin dhe brenda autoritetit dhe funksionit që kryen si harmonizuese dhe udhëheqje metodologjike për Njësitë e Auditimit të brendshëm në sektorin publik, gjatë vitit 2023 ka përfshirë në Programin e Trajnimit temat e “Auditimit të Performancës” me qëllim ngritjen e kapaciteteve për të audituar fusha specifike sikurse është dhe çështja e audituar. Njëkohësisht në bashkëpunim me SIGMA po përgatiten udhëzues specifike për këto lloj auditimesh. Gjithashtu në hartimin e Planeve Strategjike dhe Vjetore të Auditimit, nga ana e DH AB janë dhënë udhëzime rreth një planifikimi me efektiv të auditimit, ku janë përfshirë çështje sa më lartpërmendur. Megjithatë, realizimi i plotë i rekomandimit në formën e dhënë është jashtë kompetencave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Funksioni i auditimit të brendshëm në sektorin publik, në zbatim të ligjit nr 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, si dhe Standardet Ndërkombëtare të pranuar përcaktojnë se auditimi i brendshëm është i organizuar në mënyrë të decentralizuar, pra krijohet nga Titullari i njësisë publike në një nga format e përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji. Çdo njësi auditimi harton planin strategjik dhe vjetor në mënyrë të pavarur i cili pasi miratohet nga Titullari dërgohet në DH AB për konsolidim. Në këtë kuptim Ministria e Financave nuk ka autoritet të përcaktojë drejtimit e auditimit të NJAB-ve, por të ndjekë zbatimin e planeve dhe zhvillimin e këtij funksioni në nivel vendi. Rekomandimi është në ndjekje

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, në proces zbatimi.**

4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të përfshijë në udhëzimin vjetor të buxhetit raportimin mbi Buxhetim të Përgjigjshëm Gjinor gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të projektbuxhetit pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financën dhe Nënkomisionit për Barazinë Gjinore, për të përmirësuar performancën buxhetore të programeve buxhetore me tregues gjinor.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

MF: Ky rekomandim nuk është pranuar me argumentin që mbetet e paqartë lidhja e udhëzimit vjetor të përgatitjes së PBA për NJQQ e cila ka të përfshirë detyrimin për të programuar objektiva/treguese performance/produkte gjinore nga IQ me rolin që ka Komisioni për Ekonominë dhe Financën në procesin e shqyrtimit të projektbuxhetit vjetor.

Theksojmë që paketa e projektbuxhetit për vitin 2023 ka të përfshirë në relacionin shoqërues të projektbuxhetit një aneks për buxhetimin gjinor i cili jep informacion mbi fondet publike buxhetore të dedikuara për produkte/tregues gjinor në nivel qendror. Ky informacion është publik dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pa pranuar.** MFE ka kthyer përgjigje mbi këtë rekomandim edhe në planin e masave pas 20 ditësh.

2. A kanë qenë efektive politikat e nxitjes së punësimit të grave në vendin tonë?

Gjetje nga auditimi:

3. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nuk ka qenë plotësisht efektive në aktivitetin e saj për punësimin e grave sidomos të grave që ndjekin kurset e aftësimin profesional, duke mos realizuar objektivat e vendosur në shkallën 85 - 88%. Indeksi i barazisë gjinore për kurset e formimit profesional është 36 - 44% të pjesëmarrësve gra për periudhën 2017 - 2021 dhe rezultatet e punësimit të tyre është 39.7%. Gati 1/2 e të papunëve gra nuk janë regjistruar në zyrat e punës dhe se vetëm 1/3 e të papunëve ju drejtohen zyrove të punës për të kërkuar punë.

4. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

- Nuk ka integruar në politikat e saj, rregulloret udhëzimet dhe procedurat standarde të veprimtarisë instrumentet, mjetet dhe mekanizmat e realizimit të barazisë gjinore.
- Nuk ka integruar në planet e saj të veprimit, qëllimin dhe objektivat strategjike të SAP 2014-2021 për sa i përket barazisë gjinore, zërthimin e tyre në objektiva gjinore specifike, të matshëm, të arritshëm, realist dhe në një kohë të caktuar, në kartën e saj të performancës.
- Nuk ka integruar BPGJ në të gjitha fazat e ciklit buxhetor për vitet 2017 - 2021 në të dyja nivelet organizative të saj, që në planifikim në PBA në nivel qendror nuk ka parashikuar buxhete më qëllime, objektiva e tregues produkti me ndarje gjinore. Në nivelin dytësorë të administrimit nuk plotësohet formati standard i PBA-së me objektiva e produkte buxhetore, ashtu edhe ai i raporteve të monitorimit.
- Nuk ka kryer trajnime për integrimin e barazisë gjinore në politikat buxhetet si dhe zbatimin, monitorimin e vlerësimin e tyre.
- Janë kryer rishikime të shumta të buxhetit dhe treguesve në nivel qendror dhe rajonal, në shumicën e rasteve me pakësim fondesh, por nuk janë kryer analiza gjinore para rishikimeve buxhetore, gjithashtu ka patur një mos realizim të buxhetit ndërmjet 80.7% dhe 94.44%
- Nuk ka matur rezultatet e punësimit në tërësi të grave si synime përfundimtarë për tre programet e politikës aktive të punësimit.

5. Agjencia Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në vitin e fundit 2021 ka një rritje të kostove të produkteve buxhetore e cila është mbi mesataren e realizuar të pesë viteve të fundit, duke treguar një ulje të eficiencës organizative operacionale të saj. Përkatësisht programi *ndërmjetësim punësimi* rritje kostoje me 22 %, programi *pagesë papunësie* rritje kostoje me 10%, programet *nxitjes së punësimit* rritje kostoje me 28.4% dhe programi për *kurset e trajnimit formimi profesional* me një rritje kostoje 41%.

Rekomandime:

5. Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim të miratojë politika, udhëzime dhe procedura standarde të veprimtarisë së brendshme duke respektuar parimet e mjetet e barazisë gjinore, duke përfshirë Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor në të gjitha fazat e ciklit buxhetor në të gjitha nivelet organizative, të rishikojë treguesit kyç të performancës duke përfshire treguesit gjinore në to, të kryejë matjen e rezultateve të punësimit sipas produkteve buxhetore të politikës aktive të punësimit.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

AKPA: Miratuar VKM Nr. 401, datë 19.6.2024 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegritimit social”, ku pëfitues janë gratë që banojnë në njësitë administrative/vendore ku nuk ka struktura vendore punësimi, por edhe përfituesit e ndihmës ekonomike. Target grupi i synuar do të përfitojë shërbime të këshillimit të specializuar nisur nga kompleksiteti i vulnerabilitetit që paraqet dhe do të

mbulohet me shërbime dhe programe punësimi në zonat ku nuk ka struktura vendore punësimi. Programi i riintegritimit social i ofron përfituesve shërbimet mbështetëse si edhe një mbështetje financiare për pjesëmarrjen në program, të tilla si: Pagesë për pjesëmarrje, bonuse për shpenzime të transportit, për kujdesin e fëmijës në ngarkim dhe/ose të moshuarve ose personave të sëmurë në ngarkim. Efektet e pritshme të programit synojnë të jenë ofrimi i këshillimit të specializuar dhe dedikuar për punësim, vetëpunësim ose formim profesional të pjesëmarrësve të programit, në bazë të Planit Individual të Riinterimit dhe Punësimit. Gjithashtu, programi angazhohet gjithashtu në integrimin e qëndrueshëm të tyre në tregun e punës, jo vetëm nëpërmjet këtyre shërbimeve, por edhe nëpërmjet bonuseve të parashikuara për t'u ofruar në rast punësimi të pjesëmarrësit deri në një afat maksimal prej 6 (gjashtë) muajsh pa shkëputje pas përfundimit të programit.

- Gjithashtu, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (AKPA) ka hartuar dhe ka propozuar pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) një vendim të ri për "Përcaktimin e procedurave, kritereve dhe rregullave për zbatimin e programit të mbështetjes financiare për pjesëmarrjen në kurset e formimit profesional" të një kategorie të veçantë të punëkërkuësve të papunë. Target grupi i këtij programi janë punëkërkuësit e papunë në moshë pune, që janë të regjistruar si punëkërkuës të papunë në zyrën e punës të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike si dhe të rinjtë e moshës 15-29 vjeç. Pjesëmarrësit do të mbështeten me të ardhura për ndjekjen e kursit në nivelin e 50% të pagës minimale orare dhe do të përfitojnë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, sipas tarifave në fuqi, për personat që jetojnë 5-50 km larg nga vendi i zhvillimit të kursit të formimit profesional, për çdo ditë pjesëmarrje.

- AKPA disponon të dhëna për kursantët, të cilët kanë ndjekur kurset e formimit profesional sipas njësive bashkiake ku ata banojnë. Edhe pse Qendrat e Formimit Profesional janë të lokalizuara në qytetet kryesore, ato në bazë të kërkesave apo nevojave specifike, në disa raste kanë hapur kurse edhe në bashkitë më të vogla në bashkëpunim me Shkollat e Mesme Profesionale apo bizneset. Për rajonin verilindor, kurset e formimit profesional afrohen nga Qendra e Formimit Profesional Lëvizëse, e cila ofron kurse në disa njësi vendore të këtij rajoni.

- Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive me mbështetjen e Expertise France ka dizenuar dhe validuar një paketë gjithëpërfshirëse shërbimesh dhe programesh punësimi të përshtatura për gratë që banojnë në zonat rurale dhe zona të tjera që aktualisht nuk mbulohen plotësisht nga shërbimet publike të punësimit. Tre bashki u përfshinë në zbatimin pilot të kësaj pakete, të cilat janë Elbasani, Lushnja dhe Kamza.

Zhvillimi i kësaj pakete të validuar të shërbimeve të punësimit për gratë e papuna që jetojnë në zona rurale dhe zona të tjera që aktualisht nuk mbulohen nga shërbimet e punësimit, bazohet në një dokument koncept të mëparshëm të qarkulluar në Prill 2023, dhe më pas në seminarin e prezantimit dhe validimit të kësaj pakete shërbimesh punësimi të mbajtur në 8 qershor 2023, si dhe në një studim të mëparshëm analitik mbi rrethanat dhe nevojat e veçanta të grupit të synuar të cilat janë gratë që jetojnë në zona rurale dhe/ ose në zona të tjera që aktualisht nuk mbulohen nga Shërbimet Publike të Punësimit.

Dokumenti aktual pasqyron rezultatet e seminarit të prezantimit dhe vlerësimit, diskutimet e detajuara të zhvilluara me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) në nivel qendror dhe lokal, stafin e Shërbimit Social në tre Bashkitë pilot të propozuara, OJF, partnerë të ndryshëm, etj. Seminari siguroi gjithashtu që të gjithë aktorët e identifikuar dhe të përfshirë të kenë një kuptim të përbashkët dhe të qartë të objektivave dhe qëllimeve të paketës dhe të përfituesve të synuar.

Metodologjia e përdorur në hartimin e Paketës së Shërbimeve të Punësimit bazohet në hartimin e një modeli praktik operacional për zbatimin e një pakete të zgjeruar të Shërbimeve të Punësimit për grupin e synuar. Grupi i synuar, nga një këndvështrim operacional, mund të

përshkruhet si gra që banojnë në njësitë administrative të cilave u mungojnë strukturat vendore të Shërbimeve të Punësimit të AKPA ose ndodhen shumë larg çdo pike shërbimi ekzistuese të AKPA. Modeli operacional i propozuar për zbatimin e një pakete të zgjeruar të Shërbimeve të Punësimit për grupin e synuar do të arrihet duke shfrytëzuar instrumentin ekzistues të AKPA dhe duke zhvilluar tregues të performancës në lidhje me ofrimin e shërbimeve për grupin e synuar. Kjo iniciativë po pilotohet në kushtet kur midis 2019-2021, paketa e AKPA e Programeve Aktive të Tregut të Punës (PATP-ve) është përditësuar dhe janë bërë shtesa. Vlen të theksohet në këtë proces që modeli i udhëzimit dhe këshillimit të planifikimit me katër faza është prezantuar dhe integruar në sistemin e ri të shërbimeve të punësimit. Profilizimi ekonometrik është përfshirë gjithashtu në sistemin e menaxhimit të rasteve, për herë të parë në AKPA në Shqipëri. Këto karakteristika mundësojnë identifikimin e atyre punëkërkuessve që kanë më shumë nevojë për shërbime intensive punësimi dhe të atyre që janë më larg nga tregu i punës.

Janë organizuar trajnime të dedikuara për punonjësit e Zyrave të Punës për zyrat pilot ku po zbatohet projekti.

- Sqarojmë gjithashtu se Politikat Aktive të Tregut të Punës hartohen nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit. Këto programe/politika ndërtohen duke iu referuar nevojave dhe specifikave kombëtare të punëkërkuessve. Në këtë kontekst, sqarojmë se programet nuk kanë karakter lokal por ndërtohen në nivel kombëtar dhe synojnë t'i adresojnë nevojat me qasje gjithëpërfshirëse dhe sa më ezauruse.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i zbatuar.**

6. Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim të rrisë kapacitetet institucionale në të gjitha nivelet nëpërmjet trajnimit periodik të punonjëssve në lidhje me Barazinë Gjinore dhe mjetet për arritjen e saj.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

AKPA: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka organizuar trajnime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve për stafet e saj në të gjitha nivelet. Risia e viteve të fundit është ngritja e grupit të TOT (trajnerëve), të cilët shërbejnë për trajnimin e stafëve të reja por edhe gjithë risitë dhe proceset e punës. AKPA ka sfidë ofrimin cilësor të shërbimeve të punësimit, nëpërmjet të cilit edhe grupet vulnerabël apo gratë.

- Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive me mbështetjen e Expertise France ka dizenuar dhe validuar një paketë gjithëpërfshirëse shërbimesh dhe programesh punësimi të përshtatura për gratë që banojnë në zonat rurale dhe zona të tjera që aktualisht nuk mbulohen plotësisht nga shërbimet publike të punësimit. Tre bashki u përfshinë në zbatimin pilot të kësaj pakete, të cilat janë Elbasani, Lushnja dhe Kamza.

Në kuadër të trajnimeve periodike të punonjëssve të zyrave të punës, bazuar tek Paketa e Shërbimeve të Punësimit të ofruara nga AKPA, janë ofruar trajnime interaktive për specialistët këshillues të AKPA, duke përdorur një qëndrim pjesëmarrës dhe praktik, përmes një përzierje prezantimesh, diskutimesh të rasteve studimore, lojërave me role, sesioneve pyetje-përgjigje dhe diskutime plenare që përfshijnë të gjithë pjesëmarrësit dhe kontribuojnë në nxitjen e një mjedisi të favorshëm mësimi dhe për shkëmbimin e ideve dhe informacionit.

- AKPA ka përcaktuar edhe një 'Kampion Gjinor' pranë zyrave pilot dhe e ka vendosur këtë element si pjesë të Udhëzuesit të ofrimit të shërbimeve ndaj punëkërkuessve dhe punëkërkuessve të papunë.

- Megjithatë, me qëllim arritjen e kohezionit territorial të shërbimeve të punësimit,

është rishikuar dhe miratuar struktura e Drejtorive Rajonale të Punësimit, ku për herë të parë janë ngritur 2 zyra vendore punësi lëvizëse në Tiranë dhe Durrës, ku do të angazhohen specialistë në njësi dhe zona të pambuluara. Gjithashtu, në shumë njësi administrative ku nuk ka zyra pune, ka specialist të dedikuar. Përmendim: Rrogozhinën, Shijakun, Policanin, Vaun e Dejës, Patosin etj.

- Por, një risi shumë e madhe është edhe digjitalizimi i shërbimeve të punësimit, AKPA ka siguruar qasjen online të të gjitha shërbimeve kryesore të punësimit nëpërmjet portalit e-Albania. Në këtë kuadër, është realizuar përmirësimi i faqes zyrtare të AKPA, duke zgjeruar gamën e informacionit dhe të funksionaliteteve të tij dhe së fundmi, të portalit të punësimit puna.gov.al. Shërbimet online shërbejnë për një qasje më të lehtë të shërbimeve dhe në shumë raste në shmangien e nevojës për paraqitjen fizike në sportel.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i zbatuar.**

3. A kanë qenë efektive politikat e zhvillimit bujqësor rural në përfitim të gruas?

Gjetje nga auditimi:

6. Nga auditimi i efektivitetit të politikave të zhvillimit bujqësor rural në përfitim të gruas u konstatua se ka:

- mungesa të nëpunësit gjinor lokal në strukturat e AREB-ve dhe QTTB-ve;
- rritje të rasteve të mos raportimit të dhënave për ndjekjen dhe zbatimin e shpenzimeve të financimit për fuqizimin ekonomik të gruas, dhe mos zbatimit të detyrimeve ligjore sipas SKBGJ-së në përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit;
- MBZHR ka të caktuar një nëpunës gjinor¹, por mungon përshtetja e detyrave funksionale të tij në rregulloren e brendshme të funksionimit dhe organizimit të MBZHR-së duke sjellë mungesë të gjurmës së auditimit për procedurat kryesore dhe për rrjedhojë nuk ka statistika të sakta në lidhje me objektivat e SKBGJ-së;
- MBZHR për treguesin në SKBGJ për përmirësimin e legjislacionit mbi regjistrimin e pronësisë së tokës, në favor të grave, të rejave dhe vajzave, nuk ka realizuar aktivitete ndërgjegjësuese/këshilluese në zonat rurale dhe urbane si dhe nuk ka propozuar në nxjerrjen e akteve nënligjore, duke pranuar në “heshtje” moszbatimin e këtij treguesi të panevojshëm, i miratuar nga Këshilli i Ministrave duke mos iu referuar Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i cili e ka të sanksionuar në mënyrë shteruese.
- MBZHR nuk ka hartuar Planin e Veprimit për vitin 2022 për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave rural, ndonëse ka miratuar edhe SBZHR 2021-2027.

7. Shpenzimet për produktin Gjinor e përshkruar gjerësisht në Strategjitë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016 - 2020 dhe 2021 - 2030 nuk janë siguruar të plota ose janë në nivele të papërfillshme krahasuar midis buxhetit total të MBZHR-së me buxhetet e QTTB-ve, të AREB-ve dhe AZHBR-së, në lidhje sipas produkteve dhe aktiviteteve, fakt që bën të vështirë ose të pamundur arritjen e objektivave të përcaktuara në SKBGJ, kështu:

- nuk kanë ndjekur të njëjtën prirje të rritjes së tyre krahasuar me buxhetin e përgjithshëm të MBZHR-së ndër vite programi “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor” ndaj buxhetit të MBZHR-së, ku vihet re që për periudhën 2018-2022 pesha që zë programi është mbajtur në të njëjtin interval 4% deri në 5% .

- Mungojnë sistemet për matjen dhe raportimin mbi këshillimin e grave rurale pranë AREB dhe në MBZHR, mbi treguesin grave rurale përfituese nga shërbimet e ekstensionit, të ndarë saktësisht që sa prej tyre janë gra/vajza fermerë dhe sa prej tyre janë burra fermerë.

- Shpenzimet për produktin Gjinor në lidhje me AZHBR zënë një peshë të vogël në shpenzimet buxhetore që kryen programi, ku ndërkohë buxheti i përgjithshëm i MBZHR-së ndër vite ka ardhur duke u rritur ndjeshëm. Intervali i përqindjes që produkti Gjinor zë në

buxhetin e programit të Zhvillimi Rural të MBZHR-së varion nga 9% në 2019 në % në vitin 2021 me një rënie të konsiderueshme prej 5%;

- Buxheti i fondeve në AZHBR realizohet në total dhe jo me bazë gjinore, duke mos pasqyruar matjen dhe raportimin e treguesit mbi numrin e grave përfituese nga fondet e skemave kombëtare dhe të IPARD-BE, sipas strategjive të barazisë gjinore.

- nuk ka një analizë të hollësishme se sa gra rezultojnë të punësuar në sektorin bujqësor pas marrjes së fondeve, si i kanë zhvilluar këto fonde mjedisin rural si dhe mungojnë analizat krahasimore të rritjes ose jo të nivelit të përqindjes së punësimit të grave në zonat rurale nga Drejtoria e Monitorimit të Skemave, Riskut dhe Raportimit, (DMSRR) në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural;

- nuk janë marrë në konsideratë gjatë përgatitjes së fazave të PBA-ve, përmirësimi i treguesve gjinorë, bazuar në strategjinë e zhvillimit rural dhe atë të barazisë gjinore si nga MBZHR dhe edhe institucionet e varësisë në adresimin e prioriteteve gjinore dhe konkretisht në:

- përcaktimin e numrit të grave dhe burrave që punojnë në sektorin e zhvillimit rural,

- përcaktimin si tregues performance i numri të grave dhe burrave fermerë të regjistruar,

- përcaktimin si tregues performance, më vete, numri i grave dhe burrave fermerë që përfitojnë nga skemat mbështetëse kundrejt atyre që aplikojnë për çdo skemë mbështetëse,

- përcaktimin si tregues performance vlera e fondeve të skemave mbështetëse prej të cilave përfitojnë gratë fermerë ndaj totalit të vlerës për skemat kombëtare dhe I-PARD,

- përcaktimin e numrit të grave dhe burrave që marrin pjesë në aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agropërpunim,

- përcaktimin si tregues performance numri i grave dhe burrave që përfitojnë nga kreditë e agrobizneseve,

- përcaktimin si tregues performance të ndarë sipas gjinisë përfituesit e programit Mbështetje për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Zonave Rurale në Shqipëri - SDRRA (GRAND).

8. Nga MBZHR nuk ka një statistikë zyrtare mbi numrin e fermerëve progresivë deri më sot dhe rrjedhimisht nuk ekziston një shifër e saktë se sa nga këta janë burra dhe sa gra si dhe sa fermerë janë me status pasiv për periudhën në auditim. Grupi i auditimit këtë të dhënë e mori nga Web-i i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nga ku rezultoi se numri i fermerëve aktiv sot në Republikën e Shqipërisë, dhe konkretisht deri në datën 21.12.2022 është 84,344.⁶ Mungesa e këtyre të dhënave kaq të nevojshme në performancën dhe punën e MBZHR-së nuk japin një tablo të qartë mbi rezultatin dhe progresin në vite të punës së kryer lidhur me politikat në mbështetje të grave në zonat rurale si dhe në zbatim të objektivave të mire përcaktuara në dy SKBGJ.

Rekomandime:

7. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrë masa të menjëhershme në përditësimin e listës së fermerëve aktive duke e risfreskuar atë në bashkëpunime Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si institucioni përgjegjës që kryen regjistrimin dhe çregjistrimin e subjekteve - fermerë.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

MBZHR: Rekomandim i pranuar. Rregjistrimi i fermerëve me NIPT bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, detyrim ligjor. Të gjithë fermerët që aplikojnë në skemat e mbështetjes duhet të jenë të pajisur me NIPT. Fermerët aplikues tek skemat e mbështetjes direkte, janë të identifikueshëm sa femra e sa meshkuj, për efekt raportimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

⁶ Marrë nga faqja e web-it, www.tatime.gov.al, lista e fermerëve aktiv, datë 21.12.2022.

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i pa zbatuar**, pasi subjekti nuk ka paraqitur dokumentacioni mbi komunikimet me Drejtorinë e Përgjithshme të tatimeve sa i takon përditësimin të listës së fermerëve aktive.

Komentet e subjektit të auditimit pas dërgimit të projektraportit:

Me shkresën nr. 595/1, prot., datë 03.10.2024, protokolluar me tonën nr. 914/20, prot., datë 07.10.2024, MBZHR ka vendosur komunikimin e kërkuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve sa i takon listës së fermerëve aktiv dhe ndarjes së tyre në femra - meshkuj, duke specifikuar se komunikimi do të kryet katër herë në vit nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër rekomandimi rezulton **i pranuar, i zbatuar**.

8. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të identifikojë në strukturat organike aktuale të Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor dhe Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, një nëpunës gjinor lokal të ngarkuar me ndjekjen e produkteve buxhetore gjinore si dhe hartimin dhe miratimin e Planin të Veprimit për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave rurale në kohë.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

MBZHR: rekomandim i pranuar. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Urdhrin e Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 185, datë 29.03.2023, me Nr prot. 1891/1, datë 29.03.2023 ka miratuar Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Në rregulloren e miratuar, në Nenin 37, janë përcaktuar detyrat e Nëpunësit gjinor të Ministrisë (pika fokale për barazinë gjinore). Bashkëlidhur Rregullorja e sipërcituar. Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor dhe Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, sipas udhëzimeve të përcjella nga ky Raport auditimi, kanë caktuar me Urdhra të brendshëm një nga punonjësit e tyre që krahas detyrave të tjera funksionale të jenë të ngarkuar dhe me çështjen Gender. Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor raportojnë çdo muaj në Sektorin e Shërbimit Këshillimor treguesin e ndarë në bazë gjinie (burra/gra) “Fermerë të asistuar dhe informuar nga Strukturat e Ekstensionit”. Bashkëlidhur, Urdhërat nr. 2628, datë 30.05.2023, nr. 132/2, datë 22.05.2023, nr. 71, datë 08.05.2023, nr.1910, datë 04.05.2023, nr. 104/1, datë 06.06.2023, nr. 487, datë 21.06.2023, nr. 1588, datë 21.09.2023, nr. 23, datë 18.05.2023 si dhe një model raportimi mujor nga AREB-et dhe monitorimi përmbledhës çdo muaj nga Sektori i Shërbimit Këshillimor për vitin 2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i zbatuar**.

9. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ekipet përkatëse të menaxhimit të programimeve buxhetore të ngritura për përgatitjen e projekt buxheteve të marrin masa në rritjen e planifikimit në PBA-të respektive në lidhje me produktin gjinor, me qëllim rritjen e numrit të grave përfituese rurale nga shërbimet e ekstensionit, nga skemat kombëtare dhe IPARD.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

MBZHR: Rekomandimi është i Pranuar. Do të vijojë, konsiderohet në hartimin e PBA -së 2025-2027. Në PBA 2024-2026 është konsideruar rritja e buxhetit për trajnimin e grave

fermere në Programin Buxhetor 04860 “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor” nga 1.75 milion lekë në vitin 2023 në 2.3 milion lekë në vitin 2024. Rritja është me 31% për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023. Dokumenti PBA 2024-2026.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, në proces zbatimi.**

10. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me institucionet e varësisë, Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural dhe Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor të marrë masa që në fazën e planifikimit të PBA-ve për të përcaktuar prioritetet gjinore me tregues të performancës numrin e grave të informuara që përfitojnë nga skemat mbështetëse dhe të huaja, si dhe numrin e grave/vajzave dhe burrave përfitues nga shërbimi i ekstensionit bujqësor. rekomandime këto dhe nga UN Woman.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

MBZHR: rekomandim i pranuar. Në bashkëpunim dhe me UN Woman janë identifikuar dhe shtuar disa tregues performance si më poshtë, por që marrja e të dhënave të tyre do të jetë viti 2024:

- Numri i grave dhe burrave fermerë të regjistruar, (në regjistrin e fermës nga viti 2024);
- Numri i grave dhe burrave fermerë që përfitojnë nga skemat mbështetëse kundrejt atyre që aplikojnë për çdo skemë mbështetëse (të dhëna marrë dhe dërguar në MF edhe për vitin 2023);
- Vlera e fondeve të skemave mbështetëse prej të cilave përfitojnë gratë fermerë ndaj totalit të vlerës për skemat kombëtare dhe IPARD (duke filluar nga 2024);

Numri i grave dhe burrave që marrin pjesë në aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agro përpunim, (duke filluar nga 2024).

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i zbatuar.**

4. A ka qenë efektive veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore?

Gjetje nga auditimi:

9. Në përbërjen dhe reformatimet e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore nuk është respektuar, parimi i përfaqësimit të barabartë sipas përkatësisë gjinore duke patur për periudhën objekt auditimi mbi përfaqësim të grave në masën 70%. Nuk janë respektuar gjithashtu edhe afatet kohore të parashikuara me ndryshimin e pozicioneve të punës së anëtarëve të tij.

10. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore nuk ka zhvilluar mbledhjet rregullisht, qoftë si organ këshillimor apo dhe si faktor në fuqizimin ekonomik të gruas në vendin tonë në kushtet normale apo të situatave të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.

- Sekretariati Teknik i KKBGJ nuk ka funksionuar me strukturë të plotë dhe nuk ka të dokumentuar proces-verbalet dhe vendimmarrjet në to.

- Organizimi i punës së Sektorit të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në rolin e Sekretariatit të KKBGJ, nuk përfshihet në Urdhrin e ministrit të MSHMS, Nr. 178, datë 22.02.202, "Për miratimin e Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", për më tepër që në këto vite janë kryer reforma institucionale dhe ka ndryshuar struktura organizative e MSHMS.

11. Në referencën ligjore të Urdhrit të Kryeministrit, nr. 32, datë 12.2.2018 “Për caktimin e Koordinatorit Kombëtar për Barazinë Gjinore”, nuk përfshihet ligji për barazinë gjinore, si një ligj specifik për fushën dhe KKBGJ nuk ka patur korrespondencë me Koordinatorin Kombëtar për Barazinë Gjinore.

- Nuk ka patur lidhje të ndërsjella midis GMIP-ve, Nën komisionin parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj grave, KDS, etj., me synim fuqizimin ekonomik të grave dhe përmirësimin e barazisë gjinore.

- KKBGJ nuk ka bërë ndonjëherë performancën e punës së vet, konkretisht, në aspektin si organ këshillimor, apo dhe si faktor në fuqizimin ekonomik të gruas në vendin tonë gjë e cila do t’i shërbente për të rritur efektivitetin e punës së vet.

Rekomandime:

11. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të riformatojë menjëherë Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore lidhur me përbërjen e anëtarëve të tij, duke realizuar përfaqësimin e barabartë sipas përkatësisë gjinore.

Menjëherë

Komentet e Subjektit të auditimit:

MSHMS Rekomandimi është realizuar pas ndryshimeve të disa prej zëvendësministrave, që janë anëtarë të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore (KKBGJ).

Për sa më sipër sqarojmë se: Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore funksionon në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Këshilli kryesohet nga Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) përfaqësues të përcaktuar nga Qeveria, në nivel zëvendësministri dhe 3 përfaqësues nga shoqëria civile. Përfaqësuesit nga shoqëria civile në këtë këshill janë: 1 burrë dhe 2 gra.

Përfaqësuesit e caktuar nga Qeveria janë në nivel zëvendësministrash sipas fushës së tyre të përgjegjësisë. Emërimi i zëvendësministrave është kompetencë e Kryeministrit.

Në ndryshimet që i janë bërë përbërjes së Qeverisë, tani përfaqësimi gjinor në KKBGJ është sipas detyrimeve të përcaktuara nga Ligji 9970 ‘Për barazinë Gjinore në shoqëri’

Bashkëlidhur lista e anëtarëve në 2 mbledhjet e fundit të KKBGJ.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i zbatuar.**

12. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore t’i drejtohet Zëvendës Kryeministrit, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar për Barazinë Gjinore, me qëllim dakordësimin e një Memorandumi Bashkëpunimi për të fuqizuar mekanizmat e barazisë gjinore në nivel qendror dhe vendor.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

MSHMS: Rekomandimi është realizuar për sa i takon fuqizimit të kapaciteteve të nëpunësve gjinorë në nivel qendror dhe vendor. Gjithashtu subjekti i këtij rekomandimi është pjesë edhe e ndryshimeve që po i bëhen Ligjit nr. 9770 Për barazinë gjinore në shoqëri , për të cilën po punon Grupi i Punës i ngritur me Urdhër të Ministres së MSHMS. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të fuqizimit të kapaciteteve ka realizuar aktivitetet si më poshtë vijon:

1. Organizimi i trajnimit dy ditor me rrjetin e koordinatorëve vendorë për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet në datat 1-2 Nëntor 2023. Ky trajnim u organizua në vijimësi të punës së vazhdueshme për fuqizimin e rrjetit dhe kishte për qëllim të ofrojë një platformë e cila i shërben rritjes së kapaciteteve të Koordinatorëve / Koordinatorëve për menaxhimin sa më efektiv të të mbijetuarave / mbijetuarve të formave të

ndryshme të dhunës, të promovojë bashkëpunimin mes Koordinatorëve / Koordinatorëve, si dhe të inkurajojë ndarjen e praktikave të mira dhe sfidave të hasura gjatë punës.

2. Në datën 15 Prill 2024, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale organizoi trajnimin me temë “Roli i Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje në parandalimin dhe luftimin e dhunës dixhitale”. Në këtë trajnim morën pjesë koordinatorë vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, nga bashki të ndryshme të vendit.

3. Në datën 29 Prill 2024, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale organizoi Ëorkshop-in me temë: “Ndarja e Përvojave në Mbështetje të Mbijetuarave/Mbijetuarve të Dhunës Seksuale në Shqipëri”. Në aktivitet ishin pjesëmarrës përfaqësues të tre qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale, si dhe mekanizmat përkatës të referimit, duke ofruar një mundësi për të prezantuar dy modelet e shërbimit, si dhe për të ndarë praktikën më të mira dhe sfidat e hasura në adresimin e nevojave të mbijetuarave/mbijetuarve.

4. Në datën 1-2 Korrik 2024, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zhvilloi takimin 2 ditor, me rrjetin e koordinatorëve vendorë për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, me synim forcimin e kapaciteteve të Koordinatorëve Vendorë të Dhunës në Familje në trajtimin e rasteve viktime të dhunës, si dhe të lehtësojë shkëmbimin e eksperiencave, ndarjen e praktikave të mira dhe sfidave të hasura duke promovuar një qasje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse në mbështetjen e viktimave dhe në parandalimin e dhunës.

5. Në datën 9 Korrik 2024, në zbatim të planit të punës për fuqizimin e kapaciteteve të rrjetit të Nëpunësve të Barazisë Gjinore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zhvilloi trajnimin e nëpunësve gjinor të ministrive, mbi të drejtat pronësore dhe profesionale të vajzave dhe grave.

6. Në kuadër të procesit të ndryshimit të Ligjit Nr. 9870/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, është ngritur grupi i punës sipas Urdhrit të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 39, datë 24.01.2024, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit Teknik ndërinstitucional të punës për hartimin e ndryshimeve në ligjin Nr. 9870/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Nga nenet kryesore që janë parashikuar të ndryshojnë është edhe neni që lidhet me mekanizmin e barazisë gjinore.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, në proces zbatimi.**

5. A ka qenë efektive veprimtaria e pikave fokale gjinore në rang vendi dhe e sektorit të barazisë gjinore në MSHMS?

Gjetje nga auditimi:

12. Treguesi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore lidhur me numrin e Nëpunësve Gjinorë në nivel qendror, me kohë të plotë, dedikuar tërësisht zbatimit të legjislacionit për barazinë gjinore, i rritur me 100%, nuk është realizuar plotësisht, pasi jo të gjithë institucionet qendrore kanë emëruar nëpunës gjinorë dhe jo në të gjitha këto institucione janë përfshirë përshkrimet e punës në rregulloret e institucioneve.

Në nivel vendor janë caktuar punonjësit përgjegjës për barazinë gjinore në 61 bashkitë e vendit, por këto në shumicën e rasteve këto janë koordinatorët vendor kundër dhunës në familje, punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, specialistët për ndihmën ekonomike dhe pagesat për aftësinë e kufizuar etj., duke krijuar mbivendosje detyrash dhe mbingarkesë në punë.

13. Fuqizimi i sektorit të barazisë gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ⁷ sikundër edhe evidentohet në Raportin e Vlerësimit të SKBGJ – së 2016 – 2020, nuk është realizuar sipas pritshmërive, pasi gjatë periudhës 2016 – 2022 ka pasur pozicione të lira punë; jo të gjithë specialistet/specialistët kanë në përshkrimin e tyre të punës detyra dhe përgjegjësi që fokusohen tek çështjet e barazisë gjinore dhe të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje; në përfundim të këtij auditimi vendi i specialistit për barazinë gjinore është sërish vakant.

Rekomandime:

13. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të plotësojë pozicionet e lira të punës të krijuara në sektorin e barazisë gjinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të vijojë puna e tij në mbështetje të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore në përmbushje të objektivave të strategjive për barazinë gjinore.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

MSHMS: Rekomandimi është realizuar plotësisht. Pozicionet e lira në Sektorin e Politikave të Barazisë Gjinore, në Drejtorinë e Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, janë plotësuar.

1. Në datë 6 Prill 2023, është realizuar konkursi nga Departamenti i Administratës Publike, për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Politikave të Barazisë Gjinore, në Drejtorinë e Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/4062>

2. Për sa i përket dy pozicioneve të lira për Specialist në Sektorin e Politikave të Barazisë Gjinore, në Drejtorinë e Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale, në datën 1 Korrik 2024, është realizuar konkursi nga Departamenti i Administratës Publike.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/4815>

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, i zbatuar.**

14. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë dhe miratojë udhëzime dhe qarkore drejtuar të gjitha institucioneve për të mundësuar konsolidimin e figurës së nëpunësit gjinor nëpërmjet shmangies së mbivendosjes së detyrave funksionale dhe përcaktimit në rregulloret e brendshme të përshkrimeve të punës për këta punonjës.

Brenda vitit 2023

Komentet e Subjektit të auditimit:

MSHMS Rekomandimi është realizuar pjesërisht. Në kuadër të procesit të ndryshimit të Ligjit Nr. 9870/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, do të vlerësohet gjendja konkrete e barazisë gjinore në vend dhe do të përcaktohet hartimi i udhëzimeve të lidhura, me strukturat e barazisë gjinore duke adresuar çështjen e mbivendosjes së detyrave funksionale dhe përcaktimit në rregulloret e brendshme të përshkrimeve të punës për këta punonjës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pranuar, në proces zbatimi.**

⁷ “Në fund të vitit 2020, Sektori i Barazisë Gjinore në ish MMSR i fuqizuar (me strukturë të konsoliduar dhe efçente), në përputhje me rolin e tij koordinues dhe monitorues.”

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresat nr. 588/17, 18, 19, 20, 21, prot., datë 05.04.2023, konstatohet se pjesa se:

- 7 rekomandime janë zbatuar plotësisht,
- 1 rekomandim zbatuar pjesërisht;
- 4 rekomandime janë në proces zbatimi;

Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **ri-kërkojmë** zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. A ka qenë efektiv zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor?

Gjetje nga auditimi:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë qenë pjesërisht efektive në realizimin e objektivave mbi numrin e programeve që do të integronin buxhetimin gjinor, vetëm 31% e tyre nga 70% që ishte objektivi janë përfshirë BPGJ në PBA. Si dhe nuk është implementuar BPGJ për NJVQV.

2. Planifikimi i BPGJ në programet ekzistuese nga ML nuk ka tregues më ndarje gjinore edhe monitorimi e gjurmueshmëria e shpenzimeve buxhetore dhe vlerësimi e matja e ndikimeve të tyre nuk janë realizuar. Sistemet elektronike të menaxhimit dhe monitorimit të buxhetit nga MFE nuk kanë kodifikim për treguesit e produkteve me ndarje gjinore.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim të dakordësojnë plane vjetore trajnimesh, në fuqizimin e kapaciteteve planifikuese, monitoruese dhe vlerësuese të institucioneve qendrore e vendore për programet buxhetore në përgjithësi dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

Brenda muajit Mars 2025

Të tjera

Për të gjitha masat e dhëna të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar me statusin ***në proces zbatimi***, duke vlerësuar proceset e ndërmarra nga subjektet e audituara dhe afatet e nevojshme për implementimin e plotë të tyre, kërkohet përmbushja e plotë e tyre **brenda tremujorit të parë të vitit 2025**.

4. PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “SHËRBIMI PËRMBARIMOR SHTETËROR NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE”.

I. Përmbledhje EKZEKUTIVE

I. 1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 914 prot., datë 08.07.2024 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, ushtroi auditim në 1 subjekt auditimi dhe institucionet e tij të varësisë pjesë e Auditimit të Performancës me temë “Shërbimi përmbartimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”, përkatësisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit Shtetëror.

Auditimi i kryer në vitin 2023, kishte si periudhë auditimi nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2022 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me Vendimin nr. 119, datë 19.07.2023 të Kryetarit të KLSH-së si dhe i janë përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit Shtetëror me shkresën nr. 1182/5 prot., datë 20.07.2023 duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

1. Hartimi i programit (Plani Veprimi) me personat përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;
2. Realizimi i programit (Plan Veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.;
3. Statusi i rekomandimeve të lëna, (sa rekomandime janë pranuar nga këto e sa janë zbatuar plotësisht, pjesërisht, në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar).

Në subjektin objekt auditimi u mbajt Akt – Verifikimi përkatës, i cili është regjistruar përkatësisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit Shtetëror me nr. 1299, prot, datë 02.08.2024.

I. 2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh

Në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit Shtetëror ka dërguar me shkresën nr. 1182/6, prot., datë 25.04.2024, planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH – së, në tejkallim të afatit ligjor prej 20 ditësh.

I. 3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh

Për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se:

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit Shtetëror nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

I. 4. Statusi i pranimit të rekomandimeve

Sipas shkresave përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 1182/5 prot., datë 20.07.2023 janë rekomanduar gjithsej:

Masa organizative 11 rekomandime.

Sa i takon statusit të pranimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi, si dhe në mungesë të informimit dhe raportimit në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	11	11	0

II. Hyrja

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në vitin 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve” miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 13.06.2021.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 914 prot., datë 08.07.2024 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2023” për Auditimin e Performancës me temë “Shërbimi përmbartimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”.

Konkluzionet përkatëse janë miratuar me Vendimin nr. 119, datë 19.07.2023 të Kryetarit të KLSH-së dhe janë përcjellë në subjektin e audituar me shkresën nr. 1182/5 prot., datë 20.07.2023.

Auditimi u kryenga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. V.K, përgjegjës grupi
2. A.Ç, anëtar.

Auditimi ka filluar më, 15.07.2024

Auditimi ka përfunduar më, 16.08.2024

II. 1. Objekti i auditimit

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit Shtetëror me shkresën nr. 1182/5 prot., datë 20.07.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II. 2. Qëllimi i auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II. 3. Metodologjia e auditimit

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

II. 4. Konkluzioni

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e auditimit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 1182/5 prot., datë 20.07.2023, rezulton se 11 (njëmbëdhjetë) masat e rekomanduara janë pranuar nga subjekti i audituar. Nga këto masa:

- është zbatuar 1 rekomandim ose 10 % e tyre,
- janë zbatuar pjesërisht 3 rekomandime ose 27 % e tyre
- gjenden në proces zbatimi 4 rekomandime ose 36 % e tyre;
- nuk janë zbatuar 3 rekomandime ose 27 % e tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa organizative	11	1	3	4	3

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	11	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	11	100%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	1	10%
2	Zbatuar pjesërisht	3	27%
3	Në proces zbatimi	4	36%
4	Pa zbatuar	3	27%

II. 5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve është relativisht i ulët, për disa nga masat organizative, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit Shtetëror nuk ka mundur të realizojë tërësisht ato. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjekti i audituar për përmbushjen e rekomandimeve të lëna.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. A kanë nxitur dhe siguruar politikat e hartuara mirë funksionimin e sistemit të përmbartimit shtetëror?

1.1 Për pyetjen audituese: A është hartuar kuadri rregullator i nevojshëm me qëllim ofrimin e një shërbimi përmbartimor në përputhje me misionin institucional të DPP?

1. Gjetje nga auditimi:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit nuk ka një Strategji Institucionale ku përcaktohen objektivat dhe prioritetet e veprimtarisë së saj. DPP ka përcaktuar disa objektiva në Analizat Vjetore Institucionale. Objektivat e shërbimit përmbartimor shtetëror duhet të jenë të

përcaktuara në një dokument strategjik dhe jo pjesë integrale e analizës vjetore institucionale. (Trajtuar më hollësisht në fq. 14-20 të Raportit Përfundimtar)

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit të marrë masa për hartimin e Strategjisë Institucionale, e cila përcakton objektiva konkret për efektivitetin e shërbimit përmbartimor shtetëror, në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Brenda Qershorit të Vitit 2024

Përgjigja e Subjektit:

Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor në fillim të çdo viti kalendarik harton Planin e veprimit të shërbimit, duke përcaktuar në të objektivat, identifikimin e problematikave, masat që do merren, sektorët përkatës që do të kryejnë dhe monitrojnë hap pas hapi.

Ndërkohë sa i përket Strategjive të Institucionit, më lejoni tju sqaroj se Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor është pjesë e Grupit të Punës dhe jep kontributin e vetë në:

Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021- 2025

Strategjisë së Re të Drejtësisë 2024- 2030

Strategjistë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së viktimave të Krimit 2024-2030

Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të mitur 2022-2026

Gjithashtu DPP është pjesë dhe jep kontributin e saj në Grupin Ndërinstitucional të Punës Për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, Shtetin e së Drejtës dhe Kriterin Politik e për rrjedhojë objektivat e vendosura nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror i shërbjnë Reformës në Drejtësi.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet i pranuar, i pazbatuar. Mungesa e përpilimit të një strategjie nga ana e DPP-së mund të cenojë në efektivitetin e përmbushjes së këtij misioni. Objektivat e shërbimit përmbartimor shtetëror duhet të jenë të përcaktuara në një dokument strategjik të hartuar nga DPP dhe më pas të hartohen planet e veprimit vjetore që përmbajnë masa konkrete për zbatimin e tyre. Natyra e planeve vjetore, për vetë faktin se ato hartohen çdo vit kalendarik, i bën ato të kenë një karakter dinamik, ndërsa strategjia i parashikon objektivat në afatgjatë, e për rrjedhojë garanton më tepër efektivitetin e përmbushjes së misionit institucional.

Komentet e subjektit të auditimit pas dërgimit të projektraportit:

Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor në fillim të çdo viti kalendarik harton Programin e Punës për shërbimin, në përputhje të plotë me politikën e programit të shërbimit, Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, si dhe dokumenteve të tjerë strategjik, pjesë e të cilës është edhe Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor shtetëror, apo e thenë ndryshe ekzekutimi i detyrueshem i vendimeve gjyqësore, duke përcaktuar qëllim, objektiva të qartë, si dhe masa konkrete për realizimin e tyre.

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit, në cilësinë e institucionit qendror të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, dhe që varet administrativisht nga Ministri i Drejtësisë, ka qënë dhe është pjesë e grupit të punës së ngritur me urdhër të Ministrit të Drejtësisë për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, që sigurisht ka ofruar dhe ofron kontributin e saj sa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Vendimarrja mbi përcaktimin e qëllimit dhe objektivave strategjike të përmbartimit shtetëror ka qënë dhe mbetet vendimarrje e institucionit epror administrativ, Ministria e Drejtësisë. Shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror nuk mund të ketë një strategji më vetë institucionale nga ajo

ndërsektoriale e drejtësisë, pasi organi që përcakton strategjinë për shërbimin përmbartimor, shtetëror dhe atë privat është Ministria e Drejtësisë. Për sa më sipër si dhe në zbatim të dispozitave të ligjit organik të përmbartimit shtetëror theksojmë se ky rekomandim është i zbatuar për sa i përket institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme, ndërsa sa i përket vlerësimit të kontributit strategjik të shërbimit të dhënë nga Drejtoria dhe përfshirja ose jo e tij në draftin final të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë, është dhe mbetet në diskrecion të organit epror, Ministria e Drejtësisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër rekomandimi rezulton **i pranuar, pjesërisht i zbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi:

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përkatësisht neni 25 krijon një vakum ligjor sa i përket mbulimit të shpenzimeve të ekspertëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve për personat në pamjaftueshmëri financiare, të cilët përfitojnë nga ndihma juridike dytësore falas. Tarifa e psikologut apo çdo eksperti tjetër gjatë fazës së ekzekutimit nuk përfshihet në skemën e ndihmës juridike dytësore falas, duke sjellë kështu vështirësi për përmbartuesit gjyqësor shtetëror gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutiv. (Trajtuar më hollësisht në fq. 14-20 të Raportit Përfundimtar)

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit të përcjellë në Ministrinë e Drejtësisë problematikat e konstatuara gjatë ekzekutimit të “titujve ekzekutiv” për personat në pamjaftueshmëri financiare të cilët mbulohen nga skema e ndihmës juridike falas, sa i përket mbulimit të shpenzimeve të ekspertëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve.

Menjëherë

Përgjigja e Subjektit:

Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka si qëllimin kryesor të veprimtarisë së tij ekzekutimin e titujve ekzekutiv, konform dispozitave ligjor të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil, ligjin organik etj. Gjatë fazës së ekzekutimit vullnetar dhe të detyrueshëm të titujve ekzekutiv, përmbartuesit gjyqësor hasen me pengesa të tilla në ekzekutim, ku palët në pamjaftueshmëri ekonomike kërkojnë të përjashtohen nga parapagimi i tarifave gjatë fazës së ekzekutimit. Nga ana e përmbartuesve gjyqësor apo edhe e Drejtorisë së Përmbartimit, i'u është bërë gjithmonë me dije kërkesve se përmbartuesit gjyqësor nuk mund të kryejnë veprime gjyqësore tej asaj çka urdhëruar gjakata për dhënien e ndihmës juridike falas, apo çka parashikojnë dispozitat e ligjit përkatës.

Gjithashtu nëpërmjet analizave të kryera dhe të përcjella në Ministrinë e Drejtësisë, DPP e ka bërë gjithmonë prezent faktin se një nga shkaqet kryesore të mosekzekutimit, apo të zvarritjes në ekzekutim të titujve ekzekutiv, është paaftësia paguese e palëve, mbetet në diskrecion të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave për të bërë ndryshime në ligjin e taksave kombëtare.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet i pranuar, i pazbatuar. Kjo për arsye se, në analizat e përcjella Ministrisë së Drejtësisë dhe të vëna në dispozicion grupit të auditimit, nuk evidentohet qartësisht ky fakt. Për shkak të rëndësisë dhe ndjeshmërisë që paraqet kjo problematikë, kërkoht një vëmendje e shtuar në trajtimin e saj me qëllim përmirësimin e situatës.

Komentet e subjektit të auditimit pas dërgimit të projektraportit:

Për sa më sipër sqarojmë se në Ligjin 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në nenet 25;26;27;28 të tij janë të përcaktuar përfituesit e marrjes së ndimës juridike dytësore falas, të drejtën e përjashtimit të tyre nga tarifat, mënyra e hartimit dhe përgatitjes së kërkesës si dhe kush është organi kompetent, i cili urdhëron përjashtimin e tyre nga tarifat e përgjithshme dhe të veçanta, shpenzime gjyqësore si dhe parapagimi i tarifës së vënies në ekzekutim.

Në nenin 25 të ligjit parashikohet:

Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të këtij ligji, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga:

- a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;
- b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;
- c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

Në nenin 26 përshkruhet mënyra e hartimit të kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore si vijon:

Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore

1. Përjashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore jepet në bazë të një kërkesë që hartohet sipas formularit të kërkesës së miratuar nga Ministri i Drejtësisë.
2. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet: a) së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore; b) bashkëlidhur kërkesëpadsisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural; c) në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor.
3. Në kërkesën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të kërkohet përjashtimi nga pagimi i një, disa ose të gjitha tarifave gjyqësore dhe/ose i shpenzimeve gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 25 të këtij ligji.
4. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet nga personi, i cili gëzon të drejtën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, nga një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose i afërm i shkallës së parë.
5. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet shërbimit postar.

Në nenin 28 të këtij ligji parashikohet procedura e shqyrtimit të kërkesës:

Procedura e shqyrtimit të kërkesës

1. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel.
2. Gjykata shqyrton kërkesën në përputhje me parashikimet në legjislacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me parashikimet e nenit 22 të këtij ligji.
3. Gjykata, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe parashikimet në legjislacionin procedural, pas shqyrtimit të kërkesës vendos:
 - a) pranimin e kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore;
 - b) rrëzimin e kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit, sipas parashikimeve të nenit 22 të këtij ligji.
4. Vendimi i pranimin të kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore i njoftohet menjëherë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Në nenin 28 të këtij ligji parashikohet se “ Vendimi gjyqësor për përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural”.

Për sa më sipër, në momentin që paraqitet një vendim i tillë pranë Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, vendimi gjyqësor ekzekutohet sipas përcaktimeve të gjykatave. Në vijim nga ana e DPP në të gjitha ankesat e trajtuara të përcjella në institucionin tonë nga Ministria e Drejtësisë, i'u janë bërë gjithmonë me dije Ministrisë dhe ankuesve shkaqet e mosekzekutimit apo të mosvijimit të procedurave.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Komentet e dërguara nga ana e subjektit të audituar pas dërgimit të projektraportit nuk merren në konsideratë nga ana e grupit të auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë.

Për sa më sipër rekomandimi rezulton **i pranuar, i pazbatuar.**

3. Gjetje nga auditimi:

Rregullorja e Brendshme e Shërbimit të Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror nr. 650, datë 17.10.2004 nuk është në përputhje me strukturën dhe organikën institucionale dhe Ligjin nr. 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”. Kjo rregullore e ka humbur koherencën dhe aktualitetin dhe është e pazbatueshme. (Trajtuar më hollësisht në fq. 14-20 të Raportit Përfundimtar)

4. Gjetje nga auditimi:

Rregullorja nr. 1551, datë 07.09.2006 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror” nuk reflekton ndryshimet ligjore të nevojshme, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 dhe Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2006. Ministria e Drejtësisë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim me qëllim miratimin e këtij akti, pavarësisht se kanë kaluar dy vjet nga periudha që DPP ia ka përcjellë. (Trajtuar më hollësisht në fq. 14-20 të Raportit Përfundimtar)

5. Gjetje nga auditimi:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimor nuk ka hartuar një rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror, pavarësisht parashikimit të hartimit të saj në planet e punës për vitet 2020-2022. (Trajtuar më hollësisht në fq. 14-20 të Raportit Përfundimtar)

3.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimor të marrë masa: për rishikimin e Rregullores së Brendshme të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror. për rishikimin e Rregullores nr. 1551, datë 07.09.2006 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror”. për hartimin e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror.

Në vijimësi

Përgjigja e Subjektit:

Në vijim të gjetjeve dhe rekomandimeve të lartpërmendura ju sqarojmë si vijon:

Nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimor është përmbushur detyrimi për azhurnimin e ligjit për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, pasi në Shkurt të vitit 2022 është miratuar Ligji i Ri 8/2023, ligj i cili fuqizon dhe i jep integritet këtij shërbimi, sidomos përmbartuesve gjyqësore e për rrjedhojë garanton rritje të cilësisë së tij,

garanton një proces emërimi dhe promovimi të përmbaruesve gjyqësor, të bazuar në kritere transparente, objektive, meritokracie, trajtim financiar si dhe rikoncepton sistemin e trajnimit fillestar dhe vazhdues të përmbaruesve gjyqësor.

Sa i përket paketës së akteve nënligjore rezultojn si më poshtë:

Me Urdhërin nr.157 Prot., datë 07.02.2023 të Ministrit të Drejtësisë është ngritur Grupi i Punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr.8/2023 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror” dhe duke bashkërenduar punën janë miratuar aktet nënligjore si më poshtë:

- Urdhër nr.6 datë 30.06.2023 "Për caktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e komandimit të përmbaruesit gjyqësor".

- Urdhër nr.432 datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit të shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror”.

- Urdhër nr. 433, datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përbajtjen e programit të trajnimit, pjesmarrjen në trajnime, si dhe testimin e njohurive të përfituara për përmbaruesit gjyqësor shtetëror në periudhë prove”.

- Urdhër nr.434 datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave me të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar për përmbaruesin gjyqësor shtetëror”

-Urdhër nr.447, datë 10.07.2023 “Për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të përmbaruesve gjyqësorë të shërbimit të përmbarimit gjyqësor shtetëror”.

- Urdhër nr. 475 datë 20.07.2023 “Për miratimin e formës së dokumentit të identifikimit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror”

- Urdhër nr. 167, datë 25.03.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Përmbarimit”

- Udhëzimi nr. 1, datë 25.03.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të përmbaruesit gjyqësor shtetëror”

- Udhëzimi i Përbashkët nr.3 datë 16.04.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kriteret, procedurën dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së përmbaruesve gjyqësorë shtetëror nga Policia e Shtetit”

-Urdhëri nr.333 datë 18.06.2024 “Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbaruesit gjyqësor shtetëror”

- Urdhëri nr. 334 datë 18.06.2024 “Për miratimin e marrëveshjes tip për mbledhjen e tarifës së suksesit nga shërbimi përmbarimor shtetëror”

-Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror”

Ndërkohë që me Urdhërin nr. 03 datë 11.01.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur Grupi i Punës për hartimin e Projekt- Rregullores së Brendshme të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, të cilën grupi i punës do ta përcjelli pranë Ministrisë së Drejtësisë për miratim dhe në vijim do të merret me rishikimin e Rregullores nr. 1551, datë 07.09.2006 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror” dhe hartimin e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar**. Në Urdhërin nr. 03 datë 11.01.2024, të cituar më sipër, parashikohet vetëm hartimi i Projekt-Rregullores së Brendshme të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, ndërsa për sa i përket rishikimit të Rregullores nr. 1551, datë 07.09.2006 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në

ushtrimin e funksioneve publike në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror” dhe hartimit të rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror, urdhëri në fjalë nuk shprehet.

4.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit të marrë masa për hartimin e manualit për unifikimin e praktikës gjatë ushtrimit të funksionit të përmbartimit gjyqësor shtetëror, ku të parashikohen edhe rregullat e njoftimit të vendimeve të përmbartuesit gjyqësor, në zbatim të nenit 144/a të Kodit të Procedurës Civile.

Në vijimësi

Përgjigja e Subjektit:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, prej vitit 2023 e në vijim, ka qënë e angazhuar maksimalisht për vijimin e punës në kuadër të konsolidimit të paketës së akteve nënligjore në funksion të përmirësimit të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror.

Në vijim të sqarimit të paqartësive apo ngërçeve ligjore që hasin përmbartuesit gjyqësor, gjatë fazës së ekzekutimit vullnetar dhe detyrueshëm të detyrimit objekt i titulli ekzekutiv, DPP gjithmonë ka orientuar dhe ka rekomanduar zyrat mbi procedurat vijuese në funksion të ekzekutimit tërësisht të vendimeve gjyqësore.

Thënë këtë, më lejoni tju bëj me dije se DPP në vijimësi do të hartoj manualin për unifikimin e praktikës gjatë ushtrimit të funksionit, si dhe do të bëj pjesë të trajnimeve vazhdues që do të zhvillohen për përmbartuesit gjyqësor në vijim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar. Pavarësisht se Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka orientuar zyrat se si të veprojnë mbi procedurat vijuese në funksion të ekzekutimit tërësisht të vendimeve gjyqësore., hartimi i manualit, i cili presupozon unifikimin e praktikave për zyrat përmbartimore, ende nuk është hartuar.

Komentet e subjektit të auditimit pas dërgimit të projektraportit:

Për sa më sipër, ashtu si kemi bërë me dije dhe në komunikimet e mëparshme , DPP në vijimësi do të hartoj manualin për unifikimin e praktikës gjatë ushtrimit të funksionit si dhe do të bëj pjesë të trajnimeve vazhdues që do të zhvillohen për përmbartuesit gjyqësor në vijim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Komentet e dërguara nga ana e subjektit të audituar pas dërgimit të projektraportit nuk merren në konsideratë nga ana e grupit të auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë.

Për sa më sipër rekomandimi rezulton **i pranuar, i pazbatuar.**

Për pyetjen audituese: A ka luajtur DPP një rol proaktiv në mirë organizimin e sistemit të përmbartimit shtetëror?

1. Gjetje nga auditimi:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit nuk ka hartuar një metodologji për hartimin e Planit të Punës Vjetor të Inspektiveve. Aktualisht, ky plan hartohet në mënyrë formale nga ana e Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave dhe në disa raste koha në të cilën është ushtruar inspektimi nuk korrespondon me periudhën e planifikuar në plan. (Trajtuar më hollësisht në fq. 20-25 të Raportit Përfundimtar)

1.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit të marrë masa për hartimin e metodologjisë për përpilimin e Planit Vjetor të Inspektiveve, ku të përcaktohen indikatorët që do të marrin në konsideratë për hartimin e planit vjetor të inspektiveve, metodologjia që do të përdoret për hartimin e raportit të kontrollit, afati i objeksioneve, si dhe çdo element tjetër i thelbësor e i nevojshëm.

Në vijimësi

Përgjigja e Subjektit:

Drejtoria e Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave ka hartuar si çdo vit kalendarik Planin Vjetor të Inspektimit, në të cilën janë përcaktuar Zyrat Përmbartimore, periudha kohore, temat mbi të cilat do të ushtrohet kontrolli, bazën ligjore mbi të cilën do të zhvillohet ky kontroll dhe mbi të cilën do të referohet gjatë verifikimit të praktikës përmbartimore, si dhe procedurat vijuese mbi hartimin e aktit të kontrollit dhe objeksioneve përkatëse.

Ndërkohë që nga DPP do të vijoj puna për Hartimin e Draft -Metodologjisë së Inspektimit, e cila do të përcillet për miratim Ministrisë së Drejtësisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Me Urdhërin nr. 83, datë 02.07.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm, është ngritur grupi i punës për hartimin e Draft Metodologjisë së Inspektimit.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

2. Gjetje nga auditimi:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit nuk ka përcaktuar në aktet e saj rregullatore procesin në të cilin kalon trajtimi i një kërkesë/ankese të depozituar dhe as periudhën kohore brenda të cilës do të trajtohet ajo. (Trajtuar më hollësisht në fq. 20-25 të Raportit Përfundimtar)

2.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit të përcaktojë në aktet e saj rregullative procesin e trajtimit të ankesave/kërkesave dhe afatin kohor të trajtimit të tyre.

Në vijimësi

Përgjigja e Subjektit:

Mënyra e trajtimit, afatet dhe procesin që kalon një ankesë/kërkesë DPP e ka bërë pjesë të Projekt Rregullores së Brendshme të Shërbimit që do të përcjellë për miratim pranë Ministrisë së Drejtësisë brenda muajit Korrik.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pavarësisht se, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit është shprehur se ka bërë pjesë të Projekt Rregullores së Brendshme të Shërbimit mënyrën e trajtimit, afatet dhe procesin që kalon një ankesë/kërkesë në DPP dhe me Urdhërin nr. 03, datë 11.01.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm, është ngritur grupi i punës për hartimin e kësaj Projekt Rregulloreje, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion një draft i saj. Në këto kushte, referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

Komentet e subjektit të auditimit pas dërgimit të projektraportit:

Me miratimin e ligjit të ri organik për shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror, tashmë në fuqi, janë përcaktuar rregulla sa i përket ankesave, procedimit disiplinor, etj, të cialt sigurosh

janë në vlerësim të institucionit për t'u përfshirë në mënyrë më të detajuar në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, gjë e cila është proces hartimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër rekomandimi rezulton **i pranuar, në proces zbatimi.**

3. Gjetje nga auditimi:

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit mungon një program i trajnimit vazhdues për përmbartuesit në karrierë, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre dhe përmirësimin e shërbimit të ofruar. (Trajtuar më hollësisht në fq. 20-25 të Raportit Përfundimtar).

3.1 Rekomandim:

Drejtorja e Burimeve Njerëzore pranë DPP-së, në bashkëpunim me zyrat rajonale të përmbartimit dhe nevojat e tyre të hartojë një program vjetor trajnimesh për përmbartuesit gjyqësor, ku të përfshihen edhe trajnime lidhur me etikën dhe integritetin e përmbartuesve.

Dhjetor 2023

Përgjigja e Subjektit:

Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor ka qënë në një fazë reformimi të tij dhe në këto kushte ka miratuar Ligjin e ri 8/2023 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, duke plotësuar edhe paketën e akteve nënligjore e qëllim krijimin e një sistemi sa me efektiv, transparent dhe në zbatim të ligjit.

Me Urdhëri nr.333, datë 18.06.2024 "Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbartuesit gjyqësor shtetëror" të Ministrit të Drejtësisë janë përcaktuar objektivat, modulet e trajnimit, orgaznizimi i trajnimeve. Kohëzgjatja e tyre, frekuentimi etj, me qëllim zhvillimin e vazhdueshëm profesional të përmbartuesve gjyqësor shtetëror.

Në kushtet kur urdhëri në fjalë sapo është miratuar, DPP do të procedoj me masat dhe aktivitete ne vijim për trajnimin e përmbartuesve gjyqësore shtetërore.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

2. A janë ekzekutuar në respektim të afateve procedurale titujt ekzekutivë nga ana e shërbimit përmbartimor shtetëror?

2.1 Për pyetjen audituese: A kanë ofruar zyrat përmbartimore rajonale shërbim cilësor ndaj qytetarëve?

Gjetje nga auditimi:

Gjatë vitit 2022, Shërbimi Përmbartimor Shtetëror ka ushtruar veprimtarinë me 59 përmbartues, ndërsa 19 vende në strukturë kanë qënë vakante. Gjatë këtij viti, përmbartimi shtetëror ka pasur një total prej 57,035 çështjesh, duke përfshirë pensionet ushqimore dhe takimet me fëmijët, të cilat janë në ekzekutim të vazhdueshëm. Kështu, raporti midis dosjeve për ekzekutim dhe numrit faktik të përmbartuesve është jo proporcional. Konkretisht, pas plotësimit të disa vendeve vakante në fund të vitit 2022, rezulton se për çdo përmbartues shtetëror janë afërsisht 839 dosje në ekzekutim. (Trajtuar më hollësisht në fq. 25-33 të Raportit Përfundimtar)

Gjetje nga auditimi:

Problemet me infrastrukturën dhe mungesa e mjeteve të nevojshme janë konstatuar në zyrat rajonale përmbarimore. Një problematikë e konstatuar është mungesa e ambienteve të arkivës për mbajtjen e dosjeve në zyrat rajonale. Gjithashtu, nga vizitat e zhvilluara rezultoi se ambientet e punës janë të vogla dhe në disa raste (si p.sh. në Berat dhe Lushnje), përmbaruesit nuk kishin një hapësirë pune të dedikuar, por iu duhej të ndanin me njëri-tjetrin tavolinën dhe mjetet e punës (kompjuterin). (Trajtuar më hollësisht në fq. 25-33 të Raportit Përfundimtar)

1.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit të kërkojë pranë Ministrisë së Drejtësisë marrjen e masave për përmirësimin e situatës së mbingarkesës së përmbaruesve, kushteve infrastrukturore të zyrave rajonale dhe problematikave të tjera të lidhura me to.

Dhjetor 2023

Përgjigja e Subjektit:

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror përballet më një ngarkesë dhe volum pune të madh, i cili nuk luan një raport të drejtë midis dosjeve përmbarimore, 59 361 dosje të regjistruara për periudhën Janar – Qershor 2024 dhe numrit të përmbaruesve gjyqësor, 74 përmbarues gjyqësor (me Urdhër nr. 222 Prot., datë 14.12.2023 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror” numri i përmbaruesve gjyqësor shkoi nga 78 në 74), duke sjellë mosrespektim të afateve në ndjekjen e procedurave përmbarimore e për rrjedhojë zvarritje në ekzekutim, mbartje të çështjeve nga viti në vit dhe mosekzekutim të titujve ekzekutiv.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit nëpërmjet shkresës nr.733 prot., datë 12.04.2023, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me propozim për miratimin e strukturës organizative, organike dhe strukturës së pagave për shërbimin përmbarimor.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit në mënyrë të përsëritur i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, duke e informuar mbi infrastrukturën e shërbimit, si dhe nevojën për përmirësim të saj, pasi mungesa e infrastrukturës, ambienteve jo funksionale ndikon drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave të Shërbimit lidhur me ekzekutimin e titujve ekzekutiv dhe cënon cilësinë e ofrimit të këtyre shërbimeve.

Me shkresën nr.2149 prot., datë 29.12.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me kërkesë për sistemimin e 22 zyrave përmbarimore, deri më tani është sistemuar Zyra Përmbarimore Gjirokastër dhe janë duke u zhvilluar procedurat edhe për 2 Zyra të tjera Përmbarimore, ajo e Lushnjës dhe Durrësit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar, i zbatuar.**

Gjetje nga auditimi:

Një tjetër problem i evidentuar në zyrën përmbarimore të Fierit dhe Tiranës, por i parashtruar në të gjitha zyrat rajonale të audituara është vështirësia e lajmërimit për debitorët, për shkak të pasaktësive në adresa. (Trajtuar më hollësisht në fq. 25-33 të Raportit Përfundimtar)

2.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit të standardizojë praktikën përmbarimore për njoftimin e palëve, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, duke e përfshirë

në aktet e brendshme institucionale të miratuara (p.sh. në Manual / Udhëzues të rekomanduar më lart).

Dhjetor 2023

Përgjigja e Subjektit:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit i ka bërë prezent gjithmonë në analizat 6 mujore dhe vjetore të institucionit të saj, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, problemin e adresave të palëve kreditor/debitor, pasaktësisë, problematikat me vendimeve të gjykatave që kanë të dhëna jo të plota ose jo të sakta etj.

Në funksion të zgjidhjes së ngërçit të krijuar, bazuar në shqetësimin e zyrave përmbarrimore, me shkresën nr. 1579/16 prot., datë 26.10.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit i është drejtuar Postës Shqiptare, Administratorit të saj, duke bërë prezent shqetësimin dhe kërkuar bashkëpunimin e zyrave të tyre rajonale me qëllim njoftimin e palëve, pasi shumica e zarfave ktheheshin mbrapsht pranë zyrave përmbarrimore në rrethe me mbishkrimin” larguar”, “I panjohur”, adresë e pasaktë” etj

Thënë këtë më lejoni t’ju bëj me dije se në kuadër të plotësimit të kuadrit të akteve nënligjore DPP do të hartoj manualet përkatëse me qëllim zgjidhjen e ngërçeve me adresat e palëve.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar. Pavarësisht se Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit është përjektur në mënyrë aktive të përmirësojë problemet që sjell vështirësia e lajmërimit për debitorët, për shkak të pasaktësive në adresa, ajo ende nuk ka hartuar manualet përkatëse me qëllim standardizimin e praktikës përmbarrimore për njoftimin e palëve.

Komentet e subjektit të auditimit pas dërgimit të projektraportit:

Duke evidentuar aktet nënligjore në zbatim të ligjit të ri organik të shërbimit dhe kohës së nevojshme që kërkohet për vlerësimin dhe dhënien e kontributit, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit, pavarësisht se hartimi i akteve nënligjore kërkon kohën e duhur si dhe staf të shtuar, sqaron se standartizimi i praktikës përmbarrimore është dhe mbetet prioritet, i institucionit për t’u realizuar në vijim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**, pasi DPP ende nuk ka hartuar manualet përkatëse me qëllim standardizimin e praktikës përmbarrimore për njoftimin e palëve.

Gjetje nga auditimi:

Një tjetër problem i hasur në praktikën përmbarrimore rezulton edhe emigrimi i shumë debitorëve të cilët duke qenë larg, nuk paguajnë detyrimin ushqimor dhe nuk u rezulton pasuri e sekuestrueshme, pavarësisht faktit se shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën e Hagës në lidhje me bashkëpunimin me vende të tjera për ekzekutimin e vendimeve. Nga intervistat e zhvilluara rezultoi se përmbarruesit shtetërorë nuk ishin të mirëinformuar për procedurat e saj. (Trajtuar më hollësisht në fq. 25-33 të Raportit Përfundimtar)

3.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit të referojë çdo çështje që nuk mund të ekzekutohet për shkak se debitori ndodhet jashtë vendit pranë Ministrisë së Drejtësisë, si autoriteti

shtetëror kompetent që transmeton kërkesat për njohje dhe ekzekutim vendimi jashtë territorit shqiptar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigja e Subjektit:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, ashtu si kemi bërë me dije edhe më sipër, e ka bërë prezent se një nga shkaqet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore, përveç faktorëve të listuar më sipër, është edhe emigrimi i debitorëve, faktor i cili çon në zvarritje të ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Në rastet e paraqitura pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, i'u është bërë me dije ankuesve në Kthim – Përgjigjet e tyre se, bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, duhet t'i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të tyre në shtetet ku debitorët kanë emigruar, në rastin kur palët kanë të dhëna të sakta të adresave të tyre. Shpeshherë palët kanë refuzuar duke u shprehur se kanë humbur boll kohë dhe të ardhura me gjyqe.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka orientuar ankuesit t'i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të tyre në shtetet ku debitorët kanë emigruar, në rastin kur palët kanë të dhëna të sakta të adresave të tyre. Megjithatë, problemi i zvarritjes së ekzekutimit të titujve ekzekutiv, si pasojë e emigrimit të debitorëve, ende nuk ka gjetur zgjidhje. Sipas Konventës së Hagës për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes nr. 38 (23 Nëntor 2007), çdo shtet kontraktues duhet të caktojë një autoritet qendror për të përmbushur detyrat që vendosen nga Konventa për këtë autoritet. Në rastin e Shqipërisë, autoriteti vendas është Ministria e Drejtësisë. Në këtë kuadër, roli i Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet shtetëror kompetent që transmeton kërkesat për njohje dhe ekzekutim vendimi jashtë territorit shqiptar, është i rëndësishëm si për fillimin e procedurave përkatëse apo lehtësimin e tyre ashtu edhe për marrjen e masave të duhura për ofrimin e ndihmës ligjore. Referimi i rasteve të tilla pranë Ministrisë së Drejtësisë, pa qenë e nevojshme që kreditori të hartojë një kërkesë të re për këtë të fundit, rrit eficiencën e ekzekutimit të vendimeve.

Komentet e subjektit të auditimit pas dërgimit të projektraportit:

Ashtu si kemi bërë me dijëni në komunikimet e mëparshme DPP e ka bërë prezent se një nga shkaqet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore, përveç faktorëve të listuar më sipër, është edhe emigrimi i debitorëve, faktor i cili çon në zvarritje të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

Në rastet e paraqitura pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit i'u është bërë me dije ankuesve në Kthim - Përgjigjet e tyre se, bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, duhet t'i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të tyre në shtetet ku debitorët kanë emigruar, në rastin kur palët kanë të dhëna të sakta të adresave të tyre.

Gjithashtu më lejoni tju sqaroj se bazuar në dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Civile janë vetëm palët apo përfaqësuesit me prokurë të tyre ato që inicjojnë apo vënë në lëvizje kërkesat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe jo Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër rekomandimi rezulton **i pranuar, pjesërisht i zbatuar.**

2.2 Për pyetjen audituese: A ka bashkëvepruar shërbimi përmbartimor shtetëror në mënyrë integrale me aktorët e tjerë të përfshirë në proces, në funksion të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore?

1. Gjetje nga auditimi:

Shërbimi Përbarimor Shtetëror, që nga shtatori i vitit 2019 është përballur me refuzimin e zyrave vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për zbatimin e urdhrave të sekuestros mbi pasuritë e paluajtshme të debitorëve, me argumentin se duhet parapaguar tarifa e shërbimit, përcaktuar me VKM-në nr. 389, datë 13.05.2020. Në rastet kur kreditorët janë persona në pamundësi financiare që përfitojnë edhe nga Ndihma Juridike falas e garantuar nga shteti, rezulton se as kreditori dhe as shërbimi përbarimor nuk kanë mundësi të parapaguajnë tarifën për vendosjen e urdhër sekuestros dhe rrjedhimisht, procedura e ekzekutimit ngelet pezull. (Trajtuar më hollësisht në fq. 33-37 të Raportit Përfundimtar)

2. Gjetje nga auditimi:

Një problematikë e ngjashme haset edhe në rastet e vendosjes së urdhër sekuestros mbi automjetet e debitorëve, ku Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor pretendon se nuk është institucioni përgjegjës për bllokimin e mjeteve. (Trajtuar më hollësisht në fq. 33-37 të Raportit Përfundimtar)

3. Gjetje nga auditimi:

Në vijim të procesit të bashkëpunimit të shërbimit përbarimor shtetëror me palët e tjera përfshira në proces, problem përbën edhe mungesa e gatishmërisë së Inspektorateve të Mbrojtjes së Territorit pranë pushtetit vendor, për të vënë në dispozicion mjetet e nevojshme (fadroma) në rastet kur titujt ekzekutivë kanë për objekt lirim dhe dorëzimin e një sendi apo prishjen e një objekti. (Trajtuar më hollësisht në fq. 33-37 të Raportit Përfundimtar)

1.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, të marrë masa për hartimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, për vendosjen e sekuestrove apo çdo veprimtarie tjetër në funksion të ekzekutimit të vendimeve.

Dhjetor 2023

Përgjigja e Subjektit:

Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit në mënyrë të përsëritur i'u është drejtuar institucioneve në fjalë duke sqaruar veprimtarinë përbarimore, procedurat ligjore, referencat e tyre, shqetësim të cilin e ka përcjellë edhe në Ministrinë e Drejtësisë. Në shkresat e saj Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit i'u ka bërë me dije institucioneve të lartpërmendura se, veprimtaria e përbaruesve gjyqësor është një veprimtari, e cila kryhet në bazë të dispozitave ligjore dhe si e tillë këto dispozita duhen respektuar nga të gjithë me qëllim ekzekutimin e titujve ekzekutiv, si dhe duke vënë theksin në faktin se Urdhëri për Sekuestro Konservative i përbaruesit gjyqësor, i parashikuar nga dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Civile, është i vetmi mekanizëm, akt procedural, i cili garanton ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, duke materializuar të drejtën të cilët qytetarët e kanë fituar nëpërmjet vendimeve gjyqësore.

Me qëllim zgjidhjen e ngërçit të krijuar dhe në funksion të zbatimit të dispozitave ligjore për ekzekutimin e Titujve Ekzekutiv, është zhvilluar një takim në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Përbarimit midis Drejtorit të Përgjithshëm të DPP, ZV. Drejtorit të Përgjithshëm të DPP, 2 Inspektor të Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave si dhe tre përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit dhe Transportit Rrugor.

Përfaqësuesit e DSHTRR u paraqitën pranë DPP sërish me të njëjtat qëndrime, të cilat ishin përcjellë edhe zyrtarisht pranë institucionit tonë, madje duke këmbëngulur se Urdhërat për Sekuestro të përmbauesve gjyqësor duhet t'i drejtohen RBS, pasi tashmë Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor nuk disponon të dhënat dhe dokumentacionin e mjeteve.

Lidhur me këtë pretendim nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaimit i'u shpjegua përfaqësuesve të DPSHTRR se një shërbim i tillë përveçse shton kostot financiare të palëve, nuk është parashikuar në asnjë dispozitë ligjore, se RBS është institucioni përgjegjës për regjistrimin apo ndryshimin e pronësisë së mjeteve. DPP j'u bëri me dije këtyre të fundit se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit dhe Transportit Rrugor është institucioni që bazuar në nenet 92, 93 e vijues të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, është përgjegjës për regjistrimin e pronësisë, ndryshimin e pronësisë së mjeteve dhe çdo ndryshim tjetër.

Ndër të tjera në nenin 93 përcaktohet se: "Në rast ndryshimi pronësie të automjeteve, motomjeteve dhe rimorkiove ose në rastin kur i jepen në përdorim të tjerëve a kur lidhen marrëveshje për qiradhënie me të drejtë blerjeje, dega përkatëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas kërkesës së paraqitur nga ana e interesuar, brenda 10 ditëve nga data kur nënshkrimi i aktit është vërtetuar ose është gjykuar i rregullt, merr masa për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose të ndryshimeve të tjera, si dhe për lëshimin e certifikatës së re të pronësisë.

Zyra e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas kërkesës së paraqitur nga pronari brenda afateve të përcaktuara në pikën 1, merr masa për rinovimin ose azhurnimin e lejes së qarkullimit që pasqyron ndryshimet e treguara në pikën e mësipërme. Në mënyrë të ngjashme veprohet edhe për ndryshimin e vendbanimit." Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaimit u sqarua se Shërbimi Përmbaimit Gjyqësor ekzekuton Titujt Ekzekutiv, të përcaktuara qartë në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk ekzekuton vetëm Barrët Siguruese, të parashikuara në Ligjin nr. 8537/1999, pasi Barrët Siguruese janë një ndër Titujt Ekzekutiv që ekzekutohen nga Shërbimi Gjyqësor sipas përcaktimeve ligjore. Ndër të tjera Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaimit u shpjegoi përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor se Urdhërat për Sekuestro të vendosura nga përmbauesit gjyqësor mbi dokumentacionin e mjeteve nuk presupozojnë që institucioni në fjalë të tërheq dokumentacionin fizikisht pronarit të mjetit, por të bëhet bllokimi dhe shënimi përkatës në regjistër për mos tjetërsimin e mjetit, deri në përmbushjen e detyrimit që përcakton Titulli Ekzekutiv, pasi bllokimi fizik i mjetit kryhet nga Strukturat e Komisarariatit të Policisë Rrugore.

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbaimit Gjyqësor Shtetëror, në takimin e datës, u shpreh qartazi se përmbauesit gjyqësor nuk mund të kryejnë veprime jashtë parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe me konkretisht nenit 527 të tij i cili citon: "Kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbauesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim (neni 517), fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit", duke u bërë sërish me dije se Urdhërat e Sekuestros të përmbauesve gjyqësor hiqen vetëm me Urdhër për Heqje Sekuestro të përmbauesit gjyqësor ose me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Në vijim të sa më sipër, u sqarua se aplikimi i sanksioneve ligjore ndaj personave që bëhen përgesë është një detyrim ligjor i parashikuar në nenet 606 të Kodit të Procedurës Civile dhe 320 të Kodit Penal, në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

Gjithashtu sa i përket moszbatimit të Urdhërave Për Sekuestro Konservative mbi pasuritë e paluajtshme nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaimit ka bërë prezent shqetësimin e saj drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke sqaruar ndër të tjera se, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës civile, Ligji nr.8116 datë 29.03.1996, i

ndryshuar, Urdhëri i Sekuestros është akt procedural civil i nxjerrë nga përmbartuesi gjyqësor për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv dhe ka kërkuar nga kjo e fundit reflektimin e ndryshimeve përkatëse për përjashtimin e Urdhërit për Sekuestro të përmbartuesit gjyqësor nga Vendimi nr.389 datë 13.05.2020 "Për miratimin e listës dhe të shërbimeve kadastrale"

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë duke kërkuar marrjen e masave për garantimin e zbatimit të urdhërave të sekuestros së përmbartuesve gjyqësor mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme nga Agjencia Rajonale Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoritë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, pasi moszbatimi i tyre sjell zvarritje dhe mosekzekutim të vendimeve gjyqësore.

Gjithashtu vlen të theksojmë se mosvendosja e Urdhërave Për Sekuestro Konservative të përmbartuesve gjyqësor nga institucionet në fjalë, përveçse bëhet pengesë në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe në rritjen e performancës së Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor, shton kostot e qytetarëve, pasi këta të fundit duhet të paguajnë për vendosjen e sekuestrove konservative, që është një tarifë shtesë, mbi tarifën e parapaguar nga kreditori për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor.

Gjithashtu Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit i është drejtuar Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, bazuar në shqetësimin e Zyrove Përmbartimore si dhe në ankesat e përsëritura që përcillen pranë DPP nga ana e qytetarëve gjyqësorë, për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore me objekt lirim dhe dorëzim sendi etj, me shpresën se do t'i jepet zgjidhje këtij ngërçi, në funksion të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, pasi mospërmbushja e detyrimit ligjor nga ana e Inspektoriateve të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkive përkatëse, do të sjellë mosekzekutimin e titujve ekzekutivë, vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Zyrat Përmbartimore Shtetërore në rrethe shprehin shqetësimin se gjatë ndjekjes së procedurave përmbartimore në funksion të ekzekutimit të Titujve Ekzekutiv me objekt lirim dhe dorëzim sendi, prishje objekti etj, bazuar në nenin 523 të Kodit të Procedurës Civile " Detyrimi për Bashkëpunim" i janë drejtuar disa herë Inspektoriateve të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkive përkatëse, me "Kërkesë për Mbështetje në ekzekutim", por nga këto të fundit i'u është përcjell përgjigjja se nuk disponojnë mjetet për të mundur prishjen apo lirimin e një trualli.

Në funksion të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore zyrat i janë drejtuar edhe Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për mbështetje gjatë ekzekutimit me mjetet dhe personelin e nevojshëm, dhe nga ana e IKMT janë adresuar t'i drejtohen Inspektoriateve të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkive përkatëse, pasi Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, për shkak të anagazhimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të përmbushi kërkesën e zyrove përmbartimore.

Me qëllim ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në zbatim të dispozitave ligjore për ekzekutimin e Titujve Ekzekutiv, neni 525 i Kodit të Procedurës Civile, përmbartuesit gjyqësor shpeshherë ju drejtohen palëve kreditore për të bërë të mundur gjetjen e mjeteve prishëse si fadromë, eskavator etj, në kushtet kur IMT deklaroi se s'kanë mjete, por nga qytetarët nuk pranohet një kërkesë e tillë me arsyetimin se është detyrë e organeve kompetente dhe se nga zyrat përmbartimore duhet të aplikohen sanksione ndaj personave që bëjnë pengesë në ekzekutimin e titujve ekzekutiv.

Në takimin e datës 17.11.2023 të mbajtur nga Ministri i Drejtësisë, u arrit në përfundimin dhe u hartua një Memo me anë të së cilës u konkludua se Ministria e Drejtësisë do ti drejtohej Ministrisë së Financave për uljen e tarifave të këtyre shërbimeve dhe DPP është ende në pritje.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit ka patur një rol proaktiv me qëllim realizimin e këtij rekomandimi, duke realizuar takime e hartuar shkresa në lidhje me problematikën e përmendur më sipër.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

IV. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresën nr. 1182/5 prot., datë 20.07.2023, konstatohet se **vetëm 1 nga 11** rekomandime të lëna është zbatuar. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **ri-kërkojmë** zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Për pyetjen audituese A kanë nxitur dhe siguruar politikat e hartuara mirë funksionimin e sistemit të përmbarrimit shtetëror?

1.1 A është hartuar kuadri rregullator i nevojshëm me qëllim ofrimin e një shërbimi përmbarrimor në përputhje me misionin institucional të DPP?

1. Gjetje nga auditimi:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit nuk ka një Strategji Institucionale ku përcaktohen objektivat dhe prioritetet e veprimtarisë së saj. DPP ka përcaktuar disa objektiva në Analizat Vjetore Institucionale. Objektivat e shërbimit përmbarrimor shtetëror duhet të jenë të përcaktuara në një dokument strategjik dhe jo pjesë integrale e analizës vjetore institucionale.

1.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit të marrë masa për hartimin e Strategjisë Institucionale, e cila përcakton objektiva konkret për efektivitetin e shërbimit përmbarrimor shtetëror, në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Brenda muajit Qershor 2025

2. Gjetje nga auditimi:

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përkatësisht neni 25 krijon një vakum ligjor sa i përket mbulimit të shpenzimeve të ekspertëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve për personat në pamjaftueshmëri financiare, të cilët përfitojnë nga ndihma juridike dytësore falas. Tarifa e psikologut apo çdo eksperti tjetër gjatë fazës së ekzekutimit nuk përfshihet në skemën e ndihmës juridike dytësore falas, duke sjellë kështu vështirësi për përmbarruesit gjyqësor shtetëror gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

2.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit të përcjellë në Ministrinë e Drejtësisë problematikën e konstatuar gjatë ekzekutimit të “titujve ekzekutiv” për personat në pamjaftueshmëri financiare të cilët mbulohen nga skema e ndihmës juridike falas, sa i përket mbulimit të shpenzimeve të ekspertëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve.

Brenda muajit Prill 2025

3. Gjetje nga auditimi:

Rregullorja nr. 1551, datë 07.09.2006 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror” nuk reflekton ndryshimet ligjore të nevojshme, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 dhe Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2006. Ministria e Drejtësisë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim me qëllim miratimin e këtij akti, pavarësisht se kanë kaluar dy vjet nga perioda që DPP ia ka përcjellë.

4. Gjetje nga auditimi:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit nuk ka hartuar një rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror, pavarësisht parashikimit të hartimit të saj në planet e punës për vitet 2020-2022.

3.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit të marrë masa:

- për rishikimin e Rregullores së Brendshme të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror.
- për rishikimin e Rregullores nr. 1551, datë 07.09.2006 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror”.
- për hartimin e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror.

Brenda muajit Qershor 2025

4.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit të marrë masa për hartimin e manualit për unifikimin e praktikës gjatë ushtrimit të funksionit të përmbartimit gjyqësor shtetëror, ku të parashikohen edhe rregullat e njoftimit të vendimeve të përmbartuesit gjyqësor, në zbatim të nenit 144/a të Kodit të Procedurës Civile.

Brenda muajit Qershor 2025

2. Për pyetjen audituese A janë ekzekutuar në respektim të afateve procedurale titujt ekzekutivë nga ana e shërbimit përmbartimor shtetëror?

2.1 A kanë ofruar zyrat përmbartimore rajonale shërbim cilësor ndaj qytetarëve?

5. Gjetje nga auditimi:

Një tjetër problem i evidentuar në zyrën përmbartimore të Fierit dhe Tiranës, por i parashtruar në të gjitha zyrat rajonale të audituara është vështirësia e lajmërimit për debitorët, për shkak të pasaktësive në adresa.

5.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit të standardizojë praktikën përmbartimore për njoftimin e palëve, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, duke e përfshirë në aktet e brendshme institucionale të miratuara (p.sh. në Manual / Udhëzues të rekomanduar më lart).

Brenda muajit Qershor 2025

6. Gjetje nga auditimi:

Një tjetër problem i hasur në praktikën përmbartimore rezulton edhe emigrimi i shumë debitorëve të cilët duke qenë larg, nuk paguajnë detyrimin ushqimor dhe nuk u rezulton pasuri e sekuestrueshme, pavarësisht faktit se shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën e Hagës

në lidhje me bashkëpunimin me vende të tjera për ekzekutimin e vendimeve. Nga intervistat e zhvilluara rezultoi se përmbaruesit shtetërorë nuk ishin të mirëinformuar për procedurat e saj.

6.1 Rekomandim:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit të referojë çdo çështje që nuk mund të ekzekutohet për shkak se debitori ndodhet jashtë vendit pranë Ministrisë së Drejtësisë, si autoriteti shtetëror kompetent që transmeton kërkesat për njohje dhe ekzekutim vendimi jashtë territorit shqiptar.

Brenda muajit Qershor 2025

Të tjera

Për të gjitha masat e dhëna të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar me statusin ***në proces zbatimi***, duke vlerësuar proceset e ndërmarra nga subjektet e audituara dhe afatet e nevojshme për implementimin e plotë të tyre, kërkohet përmbushja e plotë e tyre **brenda tremujorit të parë të vitit 2025**.

5. PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “NDIKIMI I MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR NË CILËSINË E AJRIT”.

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 914 prot. datë 08.07.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023 ”ushtri auditim në subjektet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, lidhur me auditimin e performancës me temë “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit” të realizuar në 6 muajorin e parë të vitit 2023, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë:

Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 1181/11 datë 19.07.2023;

Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën nr. 1181/10 datë 19.07.2023;

Në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me shkresën nr. 1181/12 datë 19.07.2023; duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-^{së}, të lëna nga auditimi i kryer në 6 muajorin e parë të vitit 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja 'j' të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-^{së}, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: Nga auditimi u konstatua se, MIE nuk ka përcjellë në KLSH *Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH*, në mos përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: Nga auditimi u konstatua se, MTM nuk ka përcjellë në KLSH *Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH*, në mos përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit: Nga auditimi u konstatua se, AKM ka *dërguar në KLSH Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH*, në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka respektuar afatin **prej 6 muajsh**, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky në mospërputhje me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka respektuar afatin **prej 6 muajsh**, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” duke dërguar në KLSH Raportin e masave mbi zbatimin e rekomandimeve me nr. 558/1 datë 22.01.2024.

Agjencia Kombëtare të Mjedisit nuk ka respektuar afatin **prej 6 muajsh**, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

KLSH ka dërguar:

- në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 1181/11, datë 19.07.2023
- në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 1181/10, datë 19.07.2023
- në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me shkresën nr. 1181/12, datë 19.07.2023

Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë “Menaxhimi i Burimeve Ujore”.

Në këtë auditim, me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar 1 masë “Propozime për ndryshime ligjore” dhe 14 “Masa organizative” për zbatim. Nga 15 masat e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 15 masa ose 100 % e tyre.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.	1	1	-
2	Masa Organizative	14	14	
	Totali	15	15	-

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së", lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”, miratuar me shkresën nr. 754/3, datë 05.07.2021, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 914 prot., datë 08.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit e KLSH-së:

- A.G, Përgjegjës Grupi;
- Xh.Ç, Anëtare.
- J.Zh, Anëtare.

II.1. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Raporti, për auditimin e performancës me temë “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë ajrit”.

II.2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

II.4. Konkluzioni:

Në tre subjektet e audituar rezultoi që dy prej tyre Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk janë marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për të informuar KLSH^{ne} mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, ndërsa nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit janë marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh në zbatim të ligjit të sipërcituar.

Po kështu nga këto subjekte, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk janë marrë masa për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor. Afat ky i përcaktuar në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka marrë masa për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH^{ja}, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Raporti, rezulton se:

- Nga 15 masat e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 15 masa ose në masën 100 %. Nga 15 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 masa ose 26 % tyre, janë në proces zbatimi 2 masa ose 14 % , zbatuar pjesërisht 3 masa ose 20 % dhe janë pa zbatuar 6 masa ose 40 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Pa pranuar	Statusi i zbatimit			
				Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.	1			1		
2	Masa Organizative	14		4	2	2	6
Totali		15		4	3	2	6

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet:

Nr.	Statusi i masave	Në numër	Në %
1	Totali	15	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	15	100%
	Nga të pranuarat:	15	Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar	4	26%
2	Zbatuar pjesërisht	3	20%
3	Në proces	2	14%
4	Pa zbatuar	6	40%

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 26 % dhe së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi niveli i tyre shkon në 40 %.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

III.1. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

2.1. Për nënpyetjen: A janë planifikuar politika, objektiva dhe aktivitete të përshtatshme në sektorin e transportit rrugor për të përmirësuar cilësinë e ajrit?

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në vendin tonë nuk janë transpozuar Direktiva 2009/33/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 23 prill 2009 “Mbi promovimin e mjeteve të transportit rrugor të pastër dhe me energji eficiente” dhe Direktiva 2014/94/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 22 Tetor 2014 “Mbi vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative”. Transpozimi i këtyre direktivave do të nxiste dhe do të kontribuonte më tej në rinovimin e flotës së mjeteve rrugore që përdorin karburant të pastër.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të hartojë dhe propozojë për miratim pranë organeve kompetente akte ligjore/nënligjore për të transpozuar Direktivën 2009/33/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 23 prill 2009 “Mbi promovimin e mjeteve të transportit rrugor të pastër dhe me energji eficiente” dhe Direktivës 2014/94/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 22 Tetor 2014 “Mbi vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative”.

Qershor 2024

Përgjigje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Në lidhje me këto direktiva është parashikuar të miratohet një projektvendim i Këshillit të Ministrave brenda vitit 2024 që përaftron direktivën Evropiane 2009/33/EC. Nga ana e Ministrisë është përgatitur një draft i cili është në diskutim brenda institucionit si dhe Agjencia e Prokurimit publik ka dhënë komentet e saj. Pas plotësimeve të mëtejshme projektvendimi do të nisë procedurën zyrtare të paraqitjes për mendim ministrive të ndryshme e fazat e tjera deri në miratimin përfundimtar.

Gjithashtu është parashikuar brenda vitit 2025 miratimi i një projekt udhëzimi të MIE "Për transportin rrugor të qëndrueshëm, zbatimi i infrastrukturës të karburanteve alternative", i cili synon përafrimin me direktivën 2014/94/BE, mbi vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka dhënë komente e shpjegime të tjera me anë të shkresës nr 5760/4 datë 15.10.2024 për rekomandimin nr. 1.1 të nënpyetjes 2.1. Konkretisht për këtë rekomandim MIE citon se “procedura e miratimit të iniciativave ligjore të përmendura në rekomandim është sipas afateve kohore të përcaktuara tashmë, në VKM nr 16, datë 11.1.2024 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2024-2026”.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Pavarësisht se është nisur procedura për zbatimin e pjesës së parë të këtij rekomandimi me PKIE 2024-2026 ku është parashikuar miratimi i projekt vendimit të Këshillit të Ministrave për përafrimin e Direktivës Evropiane 2009/33/EC, ende nuk ka diçka konkrete sa i përket përafrimit të Direktivës 2014/94/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 22 Tetor 2014 “Mbi vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative”. Afati për zbatimin e plotë të këtij rekomandimi ka qenë Qershor 2024, ndaj edhe rekomandimi do të konsiderohet pjesërisht i zbatuar. Pavarësisht komenteve e shpjegimeve të MIE me shkresën nr. 5760/2 datë 03.09.2024, si dhe 5760/4 përsërisim se në PKIE 2024-2026 nuk parashikohet përafrimi i Direktivës 2014/94/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 22 Tetor 2014 “Mbi vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative”. Gjithashtu, afati i vendosur nga PKIE 2024-2026 lidhur me përgatitjen e një Projekt Vendimi të Këshillit të Ministrave mbi promovimin e mjeteve të pastra të transportit rrugor është tremujori i fundit i 2024. Grupi i auditimit në Projekt Raportin e dërguar me shkresën nr 914/13 datë 11.09.2024 ka rikërkuar që ky rekomandim të zbatohet deri në qershor të vitit 2025, pra duke e shtyrë me 1 vit afatin e vendosur në Raportin Final të Auditimit. Bazuar në të gjitha këto, qëndrojmë në të njëjtin mendim që rekomandimi të konsiderohet pjesërisht i realizuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, pjesërisht i zbatuar.

III.2. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Nënpyetja: A kanë pësuar ndryshim mjetet e transportit rrugor me qëllim përmirësimin e cilësisë ajrit?

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi gjendjen e flotës së mjeteve rrugore është evidentuar se ka pasur një rritje të numrit të mjeteve rrugore me naftë me rreth 158,000 mjete nga viti 2015 në vitin 2022. Gjithashtu, për të njëjtën periudhë, vërehet se nuk është përmirësuar raporti i mjeteve rrugore me naftë kundrejt totalit, raport i cili thuhet se ka qëndruar i pa ndryshuar në nivelin rreth 71 %. Kjo situatë nuk ndikon në reduktimin e shkarkimeve që vijnë nga mjetet e transportit rrugor.

2. Gjetje nga auditimi: Moshja mesatare e mjeteve rrugore në vendin tonë, për periudhën 2015-2018 ka qenë në nivele 16-18 vjet duke shënuar nivelin maksimal të moshës mesatare (18 vjet) në 3 vjeçarin e fundit (2020-2022). Në këtë fenomen ka ndikuar rritja e numrit të mjeteve me moshë më të madhe se 20 vjet si dhe mos rritja e mjaftueshme e grupomoshave të tjera (0-2 vjet, 3-5 vjet, 5-10 vjet) që ndikojnë në uljen e moshës mesatare të mjeteve rrugore.

3. Gjetje nga auditimi: Kategoria e mjeteve rrugore që ndikon më së shumti në përkeqësimin e cilësisë së ajrit është ajo e mjeteve rrugore me naftë më të vjetra se 20 vjet. Për periudhën 2020-2022 ka pasur një rritje të kësaj kategorie me afërsisht 93,000 mjete, përkatësisht nga 104,473 mjete rrugore në vitin 2020 në 197,383 mjete rrugore në vitin 2022, ç’ka do të thotë se kemi pasur një rritje të raportit të këtyre mjeteve kundrejt totalit me 9.3 %

në vitin 2022 krahasuar me vitin 2020. Pra, raporti i mjeteve rrugore me naftë më të vjetra se 20 vjet kundrejt totalit, nga 15.4 % në vitin 2020 ka shkuar në 24.7% në vitin 2022.

4. Gjetje nga auditimi: Nga krahasimi i mjeteve rrugore M1 sipas grupmoshave midis Shqipërisë dhe vendeve të BE-së, rezulton se vendi ynë (38%) është i dyti pas Polonisë (40%) me përqindjen më të lartë të mjeteve rrugore M1 më të vjetra se 20 vjet. Ndërsa, sa i përket mjeteve rrugore të grupmoshave “0-2 vite”, “3-5 vite”, “5-10 vite”, krahasuar me vendet e tjera, vendi ynë zë përqindjen më të ulët kundrejt totalit të mjeteve rrugore M1.

5. Gjetje nga auditimi Nga krahasimi i situatës në vendin tonë me disa prej vendeve të tjera të rajonit dhe të BE-së rezulton se, për vitin 2021, Shqipëria ka raportin më të ulët të mjeteve rrugore elektrike (M1) kundrejt totalit me 0.11 %.

6. Gjetje nga auditimi: Moshja mesatare e autobusëve për periudhën 2015-2022 është luhatur në kufijtë 18 deri në 22 vjet. Niveli më i ulët i moshës mesatare të autobusëve regjistrohet në vitin 2017 (me 18 vjet), ndërsa niveli më i lartë është ai i vitit 2022 (me 22 vjet). Pavarësisht faktit se ka pasur një shtim të lehtë të autobusëve me lloje të tjera karburanti (benzinë+gaz, naftë +elektrik etj), ende sot mbi 99% e tyre operojnë me naftë.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse për sektorin e transportit rrugor të analizojë gjendjen e flotës së mjeteve rrugore dhe të paraqes propozime konkrete për rinovimin dhe përmirësimin e saj.

Mars 2024

Përgjigje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Duke qenë se transporti i pastër rrugor është subjekt i axhendës së integritetit të kapitullit të 14 dhe bazuar në takimin bilateral me Komisionin e BE që u mbajt në korrik të vitit 2023, MIE ka vendosur në PKIE 2024-2026 nismat ligjore që kanë të bëjnë me promovimin e mjeteve të transportit rrugor në mbështetje të lëvizshmërisë me emetime të ulëta. Është parashikuar të miratohet një projektvendim i Këshillit të Ministrave brenda vitit 2024 që përafrohet direktivën Evropiane 2009/33/EC. Gjithashtu është parashikuar brenda vitit 2025 miratimi i një projekt udhëzimi të MIE "Për transportin rrugor të qëndrueshëm, zbatimi i infrastrukturës të karburanteve alternative", i cili synon përafrimin me direktivën 2014/94/BE, mbi vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative. Projekt udhëzimi ka për qëllim miratimin e një kuadri masash për vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative duke përcaktuar kërkesat minimale për pikat e mbushjes së mjeteve elektrike dhe pikat për gazin natyror dhe hidrogjenin dhe specifikime teknike uniforme për pika të tilla. Një masë tjetër është që Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor rimbursonte tarifën e regjistrimit për herë të parë të mjeteve elektrike dhe hibride elektrike (tarifat e kontrollit fizik, të lejes së qarkullimit dhe të targave standard).

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Rekomandimi i mësipërm i grupit të auditimit të KLSH ka të bëjë me analizimin dhe vlerësimin e treguesve të ndryshëm të flotës së mjeteve të transportit rrugor në Shqipëri dhe marrjen e masave konkrete për rinovimin e saj me qëllim reduktimin e emetimeve nga mjetet e transportit rrugor.

Lidhur me këtë rekomandim, MIE ka dërguar disa komente dhe shpjegime me shkresën nr. 5760/2 datë 03.09.2024. Në këtë shkresë MIE thekson se “*analiza e gjendjes së flotës së mjeteve rrugore për rinovimin e saj nuk ka ndonjë referencë në kuadrin ligjor ekzistues të fushës së përgjegjësisë së MIE-s. MIE do të vlerësonte këtë analizë nëse do të kishte*

përcaktim ligjor në listën e akteve ligjore mbi të cilat rregullohet fusha e veprimtarisë së Ministrisë”. Përtej këtij konstatimi MIE ka dërguar bashkëngjitur kësaj shkrese një analizë mbi impaktin e VKM nr. 633/2018 në flotën e mjeteve në Republikën e Shqipërisë, dhe ky ka qenë qëllimi i këtij rekomandimi, pra të realizohen analiza të tilla sa më të detajuara me qëllim që t’i shërbejnë përmirësimit të flotës së mjeteve rrugore. Për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, i zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Në vendin tonë nuk ka të dhëna të sakta e të përditësuara ndër vite mbi numrin e stacioneve të karikimit të mjeteve rrugore elektrike. Kjo situatë nuk lejon vlerësimin e gjendjes aktuale në vendin tonë mbi nevojat për instalimin e këtyre stacioneve.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa për të bashkëpunuar më të gjitha institucionet e përfshira në procesin e instalimit të stacioneve të karikimit të mjeteve elektrike për të garantuar publikimin e të dhënave të sakta e të përditësuara mbi këto stacione.

Dhjetor 2023

Përgjigje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Në lidhje me stacionet e mbushjes me energji elektrike të mjeteve, Agjencia për Eficiencën e Energjisë kreu një studim për vendosjen e një rrjeti të pikave të mbushjes me energji në territorin e vendit, bazuar në flotën e mjeteve elektrike dhe të një parashikimi të ardhshëm 3 vjeçar. Kjo Agjenci ka mundur instalimin e pesë pikave të mbushjes në Tiranë, dhe një në Shkodër. Gjatë këtij viti do të vendosen dhe 8-9 pika të tjera në pika të kalimit kufitar dhe qytete bregdetare. Janë rreth 70 pika të instaluara deri me tani në territorin e Shqipërisë.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Ky rekomandim konsiston në publikimin e të dhënave të sakta e të përditësuara mbi numrin dhe shpërndarjen e stacioneve të mbushjes me energji elektrike të mjeteve rrugore dhe jo thjesht në përgjigje se sa stacione janë ndërtuar apo sa do të ndërtohen në të ardhmen. Në shkresën nr. 5760/2 datë 03.09.2024, MIE nuk ka shfaqur ndonjë mos dakordësi lidhur me konkludimin e grupit të auditimit mbi këtë rekomandim, por ka bërë me dije se për zbatimin e këtij rekomandimi do të angazhohet Agjencia e Eficiencës së Energjisë.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, pa zbatuar.

1.2 Nënpyetja: A janë siguruar të dhëna të besueshme dhe mjaftueshme për vlerësimin e gjendjes së cilësisë së ajrit?

1. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka siguruar mbulimin kohor të mjaftueshëm për monitorimin e cilësisë së ajrit. Të dhënat e publikuara në Raportet e Gjendjes në Mjedis për vitet 2019-2021 konfirmojnë këtë mangësi. Në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit kërkohet që monitorimi i cilësisë së ajrit të kryhet për 90 % të vitit.

1.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa të kryejë pa ndërprerje shërbimin e mirëmbajtjes dhe kalibrimit të stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Dhjetor 2023

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Kontrata për monitorimin e cilësisë së ajrit për viti 2023 është lidhur për periudhën Maj 2023 - Maj 2024. Kjo është bërë për të shmangur vonesat në lidhjen e kontratave të monitorimit për shkak të mosqeljes së thesarit.

Gjithashtu AKM ka vijuar korespondencën shkresore si më poshtë vijon:

1. Shkresa me Nr. 1500/1 Prot., datë 16.02.2024 me lende “Informacion mbi stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban” (MTM ka kthyer përgjigje me anë të shkresës Nr. 1371/1 Prot., datë 01.03.2024 me lende “Kthim Përgjigje”)
2. Shkresa me Nr. 2344 Prot., datë 23.02.2024 me lende “Kërkesë për fonde investimesh për artikullin 230 dhe 231” (këtu është përfshirë kërkesa për blerjen e 10-pajisjeve portabel për matjen e nivelit të shkarkimeve në ajër”)
3. Shkresa me Nr. 2344/1 Prot., datë 29.04.2024 me lende “Kërkesë për kryerjen e procedurës së prokurimit”
4. MEMO me Nr. 6199 Prot., datë 10.06.2024 me lende “Informacion lidhur me monitorimin e cilësisë së ajrit urban”

Statusi i rekomandimit: I pranuar, në proces zbatimi.

2. Gjetje nga auditimi: Aktualisht Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka në administrim 7 stacione automatike të monitorimit të cilësisë së ajrit (njëri prej tyre mobile). Ky numër stacionesh nuk është i mjaftueshëm nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për të siguruar të dhëna përfaqësuese për cilësinë e ajrit në vendin tonë. Megjithatë, AKM ka kërkuar blerjen e 6 stacioneve automatike të reja për të zgjeruar rrjetin e monitorimit të cilësisë së ajrit. Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ende nuk është vlerësuar marrja e masave për blerjen e këtyre 6 stacioneve të reja.

3. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit për periudhën objekt auditimi nuk ka realizuar plotësisht shërbimin e mirëmbajtjes dhe kalibrimit të stacioneve të monitorimit në rang vendi. Kjo situatë ka ardhur si rrjedhojë e mangësive në planifikimin dhe realizimin e procedurave të kontraktimit të shërbimit të mirëmbajtjes së këtyre stacioneve. Konkretisht, për vitin 2019 dhe 2022 shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit nuk është realizuar, ndërsa për vitin 2020 shërbimi i mirëmbajtjes është realizuar për 109 ditë kalendarike dhe për vitin 2021 për 214 ditë kalendarike. Mungesa e shërbimit të mirëmbajtjes ka ndikuar në gjendjen e stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe mungesën e të dhënave për qytete të caktuara në periudha të ndryshme.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit t’i sigurojë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit fondet e nevojshme për shtimin e numrit të stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Brenda vitit 2024

Përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nëpërmjet shkresës me Nr.2742/1 datë 28.04.2023 ka paraqitur kërkesën pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për t’u përfshirë si shtesë në Planin Buxhetor Afat-mesëm për blerjen e 3 stacioneve për monitorimin e cilësisë së Ajrit. Gjithashtu, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me suport të projektit SANE 27, faza e parë, ka hartuar një projekt fishë “*Improving the air quality and emission control system in Albania*” që përfshin edhe investim në stacione monitorimi nëpërmjet asistencës së huaj (fondet IPAIII)/ Masa: 1.Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike, do të përcjellë shkresën pranë Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të MTM-së për njohjen me rekomandimin e lënë dhe marrjen e masave për adresimin e rekomandimit dhe ripërcjelljen e kërkesës pranë MFE-së; 2. Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike do të adresojë tek titullarët e institucionit rekomandimin e lënë, për të nxitur përsheptimin e miratimit dhe sigurimin e financimit të projekt-fishës nga donatorë të huaj.

Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike përgatiti memon me nr. 3896/1 prot, datë 17.07.2024 “Përcillet informacion lidhur me problematikën e mosfunksionimit të stacioneve të ajrit të përcjellë nga AKM nëpërmjet MEMO-s me nr. 3896 prot, datë 12.06.2024”.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka dorëzuar në JICA aplikimin “*Capacity Development Project for Air Pollution Control in the Republic of Albania*” (bashkëlidhur), nëpërmjet të cilit është kërkuar asistencë teknike nga Qeveria Japoneze mbi përmbushjen e masave prioritare që lidhen me përmirësimin e cilësisë së ajrit:

1. Hartimi i një strategjie kombëtare për cilësinë e ajrit për vitin 2024 dhe më tej, duke marrë parasysh ndryshimet klimatike, shëndetin publik dhe aspektet e biodiversitetit;
2. Rritja e zbatimit dhe forcimi i legjislacionit kombëtar për cilësinë e ajrit
3. Reformimi i sektorëve me ndikim të rëndësishëm në cilësinë e ajrit
4. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe të palëve të interesuara për rëndësinë dhe efektet e cilësisë së ajrit
5. Reduktimi vjetor i substancave të importuara që shkatërrojnë ozonin për të mbrojtur shtresën e ozonit.

Gjithashtu, projekt aplikimi është përcjellë nga MTM në datë 20 gusht edhe pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)

Lidhur me këtë rekomandim, MTM me anë të shkresës nr 5724/2 prot. datë 18.10.2024 ka komentuar si më poshtë:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në cilësinë e institucionit lider për Kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, me mbështetjen e Projektit SANE 27, faza II, zhvilloi në datë 23 Shtator 2024, një vizitë studimore në Ministrinë përgjegjëse për Mjedisin, Shkup, Maqedonia e Veriut. Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i eksperiencave dhe forcimi i kapaciteteve institucionale në MTM, AKM, MIE, lidhur me zbatimin e acquis të BE-së për fushën e cilësisë së ajrit të mjedisit, organizimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i rrjetit të monitorimit të ajrit, burimet e mundshme të financimit, masat që ndërmerren nga institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe reduktimin e ndotësve të ajrit nga sektorë përgjegjës etj.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të vijojë bashkëpunimin me Programin rajonal “Partneriteti për Përmirësimin e Cilësisë së Ajrit në Ballkanin Perëndimor”, i cili zbatohet nga Agjencia Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit (SWEPA) dhe Instituti Hidrologjik (SMHI), në partneritet me UNICEF. Nga zbatimi i komponentit 3 “Air quality data portal”, do të përfitojë edhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Agjencia Kombëtare e mjedisit ka kërkuar në PBA 2024-2026 në fazën e parë, të dytë dhe të tretë shtimin e stacioneve të reja për monitorimin e cilësisë së ajrit. Gjithashtu AKM ka plotësuar në Janar të vitit 2023 Project Identification Form për blerjen e 10 stacioneve të ajrit sipas Kapitullit V, tabela 8 “Kostot që lidhen me përmirësimin e cilësisë së ajrit”, të VKM-së Nr. 412 datë 19.06.2019 “Për Miratimin e Planit Kombëtar të Cilësisë së Ajrit”. (dërguar me email në Drejtorinë e Integritimit dhe Projekteve në MTM). AKM me anë të shkresës Nr. 4866 prot., datë 29.04.2024 ka dërguar projekt Buxhetin Afat Mesëm 2025-2027, faza strategjike në të cilën janë kërkuar fonde për shtimin e stacioneve. Sa më sipër, si dhe duke pasur në konsideratë edhe iniciativat më të fundit të ndërmarrë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të përshkruara më sipër ky rekomandim do të konsiderohet në proces.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, në proces zbatimi.

4. Gjetje nga auditimi: Duke analizuar me kujdes Raportet e Gjendjes në Mjedis për vitet 2019, 2020 dhe 2021 vërehet se nuk ka një uniformitet në përmbajtjen e tyre sa i përket procesit të monitorimit të cilësisë së ajrit. Ajo që bie në sy është se monitorimi i cilësisë së ajrit zhvillohet çdo vit në qytete të ndryshme, për elementë të ndryshëm dhe për periudha të ndryshme. Rasti më konkret është edhe mungesa e monitorimit të cilësisë së ajrit për vitin 2021 në qytetin e Tiranës. Kjo situatë nuk lejon zhvillimin e analizave më të detajuara të ecures së nivelit të cilësisë së ajrit në këto qytete.

5. Gjetje nga auditimi: Në inventarët kombëtarë të shkarkimeve të ndotësve në ajër të hartuara nga AKM nuk ka të dhëna mbi shkarkimet që vijnë nga sektori i transportit rrugor. Mungesa e të dhënave mbi shkarkimet e sektorit të transportit rrugor nuk lejon vlerësimin e kontributit të shkarkimeve të transportit rrugor në totalin e shkarkimeve për vendin tonë.

3.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa të sigurojë të dhëna të përditësuara të cilësisë së ajrit në qytetet ku janë të instaluar stacionet e monitorimit të ajrit si dhe të përditësojë inventarët e shkarkimeve me të dhëna nga sektori i transportit rrugor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Përgjatë periudhës që ka qenë në zbatim kontrata për monitorimin e cilësisë së ajrit për vitin 2023, për periudhën Maj 2023 - Maj 2024 përditësimi i të dhënave është bërë çdo muaj dhe janë raportuar në MTM, javën e parë të çdo muaji në kuadër të Raportimit mujor për Kartën e Performancës.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit me anë të shkresës me Nr. 6933 Prot., me datë 30.08.2023 drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me lëndë “Kërkesë për marrjen e masave për hartimin e inventarit të shkarkimeve në ajër për vitin 2022 si dhe rishikimin e inventarëve të viteve të mëparshme.” Ministria e Mjedisit dhe Turizmit me anë të emailit me datë 08.09.2023 i ka kërkuar Urban Research Institute ndihmë për hartimin e inventarit. AKM në bashkëpunim me URI ka hartuar Inventarin e emetimeve në Ajër për vitin 2022 së bashku me raportin narativ të cilët janë raportuar në Agjencinë Europiane të Mjedisit brenda afateve të caktuara.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, i zbatuar.

Pyetja 2. A kanë planifikuar dhe zbatuar institucionet përgjegjëse masat e duhura lidhur me mjetet e transportit rrugor dhe ndikimin e tyre në cilësinë e ajrit?

2.1 Nënpyetja A janë planifikuar politika, objektiva dhe aktivitete të përshtatshme në sektorin e transportit rrugor për të përmirësuar cilësinë e ajrit?

2. Gjetje nga auditimi: Plani Kombëtar i Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit si dhe dokumentet e tjerë strategjikë në sektorin e transportit rrugor parashikojnë në parim disa masa lidhur me përmirësimin e flotës së mjeteve rrugore dhe cilësisë së ajrit. Megjithatë, në këto dokumente këto masa nuk shoqërohen me objektiva, aktivitete dhe targete të matshme e të arritshme. Pra, pavarësisht se në këto dokumente citohen disa masa si për shembull “Reduktimi i shkarkimeve të automjeteve” ose “shtimi i mjeteve rrugore me karburant alternativ”, nuk specifikohet konkretisht se sa duhet të reduktohet niveli i shkarkimeve nga automjetet dhe sa duhet të shtohen mjetet rrugore me karburant alternativ. Mungesa e këtyre përcaktimeve nuk lejon vlerësimin nëse këto masa janë të mjaftueshme për të ndikuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

3. Gjetje nga auditimi: Plani i Transportit të Qëndrueshëm, i hartuar bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare të përshtatura me realitetin shqiptar, nuk është miratuar zyrtarisht. Gjithashtu masat dhe zgjidhjet konkrete për të përmirësuar sektorin e transportit rrugor me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit nuk janë integruar plotësisht në dokumentet e tjera strategjike të qeverisë. Kjo situatë nuk krijon kushtet për ndryshim lidhur me rinovimin e flotës së mjeteve rrugore dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të përditësojnë dokumentet e tyre strategjike duke përcaktuar objektiva, masa dhe aktivitete konkrete, të matshme e të arritshme veçanërisht sa i përket reduktimit të shkarkimeve nga automjetet, shtimin e numrit të mjeteve rrugore me karburant alternativ etj.

Qershor 2024

Përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Strategjia Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit miratuar me VKM nr. 594, datë 10.9.2014, ka një shtrirje kohore 10 vjet nga miratimi i saj (2014-2024). Sa i përket Planit Kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit, miratuar me VKM nr. 412, datë 19.6.2019, është një dokument 5-vjeçar i cili identifikon masa afatshkurtra dhe afatmesme (deri në 2026). Për sa më sipër MTM ka pasur në vëmendje rishikimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të ambientit dhe më pas për rishikimin e PKMCA-së. Periudha e nevojshme për të gjithë procesin nga përgatitja e dokumenteve të përditësuar deri në miratimin zyrtar mund të kërkojë të shtyhet më tej afatit të përcaktuar nga e KLSH (si shpjeguar në observacionet e përcjella me Nr. Prot. 3741/3 datë 18.07.2023).

Gjate periudhës 2023-2024 përfaqësues të MTM kanë adresuar dhe diskutuar disa here nevojën për mbështetje për Rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Ajrit dhe Planit Kombëtar të Cilësisë së Ajrit. Në këtë kuadër Rishikimi i Planit Kombëtar të Cilësisë së Ajrit është parashikuar si një nga objektivat strategjike të Strategjisë S3 (Strategjia e Specializimit Inteligjent).

-Në takimin e mbajtur në datë 08.07.2024, midis përfaqësuesve të MTE, AKM dhe Projektit SANE 27, Faza II, u dakordësua se: projekti SANE 27, do të mbështesë institucionet tona lidhur me rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit.

-8 Bashki (Kukës, Durrës, Krujë, Vlorë, Elbasan, Përmet, Gjirokastër, Fier) kanë finalizuar hartimin e planeve lokale të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike ku kanë parashikuar edhe shtimin e mjeteve elektrike në planin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike masë që ndihmon në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe në përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Konkretisht në këto plane parashikohen:

1. Investimi në autobusë elektrike për të reduktuar varësinë nga lëndët djegëse fosile dhe për të ulur ndotjen e ajrit.

2. Nxitja e përdorimit të makinave elektrike

3. Ndërtimi i një rrjeti të gjerë të stacioneve të karikimit për të mbështetur dhe inkurajuar përdorimin e automjeteve elektrike.

-Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në varësi të MIE-s, ka iniciuar procesin për ndryshimin e VKM-së nr. 633, datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gazte dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, të ndryshuar.

Në grupin nder institucional të punës të ngritur për këtë qëllim, është edhe një përfaqësuese nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, institucion i cili është në varësi të MTM-se. Në datën 24 Maj 2024, ka organizuar takimin ndër-institucional mbi diskutimet për draft-propozimet për ndryshim në VKM-në nr. 633, datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga

shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gazte dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, të ndryshuar. Në këtë takim ishte e pranishme edhe përfaqësuesja e AKM-së, e cila gjate takimit theksoi rëndësinë dhe impaktin e madh që sektori i transportit kontribuon në shkarkimet totale në ajër të ndotësve të gaztë.

-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të mbështetet së shpejti nga projekti SANE 27, faza e dytë, për të rishikuar dokumentin e strategjisë kombëtare të cilësisë së ajrit dhe planin kombëtar të veprimit.

Lidhur me këtë rekomandim, MTM me anë të shkresës nr 5724/2 prot. datë 18.10.2024 ka komentuar se e ka përcjellë këtë rekomandim pranë Projektit SANE 27, faza II, për njohje dhe mbajtje në vëmendje gjatë procesit të hartimi të dokumenteve të rinj për cilësinë e ajrit.

Përgjigje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Konsiderojmë që, iniciativat ligjore të parashikuara sipas PKIE 2024-2026 dhe ato të DPSHTRR-së (rimbursimi i tarifave të regjistrimit për herë të parë të mjeteve elektrike dhe hibride elektrike, tarifat e kontrollit fizik të lejes së qarkullimit dhe targave standard) janë masa dhe aktivitete konkrete përsa i përket reduktimit të shkarkimeve në ajër nga mjetet rrugore.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Pavarësisht përgjigjes zyrtare (email dt. 25.07.2024 dhe 06.09.2024) nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe shkresës 5724/2 datë 18.10.2024, cituar më sipër, nuk evidentohet asnjë përditësim i dokumenteve strategjike duke përcaktuar objektiva, masa dhe aktivitete konkrete, të matshme e të arritshme veçanërisht sa i përket reduktimit të shkarkimeve nga automjetet, shtimit të numrit të mjeteve rrugore me karburant alternativ etj. Evidentohet gjithashtu përpjekja e MTM-së për të kërkuar ndihmë e asistencë partnerëve ndërkombëtarë nëpërmjet projektit SANE 27. Nga ana tjetër, MIE sjell përsëri në vëmendje (me anë të shkresës nr. 5760/2 datë 03.09.2024) që në PKIE 2024-2026 është parashikuar të miratohet një projektvendim i Këshillit të Ministrave brenda vitit 2024 që përafron direktivën Evropiane 2009/33/EC i cili do t'i hapë rrugën edhe promovimit të mjeteve rrugore ekologjike. Megjithatë, deri më sot ende nuk kemi zbatim të plotë të rekomandimit të mësipërm ndaj edhe ai do të konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, pjesërisht i zbatuar.

2.2 Nënpyetja: A janë zbatuar politikat e hartuara dhe miratuara në sektorin e transportit rrugor dhe cilësisë së ajrit?

1. Gjetje nga auditimi: Nga zbatimi i VKM nr. 633 pritej që numri i mjeteve rrugore M1 me kategori mjedisore Euro 3, të ulej ose të qëndronte i pandryshuar pas vitit 2018. Nga auditimi u konstatua se numri i mjeteve rrugore M1 të kategorisë mjedisore Euro 3 për periudhën 2019-2022 ka ardhur në rritje respektivisht me 8,661 në 2019 më shumë se në vitin 2018 dhe 14,291 në 2020 më shumë se në vitin 2018. Për vitin 2021 dhe 2022 pavarësisht se numri i mjeteve rrugore M1 me kategorinë mjedisore Euro 3 është ulur krahasuar me 2019 dhe 2020, ai përsëri ngelet më i lartë se niveli i vitit 2018. Kjo situatë tregon se të dhënat e vendosura në dispozicion nuk janë plotësisht të sakta dhe si rezultat nuk dihet me saktësi ndikimi që VKM nr. 633 ka pasur në përmirësimin dhe rinovimin e flotës së mjeteve rrugore.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të kryejë një analizë të detajuar për të saktësuar të dhënat mbi kategorizimin mjedisor për të gjithë mjetet rrugore në vendin tonë për vlerësimin e ndikimit të VKM nr. 633.

Mars 2024

Përgjigje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

MIE bashkëngjitur shkresës me nr. 5760/2 prot. datë 03.09.2024 ka sjellë një raport mbi ndikimin e VKM nr. 633/2018 në flotën e mjeteve rrugore në Shqipëri.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, i zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar Programin Kombëtar të pakësimeve të shkarkimeve në ajër. Hartimi i Programit Kombëtar të pakësimeve të shkarkimeve në ajër është një detyrim ligjor që ngarkon Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për hartimin dhe propozimin e tij për miratim pranë Këshillit të Ministrave. Mungesa e Programit nuk ka lejuar vendosjen e synimeve për pakësimin e shkarkimeve në ajër.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për hartimin e Programit Kombëtar të pakësimit të shkarkimeve në ajër dhe t’ja përcjellë për miratim Këshillit të Ministrave.

Dhjetor 2023

Përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Nga diskutimet e zhvilluara me përfaqësuesit e projektit SANE 27 dhe përfaqësuesve të AKM-se e MTM (Takim i mbajtur me date 08.07.2024) vlerësohet se ky rekomandim të adresohet pas përmbushjes së rekomandimit nr.10. me poshtë. Ndërkohë, Drejtoria Ndryshimeve Klimatike është duke ndjekur progresin e legjislacionit të BE-se në fushën e cilësisë së ajrit”.

Lidhur me këtë rekomandim, MTM ka bërë sërish një koment me anë të shkresës nr 5724/2 prot. datë 18.10.2024 duke cituar se për zbatimin e tij po bashkëpunon me Projektin “EU4Green” dhe institutin IIASA për të parë mundësinë e mbështetjes për përmbushjen e detyrimeve që kërkohen nga VKM 162/2020.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Siç jemi shprehur edhe në Raportin Përfundimtar të auditimit, Programi i parë kombëtar për pakësimin e shkarkimeve në ajër duhej të përgatitej deri më 1 prill 2022, e përcaktuar kjo në VKM nr. 162 datë 19.2.2020. Qëllimi jonë në këtë raport mbi zbatimin e rekomandimeve është të shikojmë nëse këto rekomandime janë zbatuar sipas afateve të përcaktuara apo jo. Nga përgjigja e MTM-së vërehet qartë se për rekomandimin e mësipërm, Ministria ende është duke bërë përpjekje që të sigurojë mbështetje për zbatimin e tij. Në këtë situatë, ajo që nuk ndryshon është se rekomandimi mbetet i pa zbatuar, për aq kohë sa nuk është hartuar një Program Kombëtar të pakësimit të shkarkimeve në ajër.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, i pa zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk kanë përcaktuar angazhimet kombëtare të pakësimit të shkarkimeve, në aneksin II, të VKM nr. 162 datë 19.2.2020. Afati për përcaktimin e tyre ka qenë data 30

dhjetor 2020. Mos miratimi i tyre ka ardhur si rezultat i mos kryerjes së një analize të plotë të legjislacioneve të transpozuar dhe miratuara në vend gjatë viteve të fundit të cilat kanë impakt direkt ose indirekt në shkarkimet në ajër, mos rishikimit dhe saktësimin të llogaritjeve të shkarkimeve në ajër për vendin tonë si dhe mungesës së kapaciteteve institucionale.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të përcaktojnë angazhimet kombëtare të pakësimin të shkarkimeve, në Aneksin II, të VKM nr. 162 datë 19.2.2020

Dhjetor 2023

Përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Duke mbajtur në vëmendje se llogaritja dhe përcaktimi në vlera konkrete dhe të sakta të angazhimeve kombëtare që Republika e Shqipërisë duhet të ndërmarrë për reduktimin e shkarkimeve në ajër në zbatim të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare është një proces kompleks dhe kërkon një mbështetje teknike të dedikuar për këtë fushë e cila aktualisht mungon. Mbështetur në sa më sipër, duhet të merret në konsideratë se përmbushja e këtij rekomandimi do të kërkojë një periudhë më të gjatë se afati i përcaktuar nga KLSH (si shpjeguar në observacionet e përcjella me Nr. Prot. 3741/3 datë 18.07.2023); -Masat e marra Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike përgatiti për titullarët e institucionit MEMO-n me nr. 6492 prot, datë 31.10.2023 “Përcillet informacioni mbi mbështetjen që do ti ofrohet Shqipërisë në kuadër të projektit të BE-së “EU4Green”, lidhur me detyrimet kombëtare për reduktimin e shkarkimeve të treguesve për ndotjen e ajrit.”

Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike, ka ndjekur online aktivitetet e organizuara në datat 18 Dhjetor 2023 dhe 19 Prill 2024, në kuadër të këtij projekti ku në fokus ndër të tjera ishin edhe diskutimet për angazhimet kombëtare që duhet të ndërmerren për reduktimin e shkarkimeve të ndotësve të ajrit 2020-2029 dhe për 2030 e me tej, prezantimi i projeksioneve për shkarkimet në ajër për Shqipërinë për të ardhmen. etj. Bashkëpunimi midis MTM, AKM dhe projektit EU4Green është në proces. Nëpërmjet e-mailit të dërguar nga AKM, këtij projekti i është kërkuar të shikohet mundësia që të na mbështesin në llogaritjen e tavaneve kombëtare që kërkohen sipas VKM. 162/2020.

Lidhur me këtë rekomandim, MTM ka bërë sërish një koment me anë të shkresës nr 5724/2 prot. datë 18.10.2024 duke cituar se për zbatimin e tij po bashkëpunon me Projektin “EU4Green” dhe institutin IIASA për të parë mundësinë e mbështetjes për përmbushjen e detyrimeve që kërkohen nga VKM 162/2020.

Përgjigje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Me shkresën nr. 5760/2 datë 03.09.2024 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë thekson se “Bazuar në nenin 24 të ligjit nr. 90/2012 “Për riorganizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, iniciativat e bashkëpunimit apo grupet e punës ndërmerren nga institucioni që e ka kryesisht detyrën. Duke qenë se, nuk kemi pasur kërkesë për bashkëpunim deri më tani nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MIE është e gatshme për bashkëpunim në mënyrë të rregullt sapo të paraqitet një kërkesë e tillë”.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Së pari duhet të kuptohet qartë që rekomandimet në përgjithësi dhe ky në veçanti i janë adresuar Ministrisë së Turizmit dhe jo Drejtorisë së Ndryshimeve Klimatike në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Së dyti, duke qenë se Projekt Raporti ka ardhur me shkresën përcjellëse nr. 1181/6 datë 08.06.2023, observacionet e përcjella nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me nr. prot. 3741/3 datë 18.07.2023 kanë qenë jashtë afatit⁸, ndaj edhe ato nuk janë

⁸ Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 29 pika 2.

marrë në konsideratë për shtyrjen e afateve. Së treti, në logjikën e qëndrimit të grupit të auditimit njësoj si në rastin e rekomandimit më sipër, MTM edhe në shkresën nr. 5724 prot. datë 18.10.2024 nuk sjell ndonjë fakt, dokument apo evidencë mbi zbatimin e rekomandimit, por sjell në vëmendje që për këto rekomandime po kërkon asistencë nga partnerët ndërkombëtare me të cilët por realizon apo po merr pjesë në projekte të ndryshme. Sigurisht, ne nuk jemi kundra kërkesave të tilla, por ajo që ka rëndësi dhe ajo që ne adresojmë është se sa është zbatuar rekomandimi që ne kemi lënë në raportin përfundimtar me temë “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”.

Sa i përket përgjigjes së MIE-s, sqarojmë se baza ligjore që ju citoni nuk gjen zbatim në rekomandimin e grupit të auditimit. Grupi i auditimit është bazuar në VKM nr 162, datë 19.2.2020 “Për Rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër”, Kreu III pika 2, ku citohet se “Angazhimet kombëtare të pakësimit të shkarkimeve, në aneksin II, të këtij vendimi, propozohen nga ministri përgjegjës për mjedisin, ministri përgjegjës për energjinë dhe transportin”. Sipas këtij përkufizimi asnjë ministri nuk ka rol kryesor dhe nuk ndërmerr iniciativën për të ftuar institucione të tjera në bashkëpunim. Për të gjitha sa më sipër, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, i pa zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Procesi i monitorimit dhe raportimit të zbatimit të akteve ligjore dhe nën ligjore për cilësinë e ajrit ka pasur mangësi dhe problematika si më poshtë:

- Ministria e Turizimit dhe Mjedisit nuk ka hartuar raportin mbi zbatimin e ligjit për cilësinë e ajrit të mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka hartuar raportin informues të inventarit të shkarkimeve si dhe projeksionet e shkarkimeve në ajër;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk kanë monitoruar dhe nuk kanë raportuar mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë periodikisht raportet e zbatimit të ligjit për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit.

Në vazhdimësi

Përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të përgatis Draft-Urdhrin e Ministrit sipas Pikës 5, Neni 19 i Ligjit nr.162/2014 " Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", i cili do të miratojë formatin për përgatitjen e raportit për zbatimin e ligjit, së bashku me informacionin që duhet të përmbajë ky raport; Ky Draft Urdhër është ne proces përgatitje.

Masat e marra-Ne takimin e mbajtur ne date 08.07.2024, midis përfaqësuesve te MTE, AKM dhe Projektit SANE 27, Faza II, u dakordësua se: projekti SANE 27, do te mbështesë institucionet tona lidhur me rishikimin e Strategjisë dhe Planit te Veprimit për Cilësinë e Ajrit. Paralelisht me rishikimin e planit kombëtar te cilësisë se ajrit do te përgatitet edhe raporti i zbatimit te planit 2019-2024.

Me anë të email-it më datë 06.09.2024, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka vënë në dijeni grupin e auditimit të KLSH-së se ajo do të mbështetet së shpejti nga projekti SANE 27, faza e dytë, për të rishikuar dokumentin e strategjisë kombëtare të cilësisë së ajrit dhe planin kombëtar të veprimit. Si fazë e parë e këtij procesi, është planifikuar të përgatiten raportet e zbatimit të ligjit për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe Planit Kombëtar të menaxhimit të cilësisë së Ajrit.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Rekomandimi krahas monitorimit të MTM mbi zbatimin e PKMCA, konstiston në raportimin e MTM-së mbi zbatimin e ligjit për cilësinë e ajrit i cili pavarësisht se është miratuar në 2014 ka hyrë në fuqi në 2017. Formatimi mbi të cilën MTM do të duhet të raportojë mbi zbatimin e ligjit të cilësisë së ajrit do të duhet të miratohej 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pavarësisht këtyre, ka kaluar më shumë se 1 vit që nga dërgimi i Raportit Përfundimtar të auditimit dhe ende nuk është bërë as raportimi mbi zbatimin e ligjit, as monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Cilësisë së Ajrit dhe minimalisht as miratimi i formatit mbi të cilin do të bëhet raportimi i zbatimit të ligjit të cilësisë së ajrit. Edhe në emailin e datës 06.09.2024, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit sjell përsëri në vëmendje që ky rekomandim do të realizohet pasi të fillojë projekti SANE 27, pra deri më tani ai nuk është realizuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, i pa zbatuar.

4.2 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të hartojë periodikisht raportin mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit, raportin informues të inventarit të shkarkimeve si dhe projeksionet e shkarkimeve në ajër.

Në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

AKM ka dërguar në KLSH shkresën me nr. 9528/1 prot. datë 08.10.2024 në përgjigje të shkresës së KLSH me nr. 914/15 prot. datë 11.09.2024 me lëndë “Dërgohet Projekt Raporti i Zbatimit të Rekomandimeve për Auditimin e Performancës me temë Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”. AKM ka konfirmuar njohjen me Projekt Raportin dhe ka komentuar në lidhje me Rekomandimin e mësipërm nr. 4.2. Konkretisht AKM ka theksuar në komentet e saj se lidhur me elementin e parë “Hartimi i Raportit mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit” të rekomandimit nr. 4.2 i është drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresën me nr. 9348 prot. datë 06.09.2024 me lëndë “Kërkesë për ndarjen e përgjegjësisë mbi zbatimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së ajrit” ku deri tani nuk ka pasur asnjë përgjigje. Për elementin “Hartimi i raportit informues të inventarit të shkarkimeve”, AKM e ka përgatitur këtë raport si dhe e ka raportuar në Agjencinë Evropiane të Mjedisit. Për elementin e fundit “hartimi i projeksioneve të shkarkimeve në ajër”, AKM nuk ka hartuar projeksione të shkarkimeve në ajër për mungesë të kapaciteteve teknike.

Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Mjedisit me anë të shkresës me Nr. 6933 Prot., me date 30.08.2023 drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me lëndë “Kërkesë për marrjen e masave për hartimin e inventarit të shkarkimeve në ajër për vitin 2022 si dhe rishikimin e inventarëve të viteve të mëparshme.” Ministria e Mjedisit dhe Turizmit me anë të emailit me datë 08.09.2023 I ka kërkuar Urban Research Institute ndihmë për hartimin e inventarit. AKM në bashkëpunim me URI ka hartuar Inventarin e Emetimeve në Ajër për vitin 2022 sëbashku me raportin narrativ të cilët janë raportuar në Agjencinë Evropiane të Mjedisit brenda afateve të caktuara.

Gjithashtu AKM në bashkëpunim edhe me MTM ka kërkuar që të jetë pjesë në implementimin e fazës së dytë të projektit “Partnership for Improving Air Quality in the Western Balkans,” implemented by the Swedish Environmental Protection Agency (SwEPA) and the Swedish Meteorological and Hydrological Institute (SMHI), në partneritet me UNICEF Gusht 2024 - Dhjetor 2026 kryesisht në përdorimin e softwarit për përgatitjen e hartave (grided map). Ky projekt do të mundësojë edhe të dhëna për disa bashki për përgatitjen e planeve vendore për cilësinë e ajrit.

Projekti EU4GREEN, "Depollution of Air" po mbështetin institucionet tona për zbatimin e Axfordës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor në cilësinë e ajrit të ambientit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Ministrinë e linjës, po mbështeten për angazhimet që Republika e Shqipërisë duhet të marrë në kuadër të Direktivës Evropiane për Reduktimin e Emisioneve Kombëtare (Direktiva NEC 2016/2284/EC), Angazhimet që kanë të bëjnë me: Përmirësimin e Inventareve Kombëtare të Emetimeve në Ajër dhe Përgatitjen e Parashikimet deri në vitin 2030 dhe më tej si dhe në procesin për të bërë Laboratorin e AKM-së si Laborator Kombëtar të Referencës për cilësinë e ajrit. Në kuadër të Projektit EU4Green Albania është bërë si më poshtë:

Shqipëria ka bashkëpunuar me drejtuesit e projektit "Zhvillimi i angazhimeve për uljen e emetimeve të ndotësve në ajër – EU4Green", duke dërguar të gjithë informacionin e kërkuar. Rezultatet e projektit u prezantuan më 19 prill. Në kuadër të Paketës së Punës 1-8 të zbatimit të NRL-ve në WB6, Shqipëria ka marrë pjesë në seminare dhe ka përfunduar draft dokumentin "Planet e Zbatimit në Shqipëri", për akreditimin e laboratorit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si laborator referues për cilësinë e ajrit. (prill 2024)

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Duke marrë në konsideratë shkresën më të fundit të AKM-së ku ka sqaruar dhe ka dhënë komente për të tre elementët e rekomandimit nr. 4.2, grupi i auditimit ka rivlerësuar qëndrimin mbi këtë rekomandim. Siç jemi shprehur edhe në Projekt Raport, ky rekomandim parashtron tre elementë kryesorë të cilat janë:

- hartimi i raportit mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit,
- hartimi i raportit informues të inventarit të shkarkimeve;
- hartimi i projeksioneve të shkarkimeve në ajër.

Nga përgjigja e vet AKM-së me shkresën me nr. 9528/1 datë 08.10.2024 evidentohet qartë që ky rekomandim është zbatuar vetëm në drejtim të elementit të dytë të tij, ndaj edhe ai do të konsiderohet i zbatuar pjesërisht duke rikërkuar zbatimin e plotë të tij ose më saktë zbatimin e elementit të parë dhe të tretë të tij.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, pjesërisht i zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit janë propozuar disa programe subvencionimi për të krijuar lehtësira financiare për blerjen e mjeteve me nivel të ulët shkarkimi dhe heqjen nga përdorimi të automjeteve të prodhuara para vitit 1995 me një vlerë totale prej 35 milionë Euro dhe një numër të pritshëm përfituesish rreth 35,000 njerëz. Nga auditimi është konstatuar se nuk ka pasur alokim të fondeve me qëllim vënien në zbatim të këtyre skemave subvencionuese. Aktualisht në vendin tonë aplikohen:

- përjashtimi nga TVSH i automjeteve të reja vetëm elektrike që regjistrohen për herë të parë në Shqipëri;
- reduktimi i TVSH në 6 % për mjetet e transportit publik vetëm elektrike (nëntë plus një ose më shumë vende);
- rimbursimi i tarifës së regjistrimit (6500 lekë) për herë të parë për mjetet elektrike dhe "plug in" nga DPSHTRR.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të vlerësojnë fizibilitetin financiar të programeve të subvencionimit të parashikuara në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit dhe t'i drejtohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi alokimin e fondeve për subvencionimin këtyre programeve.

Mars 2024

Përgjigje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke qenë e gatshme për bashkëpunim, nuk ka pasur kërkesa bashkëpunimi deri më tani mbi subvencionimin e këtyre programeve, as nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit as dhe nga Ministria e Financave.

Për këtë rekomandim, krahas përgjigjes së mësipërme me email (26.08.2024), MIE me anë të shkresës me nr. 5760/2 datë 03.09.2024 ka cituar se “bazuar në nenin 24 të ligjit nr. 90/2012 “Për riorganizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, iniciativat e bashkëpunimit apo grupet e punës ndërmerren nga institucioni që e ka kryesisht detyrën. Dhënia e ndihmës shtetërore është në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Financave.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Rekomandimi i mësipërm konsiston në bashkëpunimin e dy ministrive përgjegjëse për temën objekt auditimi dhe konkretisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Pra, me qëllim zbatimin e masave dhe subvencioneve të parashikuara në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit dhe të cituar edhe në gjetjen e mësipërme nr. 5, duhet që këto dy ministri t'i drejtohen Ministrisë së Financave. Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, i pa zbatuar.

Nënpyetja 2.3 A kanë bashkëpunuar institucionet përgjegjëse për marrjen e masave sa i përket ndikimit të transportit rrugor në cilësinë e ajrit?

1. Gjetje nga auditimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duhet të bashkëpunojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të garantuar financim nga fondet ndërkombëtare në mbështetje të promovimit të mjeteve rrugore ekologjike. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk kanë bashkëpunuar me njëra tjetrën dhe nuk i janë drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim përthithjen e fondeve nga financimet ndërkombëtare për të nxitur përdorimin e mjeteve rrugore ekologjike. Mungesa e iniciativave të përbashkëta midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ka sjellë mos përthithjen e fondeve të tilla dhe për rrjedhojë mos mbështetjen financiare të objektivave dhe masave të parashikuara në dokumentet politike respektive.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të bashkëpunojnë me njëra tjetrën dhe t'i drejtohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të siguruar financimin nga fondet ndërkombëtare për promovimin e shkarkimeve zero nga mjetet rrugore, shkarkime të ulëta, automjete me karburant të pastër, alternativ, etj.

Në vazhdimësi

Përgjigje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Në emailin e datës 26.08.2024, MIE është shprehur se ky rekomandim është në vazhdimësi. Deri më tani nga ana e Ministrisë nuk janë identifikuar projekte të kësaj natyre për të paraqitur më pas dhe kërkesa financimi. Kjo dhe për faktin që, siç është shprehur në përgjigjet e mësipërme legjislacioni Evropian për promovimin e mjeteve të pastra dhe me karburante alternative është në fazat e para të transpozimit në legjislacionin shqiptar. Nga ana tjetër, nuk ka pasur kërkesa bashkëpunimi mbi këtë rekomandim as nga Ministrinë e tjera të përmendura në të.

Në shkresën nr 5760/2 datë 03.09.2024 MIE përsërit edhe një herë nenin 24 të ligjit nr. 90/2012 si dhe referencën tonë ligjore VKM nr. 162 datë 19.02.2023, kreun VI, pika 2, germa ç.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Rikujtojmë se ky rekomandim bazohet në VKM nr. 162, datë 19.02.2020 “Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër”, Kreu VI, pika 2, germa ç. Bashkëpunimi nuk duhet të kuptohet si një proces i cili duhet të fillohet me patjetër nga një institucion i caktuar, ndaj, pavarësisht se as Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe as Ministria e Financave nuk i janë drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, kjo nuk do të thotë se kjo e fundit nuk duhet të inicionte një bashkëpunim të tillë.

Në shkresën nr. 5760/2 datë 03.09.2024 MIE përsërit edhe një herë nenin 24 të ligjit nr. 90/2012 si dhe referencën tonë ligjore VKM nr. 162 datë 19.02.2023, kreun VI, pika 2, germa ç. Së pari, rikujtojmë se ky ka qenë një auditim performance dhe jo një auditim përputhshmërie i cili fokus kryesor të tij ka zbatimin e legjislacionit. Siç jemi shprehur edhe përgjatë ecurisë së auditimit, por edhe standardeve ndërkombëtare të auditimit të performancës, ky lloj auditimi shkon përtej se sa thjesht zbatimin të legjislacionit. Në rastin konkret, sigurisht nëse do të flasim thjesht për zbatimin e ligjit, është Ministria e Financave e cila sipas VKM nr. 162, kreu VI, pika 2 “ç” duhet të fillojë bashkëpunimin. Pavarësisht kësaj, duke qenë se Ministria e Financave nuk ka qenë objekt auditimi dhe duke qenë se e gjithë fryma e kuadrit ligjor e rregullator për përmirësimin e flotës së mjeteve rrugore është përgjegjësi e MIE, ndaj edhe ne këtë rekomandim ja kemi adresuar MIE si dhe MTM.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, i pa zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duhet të propozojë pranë Kryeministrisë ngritjen e Komisionit Kombëtar për Ajër të Pastër, i cili duhet të ketë përfaqësues nga ministria dhe strukturat e saj të varësisë, ministrinë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore, përfaqësues të industrisë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të komunitetit shkencor. Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër nuk është ngritur sepse nuk është propozuar për miratim në Kryeministri nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Mos ngritja dhe mos funksionimi i këtij komisioni nuk ka lehtësuar bashkëpunimin ndërinstytucional për koordinimin e legjislacionit si dhe hartimin e zbatimit e politikave kombëtare në lidhje me pakësimin e shkarkimeve dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të propozojë pranë Kryeministrisë ngritjen e Komisionit Kombëtar për Ajër të Pastër.

Menjëherë

Përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Për realizimin e këtij procesi u përgatit Memo për Ministrin nr.2260 prot., date 29.03.2024 në lidhje me Draft-Urdhrin e Kryeministrit për Ngritjen e komisionit Kombëtar për Ajër të Pastër. Me pas u dërgua për mendim Draft-Urdhri i Kryeministrit me nr. 2260/1 prot., date 29.03.2024, ministrive të linjës. Pas përfundimit të këtij procesi nga ministrinë e linjës Draft-Urdhri i Kryeministrit dërgohet për shqyrtim dhe miratim në Kryeministri me nr.3597/1 PROT., date 29.05.2024. Urdhëri i Kryeministrit për “Ngritjen e Komisionit Kombëtar për Ajër të Pastër” është miratuar me nr. 98 datë 20.06.2024.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar, i zbatuar.

Shënim: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet shkresës me nr. 5760/4 datë 15.10.2024 krahas komenteve për rekomandimin nr. 1.1 të nënpyetjes 2.1 ka dhënë edhe 2 komente të tjera për rekomandimin nr. 8.1 dhe 9.1 pa referuar nënpyetjen që ato i përkasin dhe pa nominuar apo emërtuar përmbajtjen e qartë të rekomandimit që i referohen. Kujtojmë se grupi i auditimit nuk ka dhënë asnjë rekomandim me nr. 8.1 apo 9.1. Në këto kushte, duke mos qenë të sigurt se kujt rekomandime i përkasin komentet e MIE të bëra në shkresën nr. 5760/4, grupi i auditimit nuk mund t'i marrë në konsideratë ato komente.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresën nr. 1181/10, 1181/11, 1181/12, datë 19.07.2023, për Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit*”, konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e tyre është e pazbatuar, e zbatuar pjesërisht ose në proces zbatimi. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **ri-kërkojmë** nga MIE, MTM dhe AKM zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

2.1 Për nënpyetjen: A janë planifikuar politika, objektiva dhe aktivitete të përshtatshme në sektorin e transportit rrugor për të përmirësuar cilësinë e ajrit?

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në vendin tonë nuk janë transpozuar Direktiva 2009/33/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 23 prill 2009 “Mbi promovimin e mjeteve të transportit rrugor të pastër dhe me energji eficiente” dhe Direktiva 2014/94/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 22 Tetor 2014 “Mbi vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative”. Transpozimi i këtyre direktivave do të nxiste dhe do të kontribuonte më tej në rinovimin e flotës së mjeteve rrugore që përdorin karburant të pastër.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të hartojë dhe propozojë për miratim pranë organeve kompetente akte ligjore/nënligjore për të transpozuar Direktivën 2009/33/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 23 prill 2009 “Mbi promovimin e mjeteve të transportit rrugor të pastër dhe me energji eficiente” dhe Direktivës 2014/94/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 22 Tetor 2014 “Mbi vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative”.

Brenda muajit Qershor 2025

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Për nënpyetjen: A kanë pësuar ndryshim mjetet e transportit rrugor me qëllim përmirësimin e cilësisë ajrit?

1. Gjetje nga auditimi: Në vendin tonë nuk ka të dhëna të sakta e të përditësuara ndër vite mbi numrin e stacioneve të karikimit të mjeteve rrugore elektrike. Kjo situatë nuk lejon vlerësimin e gjendjes aktuale në vendin tonë mbi nevojat për instalimin e këtyre stacioneve.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa për të bashkëpunuar më të gjitha institucionet e përfshira në procesin e instalimit të stacioneve të

karikimit të mjeteve elektrike për të garantuar publikimin e të dhënave të sakta e të përditësuara mbi këto stacione.

Brenda muajit Dhjetor 2024

2.1 Për nënpyetjen: A janë planifikuar politika, objektiva dhe aktivitete të përshtatshme në sektorin e transportit rrugor për të përmirësuar cilësinë e ajrit?

2. Gjetje nga auditimi: Plani Kombëtar i Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit si dhe dokumentet e tjerë strategjikë në sektorin e transportit rrugor parashikojnë në parim disa masa lidhur me përmirësimin e flotës së mjeteve rrugore dhe cilësisë së ajrit. Megjithatë, në këto dokumente këto masa nuk shoqërohen me objektiva, aktivitete dhe targete të matshme e të arritshme. Pra, pavarësisht se në këto dokumente citohen disa masa si për shembull “Reduktimi i shkarkimeve të automjeteve” ose “shtimi i mjeteve rrugore me karburant alternativ”, nuk specifikohet konkretisht se sa duhet të reduktohet niveli i shkarkimeve nga automjetet dhe sa duhet të shtohen mjetet rrugore me karburant alternativ. Mungesa e këtyre përcaktimeve nuk lejon vlerësimin nëse këto masa janë të mjaftueshme për të ndikuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

3. Gjetje nga auditimi: Plani i Transportit të Qëndrueshëm, i hartuar bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare të përshtatura me realitetin shqiptar, nuk është miratuar zyrtarisht. Gjithashtu masat dhe zgjidhjet konkrete për të përmirësuar sektorin e transportit rrugor me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit nuk janë integruar plotësisht në dokumentet e tjera strategjikë të qeverisë. Kjo situatë nuk krijon kushtet për ndryshim lidhur me rinovimin e flotës së mjeteve rrugore dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të përditësojnë dokumentet e tyre strategjikë duke përcaktuar objektiva, masa dhe aktivitete konkrete, të matshme e të arritshme veçanërisht sa i përket reduktimit të shkarkimeve nga automjetet, shtimin e numrit të mjeteve rrugore me karburant alternativ etj.

Brenda muajit Qershor 2025

4. Gjetje nga auditimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar Programin Kombëtar të pakësimeve të shkarkimeve në ajër. Hartimi i Programit Kombëtar të pakësimeve të shkarkimeve në ajër është një detyrim ligjor që ngarkon Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për hartimin dhe propozimin e tij për miratim pranë Këshillit të Ministrave. Mungesa e Programit nuk ka lejuar vendosjen e synimeve për pakësimin e shkarkimeve në ajër.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për hartimin e Programit Kombëtar të pakësimit të shkarkimeve në ajër dhe t’ja përcjellë për miratim Këshillit të Ministrave.

Brenda muajit Mars 2025

5. Gjetje nga auditimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk kanë përcaktuar angazhimet kombëtare të pakësimit të shkarkimeve, në aneksin II, të VKM nr. 162 datë 19.2.2020. Afati për përcaktimin e tyre ka qenë data 30 dhjetor 2020. Mos miratimi i tyre ka ardhur si rezultat i mos kryerjes së një analize të plotë të legjislacioneve të transpozuar dhe miratuara në vend gjatë viteve të fundit të cilat kanë

impakt direkt ose indirekt në shkarkimet në ajër, mos rishikimit dhe saktësisimit të llogaritjeve të shkarkimeve në ajër për vendin tonë si dhe mungesës së kapaciteteve institucionale.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të përcaktojnë angazhimet kombëtare të pakësisimit të shkarkimeve, në Aneksin II, të VKM nr. 162 datë 19.2.2020

Brenda muajit Mars 2025

6. Gjetje nga auditimi: Procesi i monitorimit dhe raportimit të zbatimit të akteve ligjore dhe nën ligjore për cilësinë e ajrit ka pasur mangësi dhe problematika si më poshtë:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar raportin mbi zbatimin e ligjit për cilësinë e ajrit të mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka hartuar raportin informues të inventarit të shkarkimeve si dhe projeksionet e shkarkimeve në ajër;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk kanë monitoruar dhe nuk kanë raportuar mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë periodikisht raportet e zbatimit të ligjit për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit.

Në vijimësi

5.2 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të hartojë periodikisht raportin mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit si dhe projeksionet e shkarkimeve në ajër.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit janë propozuar disa programe subvencionimi për të krijuar lehtësira financiare për blerjen e mjeteve me nivel të ulët shkarkimi dhe heqjen nga përdorimi të automjeteve të prodhuara para vitit 1995 me një vlerë totale prej 35 milionë Euro dhe një numër të prishëm përfituesish rreth 35,000 njerëz. Nga auditimi është konstatuar se nuk ka pasur alokim të fondeve me qëllim vënien në zbatim të këtyre skemave subvencionuese. Aktualisht në vendin tonë aplikohen:

- përjashtimi nga TVSH i automjeteve të reja vetëm elektrike që regjistrohen për herë të parë në Shqipëri;
- reduktimi i TVSH në 6 % për mjetet e transportit publik vetëm elektrike (nëntë plus një ose më shumë vende);
- rimbursimi i tarifës së regjistrimit (6500 lekë) për herë të parë për mjetet elektrike dhe “plug in” nga DPSHTRR.

6.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të vlerësojnë fizibilitetin financiar të programeve të subvencionimit të parashikuara në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit dhe t'i drejtohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi alokimin e fondeve për subvencionimin këtyre programeve.

Brenda muajit Mars 2025

2.3 Për nënpyetjen: A kanë bashkëpunuar institucionet përgjegjëse për marrjen e masave sa i përket ndikimit të transportit rrugor në cilësinë e ajrit ?

8. Gjetje nga auditimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duhet të bashkëpunojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të garantuar financim nga fondet ndërkombëtare në mbështetje të promovimit të mjeteve rrugore ekologjike. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk kanë bashkëpunuar me njëra tjetrën dhe nuk i janë drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim përthithjen e fondeve nga financimet ndërkombëtare për të nxitur përdorimin e mjeteve rrugore ekologjike. Mungesa e iniciativave të përbashkëta midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ka sjellë mos përthithjen e fondeve të tilla dhe për rrjedhojë mos mbështetjen financiare të objektivave dhe masave të parashikuara në dokumentet politike respektive.

7.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të bashkëpunojnë me njëra tjetrën dhe t'i drejtohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të siguruar financimin nga fondet ndërkombëtare për promovimin e shkarkimeve zero nga mjetet rrugore, shkarkime të ulëta, automjete me karburant të pastër, alternativ, etj.

Në vijimësi

Të tjera

Për të gjitha masat e dhëna të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar me statusin ***në proces zbatimi***, duke vlerësuar proceset e ndërmarra nga subjektet e audituara dhe afatet e nevojshme për implementimin e plotë të tyre, kërkohet përmbushja e plotë e tyre **brenda tremujorit të parë të vitit 2025**.

Për sa më sipër u mbajt ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023”

3- ANEKSE

Përmbledhëse e masave sipas llojit për 5-auditimet e kryera.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuar												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa për përmirësim ligjor	5		5				100%		3		1		1								
2	Masa organizative	80		78		2		97.5%		30		16		14				18				
3	Masa shpërblim dëmi																					
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																					
5	Për eliminimin e efekteve																					
6	Masa disiplinore																					
7	Masa Administrative																					
TOTALI		85		83		2		97.6%		33		17		15				18				

Aneksi nr. 3.1

PËR AUDITIMIN ME TEMË “REZERVA MATERIALE E SHËRBIM NË SHËRBIM TË QYTETARIT”

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuara												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ	1		1				100%							1							
2	Masa organizative	24	-	24	-	-	-	100%		1		10		4				9				
3	Masa shpërblim dëmi																					
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																					
5	Për eliminimin e efekteve																					
6	Masa disiplinore																					
7	Masa Administrative																					
TOTALI		25	-	25	-	-	-	100 %		1		10		5				9	-	-	-	-

Aneksi nr. 3.2

PËR AUDITIMIN ME TEMË “PERFORMANCA E SHËRBIMIT TË PARABURGIMIT”

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ	3		3				100%		3												
2	Masa organizative	17	-	17	-		-	100%	-	17	-		-		-	-	-		-	-	-	-
3	Masa shpërblim dëmi																					
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																					
5	Për eliminimin e efekteve																					
6	Masa disiplinore																					
7	Masa Administrative																					
TOTALI		20	-	20	-		-	100%	-	20	-		-		-	-	-		-	-	-	-

Aneksi nr. 3.3

PËR AUDITIMIN ME TEMË : “FUQIZIMI EKONOMIK I GRUAS NË VENDIN TONË”

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ																					
2	Masa organizative	14	-	12	-	2	-	86 %	-	7	-	1	-	4	-	-	-		-	-	-	-
3	Masa shpërblim dëmi																					
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																					
5	Për eliminimin e efekteve																					
6	Masa disiplinore																					
7	Masa Administrative																					
TOTALI		14	-	12	-	2	-	86 %	-	7	-	1	-	4	-	-	-		-	-	-	-

Aneksi nr. 3.4

PËR AUDITIMIN ME TEMË: “SHËRBIMI PËRMBARIMOR SHTETËROR NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE”

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranua												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ																					
2	Masa organizative	11	-	11	-	0	-	100%	-	1	-	3	-	4	-	-	-	3	-	-	-	
3	Masa shpërbllim dëmi																					
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																					
5	Për eliminimin e efekteve																					
6	Masa disiplinore																					
7	Masa Administrative																					
TOTALI		11	-	11	-	0	-	100 %	-	1	-	3	-	4	-	-	-	3	-	-	-	

Aneksi nr. 3.5

PËR AUDITIMIN ME TEMË : “NDIKIMI I MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR NË CILËSINË E AJRIT”

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuar												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ	1		1				100%				1										
2	Masa organizative	14	-	14	-	-	-	100%		4		2		2				6				
3	Masa shpërblim dëmi																					
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																					
5	Për eliminimin e efekteve																					
6	Masa disiplinore																					
7	Masa Administrative																					
TOTALI		15	-	15	-	-	-	100 %		4		3		2				6	-	-	-	-